



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

# **RAPORTI VJETOR**

## **2018**

# **PËRMBAJTJA**

|                                                                                                                                                  |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| HYRJE .....                                                                                                                                      | 5  |
| i. Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.....                                                                                              | 5  |
| ii. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.....                                                                                                     | 7  |
| iii. Bordi i Autoritetit .....                                                                                                                   | 9  |
| iv. Zhvillimet kryesore të vitit 2018 .....                                                                                                      | 10 |
| v. Kronologjia e ngjarjeve më të rëndësishme në vitin 2018.....                                                                                  | 22 |
| vi. Rekomandimet e progres-raportit të BE-së për Shqipërinë .....                                                                                | 24 |
| vii. Informacion mbi zbatimin e planit të veprimit për rezolutën “Për Vlerësimin e veprimtarisë së “Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare” ..... | 26 |
| viii. Masat e marra nga Autoriteti në adresim të rekomandimeve të lëna nga komiteti Moneyval i KE.....                                           | 40 |
| ix. Inspektimet.....                                                                                                                             | 42 |
| x. Zbatimi i rekomandimeve nga Institucione të tjera .....                                                                                       | 44 |
| xi.Përmbledhje e ecursisë së tregjeve nën mbikëqyrje .....                                                                                       | 49 |
| Kapitulli 1 MBROJTJA E KONSUMATORIT.....                                                                                                         | 51 |
| 1.1 Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit .....                                                                                               | 51 |
| 1.2 Edukimi Financiar.....                                                                                                                       | 53 |
| 1.3 Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun .....                                                                                              | 54 |
| I. MBIKËQYRJA E INTEGRUAR E TREGJEVE FINANCIARE JOBANKARE.....                                                                                   | 58 |
| 2 Kapitulli 2 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Investimeve.....                                                                  | 58 |
| 2.1 Tregu i Fondeve të Investimeve.....                                                                                                          | 58 |
| 2.1.1 Struktura e Tregut.....                                                                                                                    | 58 |
| 2.1.2 Pozicioni Financiar dhe Mbikëqyrja e Tregut.....                                                                                           | 59 |
| 2.1.3 Inspektime .....                                                                                                                           | 62 |
| 2.2 Tregu i Kapitaleve.....                                                                                                                      | 63 |

|       |                                                           |     |
|-------|-----------------------------------------------------------|-----|
| 2.3   | Aktiviteti i Licencimit.....                              | 67  |
| 2.4   | Qeverisja .....                                           | 67  |
| 2.5   | Inspektimi i Shoqërive .....                              | 69  |
| 2.6   | Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor e Rregullativ .....       | 70  |
| 2.6.1 | Masat Korrigjuese dhe Administrative .....                | 72  |
| 3     | Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve.....                    | 72  |
| 3.1   | Struktura e Tregut të Sigurimeve .....                    | 72  |
| 3.2   | Pozicioni Financiar .....                                 | 77  |
| 3.1   | Inspektimi në shoqëritë e sigurimeve .....                | 83  |
| 3.2   | Provigjonet Teknike.....                                  | 85  |
| 3.3   | Mbikëqyrja e Grupeve .....                                | 92  |
| 3.4   | Qeverisja e Shoqërive të Sigurimit .....                  | 93  |
| 3.5   | Aktiviteti Licencues .....                                | 95  |
| 3.6   | Ndërmjetësit në Sigurime .....                            | 97  |
| 3.7   | Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS).....                  | 99  |
| 3.8   | Fondi i Kompensimit .....                                 | 101 |
| 3.9   | Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor e Rregullativ .....       | 103 |
| 3.10  | Masat Korrigjuese dhe Administrative .....                | 105 |
| 4     | Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare..... | 107 |
| 4.1   | Struktura e Tregut .....                                  | 107 |
| 4.2   | Pozicioni Financiar .....                                 | 107 |
| 4.3   | Mbikëqyrja dhe Analiza e Rreziqeve të Tregut .....        | 116 |
| 4.4   | Kuadri Ligjor dhe Rregullativ.....                        | 116 |
| 5     | Bashkëpunimi institucional dhe projektet .....            | 117 |
| 5.1   | Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit.....               | 117 |
| 5.2   | Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar .....               | 117 |

|      |                                                      |     |
|------|------------------------------------------------------|-----|
| 5.3  | Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje ..... | 124 |
| 5.4  | Projekte .....                                       | 128 |
| I.   | ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I AMF-së.....               | 134 |
| II.1 | Kuadri ligjor dhe rregullator i AMF-së .....         | 134 |
| II.2 | Politika e Burimeve Njerëzore .....                  | 136 |
| II.3 | Sistemet e Teknologjisë së Informacionit .....       | 139 |
| II.4 | Auditi i Brendshëm .....                             | 144 |
| II.  | STRATEGJI DHE OBJEKTIVA TË AUTORITETIT .....         | 146 |
| IV.  | SHTOJCA.....                                         | 149 |

## FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Të nderuar,

Në përmbushje të detyrimeve ligjore për transparencë dhe llogaridhënie, ky Raport Vjetor është një pasqyrë e aktivitetit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare përgjatë vitit 2018.

Dëshiroj të theksoj, se viti 2018 ishte një vit i rëndësishëm në kuadër të misionit të Autoritetit për mbikëqyrje rigorozë dhe efikase të tregjeve financiare jobankare, për zhvillimin e mëtejshëm të tyre si edhe për vendimet e marra në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe investitorit.

Objektivi i Autoritetit për të shndërruar tregjet më të brishta financiare jobankare në Ballkanin Perendimor në tregjet më të konsoliduara, u reflektuan në “Strategjinë për zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje 2018-2022”, e prezantuar në maj 2018, si një udhërrëfyes për vizionin 5-vjeçar, të lidhur ngushtë edhe me procesin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Autoriteti synon që implementimi i kësaj strategjie të nxisë zhvillimin e një tregu konkurrent dhe eficient, duke krijuar njëkohësisht stabilitet afatgjatë si dhe duke i dhënë mundësi krijimit dhe zhvillimit të produkteve të reja.

Për mua si drejtues i institucionit është kënaqësi e madhe të ndaj me Ju një nga arritjet më të rëndësishme të realizuara nga Autoriteti përgjatë viteve të fundit, edhe në zbatim të rekomandimeve të vazhdueshme nga Kuvendi dhe institucione të tjera: **Zgjidhjen e problematikës së mbartur që nga viti 2002 me pagesat e Fondit të Kompensimit.**

Duke patur në vëmendje të posaçme qytetarët, Autoriteti ka miratuar përgjatë vitit 2018 një sërë vendimesh në mbrojtje të interesave të tyre, nga të cilët do të veçoja ndryshimin e Rregullores “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”. Sipas ndryshimeve të miratuara, **nga 1 korriku 2018, qytetarët shqiptarë përfitojnë një rritje të konsiderueshme të dëmshpërblimit.**

Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit u realizua edhe nëpërmjet trajtimit të shpejtë dhe efikas të ankesave, si edhe rritjes së edukimit financiar për publikun (përmes orëve të hapura të leksioneve në universitete, apo broshurave informative për tregjet nën mbikëqyrje). Përgjatë vitit 2018, Autoriteti rriti më tej transparencën, përmes publikimeve të reja me karakter financiar dhe edukues, por edhe njoftimeve paralajmëruese për investitorët e konsumatorët.

Në funksion të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut, Autoriteti përgjatë vitit 2018 ka realizuar një numër thuajse 4 herë më të lartë inspektimesh, sipas metodologjive dhe tematikave të ndryshme. Përmes tyre janë lënë rekomandime, por edhe janë marrë masa rregullatore në funksion të mbrojtjes së qytetarëve dhe zbatimit të ligjeve e rregulloreve në

fuqi. Autoriteti gjithashtu është angazhuar për rinovimin teknologjik dhe modernizimin e platformave dhe aplikacioneve në ndihmë të qytetarëve.

Në vitin 2018, në tregun e sigurimeve, përveç rritjes së mëtejshme të tregut, u përmirësuan disa nga treguesit e tjerë të rëndësishëm, raporti dëme/prime arriti në 42%, si edhe u rrit me mbi 26% pagesa e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit, krahasuar me një vit më parë. Tregu i fondeve të investimeve u zgjerua me pjesëmarrës të ri të licencuar nga Autoriteti. Ndërsa numri i anëtarëve në fondet e pensione private vullnetare u rrit me mbi 20%.

Autoriteti ka ndjekur dhe zbatuar me prioritet të gjitha rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017”.

Përgjatë vitit 2018, Autoriteti ka përfunduar hartimin e tre projektligjeve të rëndësishme për tregjet nën mbikëqyrje dhe i ka depozituar ato në Ministrinë e Financave. Gjithashtu, është përmirësuar kuadri ligjor e rregullator në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian. Globalizimi dhe inovacionet në sektorin financiar (FinTech) kërkojnë thellim të bashkëpunimit mes autoriteteve rregullatore në përballimin e sfidave. Autoriteti u angazhua në rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe kjo u konkretizua me mbajtjen e aktiviteteve të rëndësishme në Tiranë, duke kontribuar në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira mbikëqyrëse.

Ky raport përmban të dhëna të detajuara për tregjet financiare nën mbikëqyrje dhe do t’Ju njohë më hollësisht me veprimtarinë e Autoritetit gjatë vitit 2018.

Shpresoj që të jetë me interes për Ju.

Me respekt,

Ervin Koçi  
Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si institucion juridik publik, i pavarur në ushtrimin e kompetencave të tij, që raporton në Kuvendin e Shqipërisë. Veprimtaria e Autoritetit mbështetet në këto ligje :

- Ligji nr. 9572, datë 3.7.2006 ‘Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare’ ndryshuar me ligjin nr. 54/2014
- Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"
- Ligji nr. 10 076, datë 12.02.2009 "Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit", ndryshuar me Ligjin Nr. 10455, datë 21.7.2011
- Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt"
- Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" ndryshuar me Ligjin nr. 36, datë 31.03.2016
- Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar"
- Ligji nr. 10 158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore".

Autoriteti licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e tregut të sigurimeve dhe operatorëve të tij, aktivitetin e tregut të letrave me vlerë dhe operatorëve të tij, aktivitetin e tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe operatorëve të tij, si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare.

Misioni i Autoritetit është të kontribuojë në nxitjen e qendrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Përmbyshjen e misionit të tij, Autoriteti e ushtron me anë të funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës. Objektivi prioritar i Autoritetit, i cili udhëheq këto dy funksione është **Mbrojtja e Interesave të Konsumatorit dhe Investitorit, si dhe Edukimi Financiar i tyre**. Në ushtrimin e funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës, AMF udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit. Rritja e pavarësisë institucionale dhe pavarësisë financiare, të parashikuara në Ligjin nr. 54, datë 29.05.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” synon forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së.

Objektivat kryesore të AMF-së janë nxitja dhe ruajtja e stabilitetit të sistemit financiar dhe mbikëqyrja e legjitimitetit të veprimtarive të subjekteve të mbikëqyrura. Për arritjen e objektivave të saj, AMF udhëhiqet nga parimet e transparencës, duke krijuar besim tek pjesëmarrësit e tregut financiar dhe duke mbrojtur dhe informuar konsumatorin.

### **Gjatë ushtrimit të kompetencave të saj, AMF ka objektiv të:**

- Miratojë zbatimin e rregulloreve në përputhje me Ligjin;
- Lëshojë dhe revokojë licencat, autorizojë dhe miratojë, sipas autorizimit bazuar në rregullore;
- Inkurajojë, organizojë dhe monitorojë masat që synojnë funksionimin efektiv të tregjeve financiare;
- Inicijojë miratimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative dhe të informojë publikun mbi parimet bazë të funksionimit të tregjeve financiare jobankare;
- Miratojë rregullore që përshkruajnë kushtet, mënyrën dhe vazhdimësinë e procedurave për një proces të njëtrajtshëm mbikëqyrës brenda fushës së saj të kompetencës dhe të marrë masa të tjera dhe të kryejë detyra të tjera në përputhje me kompetencat e saj statutores;
- Informojë organe të tjera mbikëqyrëse, administrative dhe gjyqësore për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në fushën e tyre të kompetencës, në lidhje me veprimtaritë që lidhen me fushën e kompetencës së AMF-së.

Misioni i Autoritetit është arritja e krijimit të një tregu bashkëkohor dhe efektiv që do të ofrojë shërbime cilësore dhe do të promovojë zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend.

**Përgjegjësia:** AMF do të reagojë me një plan konkret veprimi dhe me përkushtim gjithëpërfshirës drejt arritjes së misionit dhe synimeve strategjike si një autoritet mbikëqyrës për tregjet financiare jobankare.

**Kompetenca:** AMF do të ushtrojë autoritetin e saj që të sigurojë realizimin sa më efikas të strategjisë dhe misionit në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe me kosto racionale.

**Llogaridhënia:** Për realizimin e veprimtarive të saj AMF duhet të zbatojë standardet më të larta etike në komunikimin dhe bashkëpunimin me grupet e interesit në procesin e mbikëqyrjes për tregjet financiare jobankare.

**Transparenca:** AMF rregullisht do të publikojë informacione në lidhje me tregun si dhe shërbimet për tregjet financiare jobankare të ofruara në Republikën e Shqipërisë.



## **BORDI I AUTORITETIT**

Në vitin 2018 Bordi i Autoritetit përbëhej nga:

|          |                                                                                                                                                                         |
|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kryetar  | Z. Pajtim Melani                                                                                                                                                        |
| Anëtarë: | Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv<br>Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtor Ekzekutiv<br>Z. Ildir Gjata, Anëtar Joekzekutiv<br>Z. Klodion Shehu, Anëtar Joekzekutiv |

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës. Bazuar në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" i ndryshuar, ai është një organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë, dy prej të cilëve, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Nëndrejtori Ekzekutiv janë anëtarë ekzekutivë me kohë të plotë, ndërsa Kryetari i Bordit dhe dy anëtarë të tjerë janë anëtarë joekzekutivë. Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë sipas një procedure të përcaktuar në ligj.

Bordi i Autoritetit, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tij, gjatë vitit 2018, ka zhvilluar 21 mbledhje dhe ka marrë 261 vendime. Vendimet më të rëndësishme të Bordit janë marrë me transparencë të plotë, duke u respektuar njëkohësisht edhe parimi i shumicës së votave dhe fryma kolegjiale.

Numri më i madh i vendimeve, vazhdon të jetë i lidhur me tregun e sigurimeve. Në krahasim me vitin e kaluar është rritur ndjeshëm numri i vendimeve për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive me më shumë se dyfishin e vendimeve për këtë treg.

Me qëllim plotësimin apo përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e tregjeve dhe të institucioneve të mbikëqyrura, Bordi i Autoriteti ka miratuar 7 rregullore dhe 4 udhëzime të reja si dhe 5 marrëveshje. Po gjatë vitit 2018 janë ndryshuar 19 rregullore dhe 1 udhëzim. Në lidhje me masat administrative dhe korrigjuese janë marrë 34 vendime.

## **ZHVILLIMET KRYESORE TË VITIT 2018**

### **1. Zgjidhja e problemeve ndër vite në lidhje me Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe detyrimet e mbartura të Fondit të Kompensimit në funksion të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të investitorëve.**

Autoriteti, për herë të parë, ka hartuar një plan konkret dhe të posaçëm veprimi lidhur me mirëfunksionimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe problematikën e mbartur të Fondit të Kompensimit, si përsa i përket vlerës së miratuar të Fondit të Kompensimit, ashtu dhe ecurisë së pagesave të kryera nga shoqëritë e sigurimit.

Më poshtë renditen disa veprime të Autoritetit në këtë drejtim:

- a. Me qëllim mospërsëritjen e fenomenit të akumulimit të Fondit të Kompensimit, Autoriteti gjatë vitit 2018 kreu inspektime tek shoqëritë e sigurimit dhe BSHS. Përsa i përket kësaj të fundit gjatë vitit 2018 janë shtuar mekanizmat që lidhen me zbatimin e detyrimeve ligjore të Byrosë;
- b. Si rezultat i disa inspektimeve të kryera në maj 2018 pranë shoqërive të sigurimit dhe verifikimeve në qershor 2018 pranë BSHS-së mbi praktikën e ndjekura me shoqëritë e sigurimit, Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 155, datë 03.07.2018 dhe Vendimin Nr. 219 datë 31.10.2018 miratoi dy shtesa të Fondit të Kompensimit për vitin 2018;
- c. Gjatë vitit 2018 u monitoruan: Zbatimet e Vendimeve të Bordit lidhur me shlyerjen e detyrimeve që u përkasin shoqërive; Publikimi i personave përfitues për praktikën e miratuara të papaguara administrative; si dhe kontrolli i pagesave të kryera sipas konkluzioneve të inspektimit dhe shtesës së Fondit të Kompensimit. Janë propozuar në Bord dhe janë marrë masa ndaj shoqërive për rastet e konstatuara për moszbatim të vendimeve të AMF-së;
- d. Pagesat për Fondin e Kompensimit vetëm për vitin 2018, janë në vlerën prej mbi 1,009 milionë lekë, vlerë e cila për herë të parë tregon për pagesa të konsiderueshme të detyrimeve të Fondit të Kompensimit. Përveç këtyre pagesave për një vlerë të konsiderueshme të praktikave të Fondit të Kompensimit gjatë këtij viti janë lidhur dhe marrëveshje me palët përfituese;
- e. Me qëllim mirëadministrimit të BSHS-së janë ndërmarrë veprime si: Miratimi i drejtorit të ri të BSHS-së; Ndryshime në aktet nënligjore; Miratimi i disa rregulloreve nga ana e BSHS-së, që lidhen me përmirësimin e procedurave të ndjekjes së praktikave, objekt i Fondit të Kompensimit; Ndjekja e proceseve gjyqësore nga AMF, e cila informohet nga Byroja, dhe merr pjesë si palë dëgjuese

në mënyrë që të verifikohet ndjekja e rregullt e proceseve; si dhe procesi i auditimit nga shoqëri audituese ndërkombëtare;

- f. Për herë të parë në vitin 2018, u zbatuan kërkesat e ndryshuara të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, ndryshuar së fundmi me Vendimin e Bordit nr. 153, datë 30.11.2017, lidhur me raportimin në Autoritet mbi emetimin dhe furnizimin me polica sigurimi. Gjithashtu mbështetur në kërkesat e kësaj rregulloreje për nxjerrjen e saktë të raporteve të dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit, që prej muajit janar 2019 pranë BSHS-së funksionon Sistemi Elektronik i Administrimit të Dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, ku AMF ka të drejtë shikueshmërie dhe evidentimi të statusit të dosjes, në mbrojtje të interesave të konsumatorëve;
- g. AMF me Vendimin nr. 156 datë, 30.07.2018, ka bërë ndryshime të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, ndryshime të cilat lidhen me problematikën e akumulimit në BSHS të detyrimeve të Fondit të Kompensimit;
- h. Në muajin maj të vitit 2018 u dërgua në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Një nga qëllimet e këtij projektligji është përmirësimi i funksionimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, duke bërë riorganizimin e strukturës dhe ndarjen e funksioneve të saj, si dhe rritjen e limitit minimal të përgjegjësisë në linjë me vendet e rajonit dhe në përputhje me frymën e Direktivës 2009/103/EC të BE-së në lidhje me sigurimet.

## **2. Forcimi i rolit mbikëqyrës të Autoritetit në tregjet nën mbikëqyrje**

Në forcimin e rolit mbikëqyrës të Autoritetit gjatë vitit 2018 kanë kontribuar një sërë faktorësh si më poshtë:

- a. Mbështetur në manualin e mbikëqyrjes me bazë rreziku, si dhe në zbatim të planit të punës të vitit 2018 dhe rekomandimit të lënë në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për Vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017”, Autoriteti përfundoi në vitin 2018 ciklin e parë të inspektimeve sipas metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun për tregun e sigurimeve. Në vijim duke marrë në konsideratë nivelin e rrezikut që paraqesin siguruesit dhe elementë të tjerë si madhësia e tyre, në përputhje edhe me manualin e mbikëqyrjes do të vendosen prioritetet për alokimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe për inspektimet e mëtejshme;
- b. Miratimi dhe implementimi i 2 manualeve, të hartuara me asistencën e Bankës Botërore në kuadrin e projektit FIRST, “Manuali praktik për inspektimin e dëmeve motorike dhe të pronës”, miratuar me Vendim Bordi nr. 97, datë

13.06.2018 dhe “Manuali për inspektimin e aktivitetit të risigurimit”, miratuar me Vendim Bordi nr. 140, datë 30.07.2018. Vlerësimet e rrezikut, të nxjerra nga inspektimet, bazuar në këta manualë mund të përdoren si bazë krahasimi midis shoqërive pjesëmarrëse në tregun e sigurimeve, ndërkohë që çështjet e identifikuar si me rrezik më të lartë mund të shërbejnë si një orientim për t’u përqendruar në inspektimet e ardhshme;

- c. Gjatë vitit 2018, në zbatim të “Manualit praktik për inspektimin e dëmeve motorike dhe të pronës” janë kryer inspektime tematike për aktivitetin e administrimit dhe trajtimit të dëmeve në një pjesë të shoqërive të sigurimit Jo-Jetë. Ky proces po vijon edhe në vitin 2019 me pjesën tjetër të shoqërive të tregut të Jo-Jetës.
- d. Kryerja për herë të parë e inspektimeve në vend në të gjitha shoqëritë e brokerimit dhe bankat broker. Efekti i këtyre inspektimeve ishte zbulimi dhe parandalimi i shkeljeve ligjore e parregullsive, për të cilat janë marrë masa nga AMF duke lënë rekomandime për korrigjimin e tyre në një periudhë të shkurtër kohe, në përmbushje të dispozitave ligjore në fuqi, me qëllim mbrojtjen sa më të mirë të konsumatorit;
- e. Në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të grupeve u miratua Udhëzimi metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”, me Vendim Bordi nr. 250, datë 28.12.2018 dhe u krijuan Kolegjet Mbikëqyrëse Rajonale me pjesëmarrjen e 3 rregullatorëve AMF, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ISA) Maqedoni. Udhëzimi ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe formave specifike të një sistemi bashkëpunimi midis institucioneve mbikëqyrëse për të mundësuar një mbikëqyrje më efektive të grupeve të sigurimit si dhe duke pasur një qasje proaktive ndaj problematikave që mund të shfaqen nga grupet e sigurimit për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit të cilat kanë investime të tyre (filiale) apo degë në vende të huaja;
- f. Për koordinimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve në mënyrë efektive Autoriteti ka krijuar strukturën e nevojshme lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Autoriteti, ka shtuar inspektimet për çështje të PPP/FT, pothuajse në të gjitha subjektet që mbikëqyr. Gjatë vitit 2018, u zhvilluan inspektime të plota në vend në të tri shoqëritë e sigurimit të Jetës, dy shoqëri brokerimi në sigurime dhe në tri banka broker në sigurime, pjesë e të cilave ishte edhe mbikëqyrja në lidhje me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave, në zbatim të “Manualit të mbikëqyrjes për parandalimin e pastrimit të parave”. Edhe në tregun e kapitaleve dhe fondeve të investimit është forcuar roli mbikëqyrës i Autoritetit i shprehur

edhe në një sërë inspektimesh të realizuara. Kështu, gjatë vitit 2018, u krye inspektim në vend pranë tri shoqërive, të cilat janë miratuar nga AMF për të kryer veprimtarinë e agjentit për llogari të shoqërive të huaja të brokerimit që administrojnë platforma të tregtimit online. Gjithashtu gjatë vitit 2018 u realizua edhe një inspektim në vend pranë një shoqërie (bankë) me objekt kryesor veprimtarinë e shërbimit të kujdestarisë për titujt e Qeverisë si dhe respektimin e rregullave në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër terrorizmit. Inspektime të tjera janë kryer pranë një banke që shërben si depozitar i një fondi pensioni dhe disa fondeve investimi, përfshirë dy fondet e investimit të licencuara gjatë vitit 2018. Inspektimet janë kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), por edhe veçmas nga Autoriteti;

- g. Gjatë vitit 2018 në kuadër të projektit SECO, konsulentët dërguan edhe raportin final të menaxhimit të krizave, i domosdoshëm për reagimin e Autoritetit në situata krizash të subjekteve që veprojnë në tregun e kapitaleve në vend. Në bashkëpunim me konsulentët e projektit SECO dhe bazuar në raportin e menaxhimit të krizave, u realizuan 2 simulime. Një simulim u realizua për të testuar procedurat e brendshme të Autoritetit për menaxhimin e krizave, të cilat u miratuan në dhjetor të vitit 2017. Simulimi i dytë u organizua në qershor të vitit 2018 me anëtarët e Grupit Këshillimor për Stabilitet Financiar (GKSF).

### **3. Përmirësimi i kuadrit ligjor rregullator në tregjet nën mbikëqyrje**

- a. Hartimi i Projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit”.

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ngriti një grup pune për konceptimin dhe hartimin e projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Hartimi i këtij projektligji u bazua kryesisht në Direktivën e Bashkimit Evropian, “Direktiva 2009/103/EC”, por edhe në ligjin për sigurimin e detyrueshëm në Serbi dhe Itali. Krahas adresimit të problematikave të ndryshme të identifikuara në ligjin ekzistues, nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ky projektligj synon:

- Të përafrojë dhe harmonizojë më tej legjislacionin me direktivat evropiane;
- Të ndikojë në edukimin, ndërgjegjësimin dhe disiplinimin e konsumatorit, si dhe të rrisë cilësinë e shërbimit ndaj tij;
- Të zgjidhë problematikat e Byrosë;
- Të shmangë konfliktet eventuale të prejardhura nga zbatimi i gabuar i ligjit;
- Të përshtatet me zhvillimet dhe kërkesat e tregut të sigurimeve;

- Të ndikojë në uljen e numrit të drejtuesve të mjeteve të transportit që qarkullojnë pa kontratën e sigurimit të detyrueshëm;
  - Të përmirësojë procedurat dhe afatet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim nga ana e shoqërive të sigurimit;
  - Të garantojë zbatimin e sistemit *Bonus-Malus*, i cili është mekanizmi i tarifimit në sigurimin e detyrueshëm (MTPL), ku primi i zbatuar për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta është i varur nga historiku i dëmeve/eksperienca e drejtimit të automjetit nga ana e të siguruarit. Nga ana sociale, me aplikimin e sistemit *Bonus-Malus* në Shqipëri, synohet ndërgjegjësimi i publikut për një drejtim sa më të kujdesshëm të automjetit, rritje e cilësisë së shërbimit të sigurimeve, si dhe mbrojtja e konsumatorëve.
- b. Ndryshimi i Rregullores së AMF-së nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 72, në prill të vitit 2018, që konsiston në përditësimin e koeficienteve të llogaritjes së shumës së kapitalizuar, si element i rëndësishëm në llogaritjen e vlerës së dëmshpërblimit. Me ndryshimin e koeficienteve ka patur një rritje të konsiderueshme të dëmshpërblimit për palët e dëmtuara;
- c. Bazuar në rekomandimet e lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës (KiE), me Vendimin nr. 214, datë 31.10.2018, për disa ndryshime në Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar, u shtua dhe Udhëzuesi “Për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit”. Ky udhëzues synon përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të rrezikut për secilin subjekt. Ndryshimet që shoqëruan Rregulloren nr. 58, morën në konsideratë qasjen me bazë rreziku për mbikëqyrjen në lidhje me PPP/FT, duke krijuar kështu dhe detyrimin për subjektet raportuese të kryerjes së vetëvlerësimit të rrezikut dhe të depozitimit të të dhënave mbi baza vjetore, pranë Autoritetit, duke zgjeruar fushëveprimin dhe forcuar mbikëqyrjen në distancë në lidhje me PPP/FT. Gjatë vitit 2018 u punua edhe në drejtim të rishikimit dhe ndryshimit të “Manualit të mbikëqyrjes për parandalimin e pastrimit të parave”, me qëllim përfshirjen në procesin e inspektimit në vend, krahas shoqërive të sigurimit, edhe të institucioneve të tjerë që mbikëqyren nga AMF;
- d. Autoriteti në bashkëpunim me konsulentët e projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”, financuar nga SECO, kreu një punë intensive gjatë vitit 2018 për përfundimin e rishikimit teknik të projektligjeve “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe “Për Tregjet e Kapitalit”. Këto projektligje janë hartuar në përputhje

me direktivat e Bashkimit Evropian dhe synojnë krijimin e një tregu transparent dhe të mirërregulluar të kapitaleve, si edhe nxitjen e zhvillimit të këtyre tregjeve;

- e. Viti 2018 u karakterizua edhe nga një përmirësim i mëtijshëm i kuadrit rregullator nëpërmjet miratimit të disa rregulloreve të domosdoshme në sektorin e fondeve të investimit dhe të tregut të kapitaleve. Këto rregullore janë si më poshtë:
- Rregullore nr. 21, datë 06.02.2018 “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve”;
  - Rregullore nr. 57, datë 29.03.2018 “Mbi transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar”;
  - Rregullore nr. 16, datë 31.01.2018 “Për formularin e kërkesës, përmbajtjen e dokumentacionit për miratim prospekti për emetimin e obligacioneve”.

#### **4. Rritja e Transparencës me Publikun**

- Autoriteti, gjatë vitit 2018, në kuadër të rritjes së transparencës me publikun, si dhe zbatimit të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, ka publikuar për herë të parë në faqen zyrtare të internetit të dhënat për të gjitha shoqëritë e sigurimit lidhur me 2 treguesit kryesorë të aftësisë paguese dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike;
- Autoriteti gjatë vitit 2018 i ka kushtuar vëmendje të veçantë monitorimit të përmbushjes në mënyrë efikase të detyrimit për informim nga shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve, duke ushtruar verifikime periodike dhe komunikuar me shoqëritë e sigurimit për përmbushjen e detyrimit lidhur me informacionin e detyrueshëm;
- Rëndësi e veçantë, gjatë vitit 2018, i është kushtuar dhënies së informacionit parakontraktual konsumatorit që e njeh atë me produktin dhe kushtet e sigurimit. Me qëllim verifikimin e sjelljes ndaj konsumatorit dhe marrjen e masave të nevojshme, Autoriteti ka kryer inspektime të vazhdueshme në subjektet e mbikëqyrura dhe, në rastet kur është konstatuar mosdhënie e plotë e informacionit parakontraktual është vijuar me masat mbikëqyrëse përkatëse. Në vijim është ndjekur zbatimi i masave të Autoritetit dhe ka rezultuar se ato janë përmbushur në kohë të shkurtër;
- U pasurua me tregues të rinj Buletini Statistikor i AMF-së për dëmet dhe Fondin e Kompensimit, duke rritur më tej transparencën në tregun e sigurimeve;
- Në funksion të mbrojtjes së investitorit, Autoriteti publikoi një sërë paralajmërimesh lidhur me rrezikun e disa produkteve financiare dhe aktivitetit të shoqërive të palicencuara në tregun e kapitaleve. Në këtë kuadër Autoriteti ka

kërkuar dhe mbështetjen e institucioneve përgjegjëse lidhur me ndërhyrjen e tyre për rastet e ushtrimit të aktivitetit të paligjshëm të këtyre subjekteve.

## **5. Rritja e Edukimit Financiar të Publikut**

Në fokus të veçantë të veprimtarisë së Autoritetit ka qenë rritja e edukimit financiar të publikut, si një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrjen e Autoritetit si dhe për mbrojtjen konsumatore dhe rritjen e besimit në tregjet nën mbikëqyrje. Gjatë vitit 2018 Autoriteti është angazhuar në veprime konkrete për rritjen e besimit dhe edukimit të konsumatorit për tregjet nën mbikëqyrje. Ka vijuar puna me organizimin e aktiviteteve për zbatimin e Strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje (2017–2020)”. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të kryera nga Autoriteti në kuadër të kësaj strategjie janë:

- Zhvillimi me sukses në maj 2018 dhe me ndikim pozitiv i Konferencës Kombëtare “Sfidat e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe edukimi financiar”, ku morën pjesë studentë dhe stafi akademik nga Universitete publike dhe private në vend, të cilët kontribuan me punime të ndryshme të tyre, për çështje të lidhura me tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit;
- Prezenca e Autoritetit në Universitete të ndryshme duke prezantuar institucionin, veprimtarinë e tij si dhe tregjet nën mbikëqyrje, nëpërmjet leksioneve të hapura dhe bashkëbisedimeve. Aktivitetet janë finalizuar me nënshkrimin e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me 7 universitete, për të nisur kështu një bashkëpunim të frytshëm mes institucioneve me qëllim arritjen e objektivit të përbashkët për rritjen e edukimit financiar të publikut në përgjithësi dhe të studentëve në veçanti;
- Gjatë vitit 2018 janë nxitur shoqatat për të rritur rolin e tyre përsa i përket edukimit financiar të publikut, të cilat kanë filluar të ushtrojnë aktivitete në publik dhe në media;
- Kryerja e praktikave studentore pranë AMF-së për disa studentë, si edhe koordinimi i këtij procesi për të mundësuar kryerjen e praktikave mësimore të studentëve pranë subjekteve nën mbikëqyrje;
- Bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit për fillimin e bisedimeve për përfshirjen në kurikulat mësimore ose në lëndë të veçanta, të tematikave për tregjet nën mbikëqyrje.



## 6. Përmirësimi dhe Zhvillimi i mëtejshëm në infrastrukturën teknologjike

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në funksion të rolit të tij mbikëqyrës, mbrojtjes së interesave të konsumatorëve si dhe qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të sigurt të tregjeve nën mbikëqyrje është i angazhuar për rinovimin teknologjik dhe modernizmin e platformave dhe aplikacioneve aktuale të raportimit në Qendrën e Informacionit të Sigurimit të Detyrueshëm. Gjatë vitit 2018 ka pasur zhvillime të rëndësishme në infrastrukturën e brendshme të teknologjisë së informacionit, duke aplikuar metodat më bashkëkohore në ndërtimin e sistemeve të informacionit. Konkretisht:

- Regjistri Elektronik i Sigurimit të Detyrueshëm Motorik është përmirësuar nëpërmjet përditësimit të sistemit *Oracle* në versionin 11G (64 bit), duke mundësuar një performancë më të lartë të shërbimit të ofruar, automatizim të disa proceseve që kryheshin manualisht, rritje të cilësisë së të dhënave dhe ulje të gabimeve njerëzore. Gjithashtu u shtuan fusha të reja për të saktësuar raportimet e TPL në kohë reale si dhe është realizuar integrimi për herë të parë me regjistrin e QKB-së.
- Mbështetur në standartet ndërkombëtare, u aktivizua infrastruktura *disaster recovery* pranë AKSHI-it e lidhur me qendrën e informacionit pranë AMF. Nëpërmjet kësaj infrastrukture mundësohet ruajtja (*backup*) i të gjithë informacionit të AMF-së jashtë ambienteve të saj në rastet kur dhoma e serverave pranë AMF të mund të dalë jashtë funksionit për shkaqe të katastrofave të mundshme.
- U krijua një platformë *online* për raportime të drejtpërdrejta të pasqyrave financiare apo raportimeve të tjera periodike të tregut të fondeve të investimeve dhe pensione.
- Në shërbim të transparencës dhe krijimit të lehtësive për konsumatorin u krijua platforma e raportimit të ankesave online, ku çdo konsumator mund të shprehë ankesën e tij edhe online nëpërmjet kësaj platforme.
- U krye vlerësimi i sistemeve të TI-së të instaluar pranë shoqërive të sigurimeve, nëpërmjet të cilave kryhet raportimi i shitjes së policave në kohë reale. Pas këtij vlerësimi u miratuan ndryshimet në Rregulloren nr. 23 “Për shitjet *online* të policave të sigurimit”;
- U realizua rritja e kapacitetit përpunues dhe depozitues të serverave, rritja e sigurisë së linjës së parë të rrjetit nga sulmet kibernetike si dhe monitorimi fizik i dhomës së serverave.

## **7. Zhvillime të reja**

***Më 22 shkurt të vitit 2018 filloi mbikëqyrja e Bursës së Parë Shqiptare të Titujve, ALSE.***

Bursa e parë Shqiptare e Titujve, ALSE, me kapital privat dhe e licencuar më 03.07.2017 filloi zyrtarisht veprimtarinë e saj më 22 shkurt 2018. Sistemi i tregtimit të Bursës është në funksion të mbrojtjes së interesave të investitorëve dhe sigurimit të një tregu të drejtë dhe transparent. Gjatë vitit të parë të aktivitetit të Bursës, Autoriteti ka miratuar edhe disa rregullore të depozituara nga Bursa Shqiptare e Titujve.

***Licencimi i një shoqërie të re administruese të fondeve të investimeve dhe krijimi i 2 fonde të reja investimi.***

Gjatë vitit 2018, Autoriteti licenoi një shoqëri të re administruese të fondeve të investimit për të kryer veprimtari administrimi të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si dhe miratoi krijimin e 2 fondeve të reja të investimit.

## **8. Forcimi i bashkëpunimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit në shërbim të një mbikëqyrjeje efektive**

Fuqizimi dhe bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit e më gjerë kanë qenë në fokus të punës së Autoritetit gjatë vitit 2018.

- Gjatë vitit janë zhvilluar një seri takimesh me Autoritetet homologe nga Austria, Kosova, Italia, Republika e Maqedonisë së Veriut, Kroacia, etj;
- Falë bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe marrëdhënies profesionale të AMF-së me organizatat në të cilat aderohet, për herë të parë Shqipëria u përzgjodh nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) si vendi organizator i një konference në nivel botëror, e cila do të zhvillohet në Tiranë në vjeshtën e vitit 2019;
- Në qershor 2018 u zhvillua nën kujdesin e AMF-së një takim i rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit rajonal, me temë “Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore”, (CESEE ISI). Kjo iniciativë vijon të mbështesë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave më të mira midis punonjësve të autoriteteve rregullatore në tregun e sigurimeve;
- Në shtator të vitit 2018, Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) në bashkëpunim me Bankën Botërore organizoi për herë të parë në Shqipëri *workshopin* ndërkombëtar me temë “Mbikëqyrja me bazë rreziku,” nën kujdesin organizativ të AMF-së, ku u shkëmbyen eksperiencat dhe

pikëpamje mbi tendencat globale të mbikëqyrjes me bazë rreziku, si dhe sfidat që lidhen me zbatimin e standardeve globale të mbikëqyrjes;

- Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare janë zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të Bankës Botërore, përfaqësues të FMN-së, dhe organizatave të tjera që kanë përfaqësitë e tyre në Shqipëri;
- Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë është forcuar nëpërmjet kryerjes së inspektimeve të përbashkëta tematike me objekt kryesisht verifikimin në vend të policave të sigurimit me përfitues bankat, të vlerave monetare të shoqërisë së sigurimit dhe verifikimin e praktikave të dëmeve pezull me përfitues bankat;
- Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, AMF ka mbikëqyrur procesin e inventarizimit edhe asgjësimit të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik nga Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe shoqëritë e sigurimit;
- Për herë të parë në Tiranë u organizua takimi i Kolegjit Rajonal të Mbikëqyrjes në nivel grupi sigurimi, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit me Kosovën dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me Udhëzimin metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”. Këto takime periodike kanë për qëllim shkëmbimin reciprok të informacioneve dhe shqyrtimin e problematikave në nivel grupi për shoqëritë e sigurimit;
- Është rritur bashkëpunimi nëpërmjet takimeve në nivel teknik me shoqatën e siguruesve për mundësitë e nxitjes dhe zhvillimit të tregut të sigurimeve. Roli i Autoritetit është ndjerë në kërkesat e vazhdueshme dërguar institucioneve përgjegjëse, duke kërkuar bashkëpunim me qëllim sigurimin dhe zbatueshmërinë e akteve ligjore që lidhet me monitorimin e produkteve të sigurimit të detyrueshëm;
- Në kuadrin e zgjerimit të marrëdhënieve dypalëshe me autoritetet homologe dhe institucionet ndërkombëtare në vitin 2018 Autoriteti nënshkroi Memorandume Mirëkuptimi përkatësisht me IVASS dhe FSVC;
- Në tetor të vitit 2018 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë për Licencimin dhe Mbikëqyrjen e Sistemeve të Shlyerjes së Titujve dhe Shtëpive të Klerimit të Titujve. Kjo marrëveshje ishte e domosdoshme për ndarjen e përgjegjësisë midis dy Rregullatorëve lidhur me licencimin dhe mbikëqyrjen e Sistemit të Klerimit dhe Shlyerjes së Titujve.

## **9. Përmbyllja me sukses e projekteve**

Gjatë vitit 2018 u përmbyllën me sukses disa projekte.

- Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, për paketën “Studimi i formës së ardhshme të Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë në Shqipëri” (gusht 2018). Rëndësia e këtij aktiviteti lidhet me rolin e rëndësishëm që ka krijimi i një depozitari Qendror të Titujve në vend si një institucion për klerimin dhe shlyerjen e titujve, në funksion të mbrojtjes së investitorit. Rekomandimet e lëna nga ky aktivitet ndihmuan edhe në procesin e licencimit në janar 2019 të një shoqërie për kryerjen e funksionit si regjistrar Titujsh;
- Projekti i mikrosigurimit “Akses në Iniciativën e Sigurimeve” (A2ii), një projekt për sigurimet vullnetare gjithëpërfshirëse (nëntor 2018). Projekti konsistoi në mbështetjen dhe zhvillimin e produkteve të mikrosigurimeve të fokusuara në fushën e bujqësisë;
- Në vitin 2018 është punuar intensivisht edhe në drejtim të përmbylljes dhe të dorëzimit të disa produkteve të projektit me kohëzgjatje 3-vjeçare: “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek Zhvillimi i Tregut të Kapitaleve”.

## **10. Forcimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit dhe Politikat e Burimeve Njerëzore për Motivimin e Punonjësve**

- Në kuadër të fazës së tretë të projektit SECO dhe në funksion të rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit, stafi i tij mori pjesë në një sërë trajnimesh të realizuara në vend mbi funksionimin e tregut të kapitaleve si dhe mbikëqyrjen me bazë rreziku apo praktikabuzive në tregun e titujve. Stafi kreu edhe një sërë vizitash studimore pranë Autoriteteve homologe dhe operatorëve të tregut të kapitaleve në vendet e Bashkimit Evropian, të cilat kontribuan në shkëmbimin e eksperiencave mbi veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitaleve;
- Gjithashtu në bashkëpunim me DPPPP janë realizuar trajnime brenda dhe jashtë vendit në fushën e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
- U miratua udhëzimi që përcakton rregullat për trajnime të stafit dhe dokumentimin e rezultateve nga trajnimet apo kualifikimet e zhvilluara;
- Në kuadër të nxitjes dhe motivimit të punonjësve vetëm në vitin 2018 ka patur zhvillime pozitive në promovimin e punonjësve me aftësi shumë të mira

profesionale dhe rezultate të larta në punë. Kështu disa punonjësve të brendshëm mbi bazën e eksperiencës dhe kualifikimit të tyre u janë mundësuar pozicione më të larta të punës;

- U miratua udhëzimi “Për vlerësimin e performancës në punë të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” si një nga drejtimet kryesore të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- U miratuan ndryshime në Rregulloren nr. 129, datë 26.11.2016 “Për marrëdhëniet e punës së punonjësve në AMF”, e ndryshuar, duke përcaktuar qartë rregullat që lidhen me promovimin e punonjësve me përvojë dhe me aftësitë e duhura profesionale në një kategori më të lartë hierarkie në strukturën e Autoritetit.

## KRONOLOGJIA E NGJARJEVE MË TË RËNDËSISHME NË VITIN 2018

Disa nga ngjarjet më të rëndësishme për Autoritetin gjatë vitit 2018 përmbledhen në mënyrë kronologjike në tabelën e mëposhtme.

|                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Janar</b>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ U nënshkrua një Memorandum i ri Mirëkuptimi midis AMF-së dhe Autoritetit Italian të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, IVASS.</li> <li>➤ Me Vendimin e Bordit nr. 13, datë 31.01.2018 u licencua shoqëria WVP Fund Management Tirana sh.a. – shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive si dhe u miratua krijimi i dy fondeve të reja investimi.</li> </ul>                                                                                                                                                  |
| <b>Shkurt</b>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Më 22 shkurt 2018 Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE filloi zyrtarisht veprimtarinë e tregtimit.</li> <li>➤ Miratimi i Rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit të fondeve të investimit” me Vendimin e Bordit nr. 21, datë 06.02.2018.</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Mars</b>    | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Me Vendimin e Bordit nr.57, datë 29/03/2018 u miratua Rregullorja “Mbi transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar”.</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Prill</b>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Me Vendimin e Bordit nr. 72 u amendua Rregullorja nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, ku u përditësuan koeficientet e llogaritjes së shumës së kapitalizuar, si element i rëndësishëm në llogaritjen e vlerës së dëmshpërblimit.</li> </ul>                                                                                                                                                                                  |
| <b>Maj</b>     | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ U organizua Konferenca Kombëtare me titull: “Sfidat e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe edukimi financiar”.</li> <li>➤ Versioni përfundimtar i projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” u dërgua në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për ndjekjen e mëtejshme të procedurave deri në miratim.</li> </ul>                                                                                                                                                             |
| <b>Qershor</b> | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ U nënshkrua Memorandum Mirëkuptimi midis AMF-së dhe FSVK-së, pas miratimit nga Bordi i AMF-së, sipas Vendimit nr. 93, datë 13.06.2018.</li> <li>➤ Me vendimin e Bordit të Autoritetit nr. 97, datë 13.06.2018 u miratua “Manuali praktik për inspektimin e dëmeve motorike dhe të pronës”.</li> <li>➤ Në Tiranë, më 12.06.2018 u organizua Takimi i 15-të i Iniciativës Evropiano-Lindore dhe Juglindore e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, CESEE, ku Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u prezantua me dy punime.</li> </ul> |
| <b>Korrik</b>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Me Vendimin e Bordit nr. 143, datë 30.07.2018 u miratua krijimi i Fondit të Investimit “Raiffeisen Vizion” si dhe prospekti përkatës i tij.</li> <li>➤ Me Vendim Bordi nr. 140, datë 30.07.2018 u miratua “Manuali praktik për inspektimin e aktivitetit të risigurimit”, i hartuar me asistencën e Bankës Botërore.</li> </ul>                                                                                                                                                                                          |
| <b>Gusht</b>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ U përmbyll me sukses Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |

|                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                | Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, për paketën “Studimi i formës së ardhshme të Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë në Shqipëri”.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>Shtator</b> | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Në shtator të vitit 2018, Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) në bashkëpunim me Bankën Botërore organizoi për herë të parë në Shqipëri <i>workshopin</i> ndërkombëtar me temë “Mbikëqyrja me bazë rreziku”, nën kujdesin organizativ të AMF-së.</li> <li>➤ Në kuadër të rritjes së transparencës me publikun, si dhe zbatimit të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, për herë të parë Autoriteti ka publikuar në faqen zyrtare të internetit të dhënat për të gjitha shoqëritë e sigurimit me 2 treguesit kryesorë të aftësisë paguese dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike.</li> </ul> |
| <b>Tetor</b>   | ➤ Nënshkruhet Marrëveshja e bashkëpunimit midis Autoritetit dhe Bankës së Shqipërisë për Licencimin dhe Mbikëqyrjen e Sistemeve të Shlyerjes së Titujve dhe Shtëpive të Klerimit të Titujve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Nëntor</b>  | ➤ Përfundimi me sukses i Projektit të mikrosigurimit ”Akses në Iniciativën e Sigurimeve“ (A2ii), për sigurimet vullnetare gjithëpërfshirëse.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Dhjetor</b> | ➤ Organizimi për herë të parë në Tiranë i Kolegjeve Mbikëqyrëse Rajonale për mbikëqyrjen e grupit të sigurimit, në zbatim të udhëzimit metodologjik, miratuar me Vendim Bordi nr. 250, datë 28.12.2018.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |

## REKOMANDIMET E PROGRES-RAPORTIT TË BE-SË PËR SHQIPËRINË

Në Progres-Raportin e BE-së për vitin 2018, Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare” shkruhet:

*“Rregullat e BE-së synojnë sigurimin e konkurrencës së drejtë ndërmjet institucioneve financiare dhe stabilitetin e tyre, konkretisht në sektorin bankar, sigurimet, pensionet suplementare, shërbimet e investimit dhe tregjet e letrave me vlerë. Ato përfshijnë rregulla për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve. Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare. Janë bërë disa përparime në këtë fushë. Ka pasur disa përparime në mbikëqyrjen bankare dhe në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit me Direktivën e Solvency II.”*

**Në fushën e sigurimeve dhe pensioneve profesionale, ende duhet të miratohen ndryshime në Ligjin “Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”. AMF miratoi një legjislacion dytësor për ta harmonizuar më tej me Direktivat e Solvency I dhe Solvency II dhe filloi zbatimin e Strategjisë për konsumatorët dhe besimin e investitorëve në tregjet e mbikëqyrura. AMF ka riorganizuar strukturën e saj organizative dhe ka rekrutuar staf shtesë.**

Përparime janë bërë në infrastrukturën e tregut financiar me licencimin e bursën se parë shqiptare me kapital privat. Bursa publike mbetet e pezulluar.

Për sa i përket tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve të investimit, lëshimi i obligacioneve nga kompanitë është autorizuar për ofertat private për investitorët institucionalë, aksionarët ose individët e tyre.

Lidhur me përmbushjen e këtij rekomandimi Autoriteti që në vitin 2017 ngrii grupin e punës për hartimin e **projektligjit “Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”**, i cili u dërgua për ndjekjen e procedurave të miratimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.1654 prot., datë 08.05.2018. Gjatë hartimit të projektligjit, Autoriteti ka bashkëpunuar në vazhdimësi me Shoqatën e Siguruesve dhe ka marrë në konsideratë një pjesë të sugjerimeve dhe komenteve të tyre si dhe të Bankës Botërore.

**Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar””. Projektligji është dërguar në Ministrinë e Financave që në fund të vitit 2015 dhe ka kaluar të gjitha fazat e konsultimit me ministrinë dhe aktorët e tregut të pensioneve. Gjithashtu, sqarojmë se projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” dhe**



projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, që në kohën e hartimit dhe aktualisht janë të publikuar në faqen zyrtare të AMF-së, në linkun [www.amf.gov.al/legjislacioni/projektakte/projektligje](http://www.amf.gov.al/legjislacioni/projektakte/projektligje).

## **INFORMACION MBI ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR REZOLUTËN “PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE”**

AMF sipas rekomandimeve në Rezolutën “Për Vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, miratuar në Kuvendin e Shqipërisë në datë 21.06.2018, hartoi dhe miratoi në Bord planin e punës për zbatimin e tyre. Kjo rezolutë është përcjellë pranë AMF-së nëpërmjet shkresës së Kuvendit nr. 309/3 prot. datë 25.06.2018. Më poshtë po japim një informacion në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

- 1. Mbyllja brenda vitit 2018 e të gjitha inspektimeve me fokus rrezikun dhe hartimin e një raporti të qartë për rezultatet e këtyre inspektimeve në të gjitha shoqëritë e sigurimeve.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve  
**Afati:** Dhjetor 2018

**Plani i Veprimit:** Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve (DMTS) në zbatim të planit të punës të vitit 2018, të miratuar në janar 2018 nga Bordi i AMF përcaktoi përfundimin e inspektimeve me fokus rrezikun në 3 shoqëritë e sigurimit të Jetës. Në muajin dhjetor 2018 përfundoi cikli i parë i inspektimeve sipas metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun për tregun e sigurimeve Jo-Jetë dhe Jetë. Në mbledhjen e Bordit të AMF-së, datë 28.12.2018 u prezantua një raport i detajuar “Mbi rezultatet e inspektimeve sipas metodologjisë së inspektimit të plotë në vend me fokus rrezikun”.

- 2. Hartimi i skenarëve të qartë për zgjidhjen e problematikave në lidhje me Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe për Fondin e Kompensimit, duke përfshirë identifikimin e nevojave për ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore dhe hartimin e amendamenteve përkatëse me objektiv respektimin e të drejtave dhe trajtimin e barabartë të konsumatorëve, me synim ndalimin e ripërsëritjes së situatave si ato të kaluara.**

**Amendimet e pritshme ligjore për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike të sigurojnë zbatimin e masave stabilizuese në tregun e sigurimeve dhe vendosjen e standardeve të mirëpërcaktuara në lidhje me rezervat minimale, nivelin e likuiditetit, mjaftueshmërisë së kapitalit, praktikave të provigjonimit dhe përmirësimin në masa të arsyeshme të raportit dëme/prime.**

**Deri në miratimin e ligjit të ri për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, drejtuesit e AMF-së një herë në tre muaj do të raportojnë në Kuvend për gjendjen e Fondit të Kompensimit.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Çështjeve Juridike, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve.  
**Afati:** Gjatë vitit 2018  
**Plani i Veprimit:**

## **BSHS**

U hartua një plan i posaçëm për zgjidhjen e problematikave të Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe Fondin e Kompensimit. Është dërguar në muajin maj të vitit 2018 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Gjatë vitit 2018 u monitoruan zbatimet e vendimeve të Bordit lidhur me shlyerjen e detyrimeve që u përkasin shoqërive, publikimi i personave përfitues për praktikën e miratuara të papaguara administrative, kontrolli i pagesave të kryera sipas përfundimeve të inspektimit dhe shtesës së Fondit të Kompensimit. Janë propozuar në Bord dhe janë marrë masa ndaj shoqërive për rastet e konstatuara për moszbatim të vendimeve të AMF-së.

Në zbatim të Rregullores nr.2, datë 28.01.2010, e ndryshuar, për nxjerrjen e saktë të raporteve të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, në muajin janar të 2019 pranë BSHS-së funksionon Sistemi Elektronik i Administrimit të Dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, ku AMF ka të drejtë shikueshmërie për çdo rast, evidentimin e statusit të dosjes, në mbrojtje të interesave dhe të drejtave të konsumatorëve.

Lidhur me monitorimin e praktikave të përfunduara, AMF me vendimin nr. 156 datë 30.07.2018, ka bërë ndryshime të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, ku në nenin 6 pika 1.1 përcaktohet se nëse Byroja nuk bën shpërndarjen e praktikave të dëmeve të Fondit të Kompensimit tek shoqëritë e sigurimit, anëtarë të saj sipas vlerave respektive të detyrimit të tyre, shpërndarja për pagesë tek shoqëritë e sigurimit do të bëhet nga Autoriteti. Byroja brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni nga Autoriteti të shpërndarjes së praktikës do të vijojë me dërgimin e autorizimit dhe kopjen e praktikës tek shoqëria e sigurimit, e caktuar nga Autoriteti.

Masa të tjera të marra nga AMF janë:

- Ndjekja e proceseve gjyqësore për të cilat informohet nga Byroja, duke marrë pjesë si palë dëgjuese, në mënyrë që të verifikojmë ndjekjen e rregullt të proceseve;
- Miratimi i Drejtorit të ri të BSHS-së;
- Miratimi i disa rregulloreve nga ana e BSHS-së që lidhen me përmirësimin e procedurave të ndjekjes së praktikave, objekt i Fondit të Kompensimit.

## **Fondi i Kompensimit**

Për praktikat e Fondit të Kompensimit janë kryer 4 inspektime në vend në të gjithë shoqëritë e sigurimit dhe pranë BSHS. Përfundimet e dala nga inspektimi i kanë shërbyer përcaktimit të saktë të detyrimit të Fondit të Kompensimit si dhe pagesës së dëmeve, me qëllim mosakumulimin e tyre.

Strukturat e AMF-së kanë bërë monitorimin e ndarjes së praktikave të përfunduara të Fondit të Kompensimit, duke kërkuar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rregullores përkatëse.

Për Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave duke filluar nga data 26.09.2018, janë përgatitur informacione 2 javore lidhur me pagesat e Fondit të Kompensimit. Për vitin 2018 pagesat janë në vlerën mbi 1,009 milionë lekë, të cilat janë verifikuar me urdhërpagesat bankare gjatë inspektimit të kryer në janar 2019. Gjithashtu, në këtë inspektim janë verifikuar dhe marrëveshjet e lidhura nga shoqëritë e sigurimit, të cilat rezultojnë në vlerën prej rreth 205 milionë lekë. Janë kryer inspektime tematike në vend në të gjithë shoqëritë e sigurimit dhe tek BSHS, për praktikat që i përkasin dëmeve me objekt Fondin e Kompensimit, lidhur me autorizimet e lëshuara nga BSHS dhe konfirmimet e pagesave nga shoqëritë për vitin 2018 lidhur me detyrimet sipas vendimeve të Bordit të AMF-së.

Në muajin dhjetor 2018 Autoriteti ka miratuar vlerën e Fondit të Kompensimit për vitin 2019, vendim, i cili tashmë ka futur në normalitet Fondin e Kompensimit, duke zgjidhur problematikën e trashëguar që prej vitit 2002.

AMF po monitoron ndarjen e praktikave që përfundojnë te Fondi i Kompensimit, vendimet e formës së prerë të gjykatave në zbatim të afateve të përcaktuara në Rregulloren e administrimit të këtij fondi, pagesat sipas marrëveshjeve të deklaruara nga shoqëritë si dhe zbatimin e vendimeve të Autoritetit.

Autoriteti në zbatim të kërkesës së Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave ka dërguar informacion 2 javor mbi pagesat e Fondit të Kompensimit deri më 31 dhjetor 2018.

- 3. Të auditohen databasat e sistemeve dhe programeve aktualisht në përdorim të tregjeve të mbikëqyrur nga AMF, me qëllim evidentimin e problematikave dhe përmirësimin e tyre në funksion të aksesit të lirë, të barabartë dhe sigurimit të investitorëve si dhe të shqyrtohen opsionet e instalimit të kasave fiskale për të ndalur informalitetin në tregun e sigurimeve dhe realizuar fiskalizimin e plotë të tregut të sigurimeve.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacionale, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Njësia Auditimit të Brendshëm.

**Afati:** Gjatë vitit 2018

**Plani i Veprimit:** Gjatë muajit qershor u krye inspektimi në ambientet e shoqërive për shitjen e produkteve të tregut të sigurimeve. U verifikuan të dhënat që depozitohen dhe përpunohen në sistemet e tyre. Të dhënat e mbledhura u përpunuan dhe u krahasuan në dy nivele:

- Me raportimet e kryera *online* nga shoqëritë në sistemet e AMF-së për të evidentuar problematika të mundshme;
- Me sistemet e agjencive homologe të rajonit dhe në vendet perëndimore për të propozuar përmirësimin e tyre.

Në përmbushje të kësaj pike, krahas specialistëve të TI-së, u angazhuan dhe specialistë të Njesisë së Auditimit dhe të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve. Pas raportit final u hartua dhe u miratua ndryshimi i Rregullores nr. 23 të “Regjistrimit Elektronik Online të Shitjeve”, e cila detyron shoqëritë e sigurimeve të depozitojnë pranë AMF-së dokumentacionin teknik në lidhje me databasat dhe programet në përdorim, me qëllim rritjen e transparencës së sistemeve dhe sigurisë së tyre.

Në lidhje me opsionin e vendosjes së sasave fiskale pranë çdo pikë shitje, është dërguar shkresa nr. 2248 Prot., datë 26.6.2018 në Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për dijeni Komisionit të Ekonomisë dhe në datë 04.07.2018 është zhvilluar një takim me përfaqësues të Drejtorisë së Tatimeve për hapat e mëtejshëm. Njëkohësisht për këtë rekomandim janë njoftuar zyrtarisht edhe shoqëritë e sigurimit. Është komunikuar dhe me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë në vijim të shkresës së dërguar nga Shoqata nr.380 Prot., datë 22.10.2018. *Është kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të zbatojë më tej këtë rekomandim.*

**4. Të fillojë komunikimin urgjent me Ministrinë e Drejtësisë dhe me autoritetet përgjegjëse për fillimin e zbatimit të dy akteve që parashikojnë sigurim të detyrueshëm sipas Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, (neni 42 pika 9) dhe VKM 1109, datë 08.08.2008 në të cilën parashikohen siguri i detyrueshëm i punonjësve nga punëdhënësit që ushtrojnë veprimtari minerare.**

**T’i kërkohet Ministrisë së Drejtësisë që të plotësojë kuadrin e nevojshëm nënligjor duke parashikuar që kontratat e sipërmarrjes apo ato për shitjen e pasurive të paluajtshme në ndërtimet e reja, të parashikojnë kushte dhe afate për sigurimin e detyrueshëm sipas parashikimit të neni 42 pika 9 të Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.**

**Të kërkohet bashkëpunim me institucionet përgjegjëse që mbikëqyrin lejet dhe koncesionet në fushën minerare për sigurimin e të dhënave për të punësuarit në veprimtari minerare që përfitojnë nga e drejta për sigurim dhe të shqyrtohet mundësia që kjo kategori police dhe për pasojë edhe dëmet të raportohen drejtpërdrejt në AMF.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Çështjeve Juridike  
**Afati:** Gjatë vitit 2018

**Plani i Veprimit:** AMF në zbatim të këtij rekomandimi me qëllim ushtrimin e funksioneve të tij bazuar në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar, gjatë vitit 2018 ka komunikuar me institucionet si më poshtë:

### **Ministria e Drejtësisë**

- Janë dërguar shkresa me nr. 3159 Prot. datë 18.09.2018, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës për ndjekje të mëtejshme të procedurave për miratim të projektvendimit “Për sigurimin e detyrueshëm të rreziqeve në ndërtim dhe kontrollin e zbatimit të tij”. Projektvendimi për miratim në Këshillin e Ministrave është përgatitur nga ekspertë të AMF-së dhe Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë.

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 9587/1, datë 3.10.2018 ka kërkuar që projektvendimi të përcillet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës si ministri përgjegjëse. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës ka kërkuar të ngrihet një grup pune për këtë projektvendim. Gjithashtu janë bërë dhe takime me Ministrinë e Drejtësisë lidhur me këtë problem.

- Janë dërguar shkresat nr. 9851 Prot. datë 13.07.2018 dhe nr. 2422 Prot, datë 12.07.2018 Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës për monitorimin e detyrimit për sigurim sipas parashikimit të neni 42 pika 9 të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” si dhe VKM 1109 date 08.08.2008 në të cilën parashikohet sigurimi i detyrueshëm i punonjësve nga punëdhënësit që ushtrojnë veprimtari minerare.

*Në lidhje me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë konfirmohet nga Ministria zbatimi i akteve ligjore në fuqi. Detyrimi i shoqërive që zotërojnë leje minerare për kryerjen e sigurimit të punonjësve nga aksidentet në punë, ndiqet dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga institucionet e varësisë së Ministrisë.*

AMF lidhur me rekomandimin për mundësinë e raportimit online të policave të sigurimeve të punonjësve në miniera, ka filluar zbatimin e projektit për zhvillimin e këtij sistemi, i cili aktualisht është në fazën e testimit nga tregu dhe do të aplikohet brenda muajit maj 2019. Në këtë projekt është shtuar edhe raportimi *online* i sigurimit të pasagjerëve.

**Përveç sa më sipër Autoriteti ka dërguar shkresa edhe në institucione të tjera lidhur me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore:**

#### **Bashkive**

U janë dërguar shkresa të gjithë **Bashkive**, me objekt:

- Sigurimi i Jetës së punonjësve të Mbrojtjes kundër Zjarrit dhe Shpëtimit (MZSH).  
*Për punonjësit e zjarrfikësve nuk është miratuar ende një VKM në lidhje me sigurimin e Jetës së tyre. Kjo ka qenë përmbajtja e përgjigjeve të bashkive për këtë çështje.*
- Sigurimi i pasagjerëve në transportin publik.  
*Bashkitë kanë konfirmuar se po ushtrohen kontrole në mënyrë të vazhdueshme, për sigurimin e pasagjerëve në udhëtim gjatë procesit të licencimi. (Ky detyrim parashikohet në ligjin për sigurimin e detyrueshëm).*

#### **Ministritë së Brendshme**

Është dërguar shkresa nr. 3461 prot, datë 16.10.2018, Ministrisë së Brendshme me objekt:

- Sigurimi i Jetës së punonjësve të Mbrojtjes kundër Zjarrit dhe Shpëtimit (MZSH).

Projektvendimi i parë i Këshillit të Ministrave për sigurimin e Jetës së punonjësve të zjarrfikësve, u përgatit nga ana e Ministrisë së Brendshme, dhe iu paraqit për mendim AMF-së në vitin 2016 (kujtojmë se ligji që parashikon detyrimin për sigurimin e Jetës, ka hyrë në fuqi në 2015).

Aktualisht është hartuar një projekt VKM me efekte financiare 1.1.2019.

AMF i është drejtuar me shkresë Ministrisë së Brendshme (tetor 2018), për mbështetje e zhvillime më të shpejta drejt miratimit të VKM-së.

- Sigurimi i Jetës së punonjësve të policisë

Projektvendimi i parë i Këshillit të Ministrave për sigurimin e Jetës së punonjësve të policisë, u përgatit nga ana e Ministrisë së Brendshme, dhe ju paraqit për mendim AMF-së në vitin 2015 (kujtojmë se ligji që parashikon detyrimin për sigurimin e jetës, ka hyrë në fuqi në 2014).

Aktualisht është hartuar një projekt VKM me efekte financiare 1.1.2019.

AMF i është drejtuar me dy shkresa Ministrisë së Brendshme. Një shkresë trajton si sigurimin e jetës së punonjësve të policisë, ashtu edhe të punonjësve zjarrfikës

(u citua edhe më lart), ndërsa shkresa tjetër është dhënie mendimesh për projekt VKM-në e vitit 2018.

### **Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor Tiranë**

Është dërguar shkresa nr.2438 datë 13.07.2018, Zyrës së Administratës të Buxhetit Gjyqësor me objekt:

- Sigurimi i Jetës, shëndetit dhe pronës së gjyqtarëve të Shkallës së Parë dhe Apelit për Krimet e Rënda

Është nisur shkresë nga AMF dhe është kthyer përgjigje, ku konfirmohet aplikimi i këtij sigurimi në mënyrë të vazhdueshme.

### **Ministrisë së Drejtësisë**

Është dërguar shkresa nr. 2423 datë 12.07.2018, Ministrisë së Drejtësisë me objekt:

- Sigurimi i përgjegjësisë nga noteri ndaj palëve të treta për shkak të veprimtarisë noteriale

Ministria ka konfirmuar se në ushtrim të kompetencës mbi kontrollin e veprimtarisë ligjore të noterëve, kryen kontrole periodike lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tyre, përfshirë dhe respektimin e nenit 25 të ligjit ku parashikohet se “noteri duhet të lidhë kontratë sigurimi për përgjegjësinë e tij ndaj palëve të treta për shkak të veprimtarisë noteriale”.

### **Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Ministrisë së Infrastrukturës e Energjisë**

Është dërguar shkresa nr.1769/2, datë 12.07.2018, Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial, Ministrisë së Infrastrukturës e Energjisë me objekt:

- Sigurimi nga operatorët e tregtimit me shumicë e pakicë i përgjegjësive ligjore për dëmet që mund t'u shkaktojnë palëve të treta

I janë nisur shkresa, në lidhje me:

- Përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve dhe të licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj;
- Përcaktimin e kushteve teknike për përpunimin e bombulave të mbushura me gaz të lëngshëm.

Nga ana e tyre është konfirmuar monitorimi i të gjitha proceseve në mbështetje të akteve ligjore në fuqi, të cilat i detyrojnë të gjithë operatorët e tregtimit me shumicë e pakicë të kryejnë sigurimin e përgjegjësive ligjore për dëmet që mund t'u shkaktojnë palëve të treta. Gjithashtu, ato detyrojnë konsumatorin jo familjar që përdor bombula gazi të pajiset me kontratë sigurimi nga një shoqëri sigurimi, për të garantuar rimbursimin e dëmeve të shkaktuara ndaj palëve të treta.



## **Ministrisë së Turizmit e Mjedisit**

Është dërguar me shkresën nr. 2867, datë 17.08.2018 projektudhëzimi “Për kushtet dhe procedurat e lidhjes së kontratës së sigurimit të përgjegjësisë për palët e treta”, nga operatorët turistikë si dhe kufijtë e këtyre përgjegjësisë.

Nuk ka përgjigje zyrtare, por ka komunikim me e-mail në nivel teknik.

## **Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë (SH.S.SH)**

Janë depozituar shkresa të Shoqatës dërguar në AMF, katër shkresa në datat 19.9.2018; 28.9.2018, 02.10.2018; 03.10.2018 me objekt:

- Propozim për rishikimin e taksës mbi primin për produktet e sigurimit Jo-Jetë;
- Për aplikimin e produkteve siguruese në bujqësi;
- Mbi problemin e vendosjes së kasave pranë shoqërive të sigurimit.

AMF në vijim të këtyre shkresave i është drejtuar Ministrisë së Bujqësisë për aplikimin e produkteve të sigurimit në bujqësi dhe Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Tatimeve për vendosjen e kasave pranë shoqërive të sigurimit si dhe kryerjen e veprimeve financiare vetëm nëpërmjet sistemit bankar.

5. **Të pasqyrohen dhe publikohen në një gjuhë të qartë për publikun pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit dhe analizat financiare të Autoritetit të cilat shqyrtojnë aftësinë paguese, mjaftueshmërinë e kapitalit si dhe të dhëna të tjera të cilat ndihmojnë publikun në identifikimin e shoqërisë së sigurimeve me të cilën zgjedhin të kontraktojnë.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve  
**Afati:** Gjatë vitit 2018

**Plani i Veprimit:** Për herë të parë në faqen web të AMF-së, në seksionin “ Publikime/ Të dhëna tekniko-financiare” në muajin shtator 2018, janë publikuar të dhënat për të gjitha shoqëritë e sigurimit, ku përfshihet totali i aktiveve-pasiveve të shoqërisë së sigurimit, prime të shkruara bruto, rezultati financiar neto, aftësia paguese dhe aktive në mbulim të provigjoneve teknike. Këto të dhëna tekniko-financiare janë publikuar të detajuara edhe në Raportin e Mbikëqyrjes për vitin 2017, ndërkohë që gjatë vitit 2018 janë pasqyruar edhe në linkun [https://amf.gov.al/ts\\_tekniko\\_financiare.asp](https://amf.gov.al/ts_tekniko_financiare.asp).

6. **Të vijohet me vendimmarrjen në lidhje me tre shoqëritë e sigurimeve që nuk kanë plotësuar rregullisht detyrimin për kontributin në Fondin e Kompensimit. Vendimmarrja e Autoritetit sa i takon vendosjes së ndëshkimeve administrative, nuk mund të pengohet nga refuzimi i Drejtuesve të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve për t’i propozuar Autoritetit marrjen e këtyre masave.**

**Autoriteti të zbatojë procedurat e Kodit të Procedurave Administrative që rregullojnë kompetencën për vendimmarrje nga një organ epror në rastet kur organi refuzon ose me mosveprim nuk plotëson detyrimin ligjor për nxjerrjen e aktit administrative.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Çështjeve Juridike, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve,  
**Afati:** Gjatë vitit 2018

**Plani i Veprimit:** Bordi i Autoritetit në mbledhjen e datës 30 korrik 2018, ka analizuar ecurinë e pagesave të Fondit të Kompensimit si dhe marrëveshjet e bëra për pagesë nga shoqëritë e sigurimit.

Në këto kushte, duke shqyrtuar dhe ecurinë e pagesave të cilat paraqiteshin me ritme të ulëta bazuar në pikën 3, të nenit 52 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar, me vendimet nr. 160 dhe 161 datë 30.07.2018, janë sanksionuar dy shoqëri sigurimi për shkelje të nenit 45, pika 2 të këtij ligji, ndërsa një shoqëri ka fituar procesin gjyqësor ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimit për Fondin e Kompensimit.

Përsa i përket përdorimit të dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative për marrjen e funksioneve të BSHS-së, pas disa analizave dhe propozimeve në Bord është arritur të miratohet drejtori i ri i BSHS-së, i cili aktualisht po drejton veprimtarinë e këtij enti.

**7. Të plotësohet brenda Korrikut rekomandimi për sa i takon verifikimit të algoritmit duke referuar rregullimin në rregulloren përkatëse të miratuar nga Autoriteti si dhe të merren masa për parandalimin e krijimit të skemave të tilla për produkte të tjera të tregut të sigurimeve. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoriteti i Konkurrencës të thellojnë bashkëpunimin për këtë çështje, me qëllim rivendosjen e transparencës dhe konkurrencës në treg.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacionale, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Departamenti i Çështjeve Juridike.  
**Afati:** Korrik-Gusht 2018

**Plani i Veprimit:** Zbatimi i këtij rekomandimi filloi me inspektimet mbi sistemet e shitjeve pranë çdo pike shitje dhe u evidentua nëse ka të instaluar sisteme që lidhen me algoritmin e sipërcituar. U kërkuar bashkëpunimi me AKSHI-n në lidhje me verifikimin e algoritmit. U përgatit dhe u dërgua shkresa për Autoritetin e Konkurrencës datë 28.06.2018, për një takim të përbashkët midis 2 institucioneve. Autoriteti i Konkurrencës ka kthyer përgjigje që nuk është i nevojshëm takimi por ka kërkuar përfundimet e inspektimit.

U përgatit dhe u dërgua pranë Autoritetit të Konkurrencës raporti final i inspektimeve nr. 2375/2 Prot. datë 31.08.2018 me konstatimet dhe propozimet përkatëse si dhe në shkresën pasardhëse nr. 3602/2 Prot., datë 14.11.2018 u komunikuan masat e marra nga AMF. Në vijim të propozimeve u hartua dhe u miratua ndryshimi i Rregullores nr. 23 të Regjistrimit Elektronik Online të Shitjeve, e cila detyron shoqëritë e sigurimeve të ofrojnë mundësinë e lidhjes së drejtpërdrejtë me sistemin e shitjeve të AMF, me qëllim rritjen e transparencës së raportimit të policave të sigurimit të detyrueshëm.

Nisur nga ndjeshmëria publike dhe shqetësimet e shfaqura herë pas here dhe konstatimet që kanë dalë nga puna e përditshme, Autoriteti ka nisur disa shkresa: Nr. 1416/1 datë 27.04.2018 “Mbi një ankesë të depozituar në AMF”, Nr. 1725 prot, datë 14.05.2018 dhe Nr. 1725/2 Prot, datë 22.05.2018 “Mbi inspektimin te ndërmjetësit në sigurime”, në pikën kufitare të Hanit të Hotit, si dhe Nr. 1789 Prot, datë 18.05.2018 dhe Nr. 2143 Prot, datë 18.06.2018 “Mbi inspektimin te ndërmjetësit në sigurime” Bankat–Broker. Pas këtyre njoftimeve Autoriteti i Konkurrencës ka hapur hetimet dhe ka marrë vendimet përkatëse.

Në zbatim të Vendimit të Autoritetit të Konkurrencës Nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik TPL e brendshme”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ngriti grupin e punës për ndjekjen dhe realizimin e tyre si dhe ka raportuar pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Megjithatë në ushtrim të kompetencave në zbatim të nenit 41 të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” AMF ka kërkuar gjithmonë bashkërendim të veprimeve dhe në gjykimin tonë rezulton se pothuajse të gjitha rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës janë pikërisht gjetjet që AMF i ka referuar këtij Autoriteti nga inspektimet e kryera si dhe i kemi kërkuar të vlerësonin problematikat e tregut të sigurimeve për një hetim të plotë dhe shterues të tij për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

**8. Të auditohet situata e raportimeve të gabuara për sa i takon Fondit të Kompensimit, të identifikohen përgjegjësitë dhe të merren masa administrative apo edhe të tjera për personat që kanë përpiluar dhe lejuar publikimin dhe shpërndarjen e tabelave të pasakta apo të falsifikuara.**

**Struktura Përgjegjëse:** Njësia e Auditit të Brendshëm, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve,  
**Afati:** Gjatë vitit 2018

**Plani i Veprimit:** Pas përfundimit të auditimit të BSHS, që përfshin auditimin e veprimtarisë së Byrosë në lidhje me detyrimet e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, për periudhën 01.01.2001-31.12.2017 nga shoqëria e përzgjedhur audituese, Grand Thornton shpk, në zbatim të Vendimit të Bordit nr. 218, datë 28.02.2018, do të analizohet raporti dhe do të propozohen masa për personat përgjegjes në lidhje me problematikat e evidentuara. Autoriteti është ende në pritje të depozitimit të Raportit përfundimtar të auditimit. Njëkohësisht jemi duke pritur raportin përfundimtar të KLSH për performancën

e AMF, ku pjesë e auditimit ishte dhe Fondi i Kompensimit si dhe raporti përfundimtar i auditit të brendshëm për këtë çështje.

Megjithatë AMF lidhur me situatën e Fondit të Kompensimit ka marrë dy vendime për ish drejtorin e BSHS përkatësisht: Vendimi Nr.86, datë 07.05.2018 për sanksion me gjobë ndaj tij, si dhe Vendimin Nr.88, datë 01.06.2018 për refuzimin e kërkesës për miratimin e tij si drejtor i BSHS.

**9. Të hartohet metodologjia e mbikëqyrjes së grupit, duke ju referuar rasteve të kompanive të sigurimit që kanë dege apo filiale në shtete të tjera.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve  
**Afati:** Gjatë vitit 2018

**Plani i Veprimit:** Zbatimi i këtij rekomandimi u realizua në bashkëpunim me asistencën teknike të FSVS (22-26 tetor 2018), për organizimin e kolegjeve mbikëqyrëse rajonale të Ballkanit. U miratua në mbledhjen e Bordit të AMF datë 28.12.2018, udhëzimi metodologjik “Për mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”. Ky udhëzim përcakton rregullat dhe format specifike të një sistemi bashkëpunimi midis institucioneve mbikëqyrëse, si Kolegje Mbikëqyrës të Grupit të Sigurimit, me qëllim shkëmbimin e informacionit në funksion të mbikëqyrjes efektive në nivel grupi për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit të cilat kanë investime të tyre apo degë në vende të huaja. Takimet e kolegjeve do të jenë 4 herë në vit.

**10. Të dilet me vendim për sa i takon kandidaturës së propozuar për Drejtor të Byrosë Shqiptare dhe të zgjidhet situata në përputhje dhe në zbatim të ligjit.**

**Struktura Përgjegjëse:** Bordi i AMF  
**Afati:** Brenda muajit korrik 2018

**Plani i Veprimit:** Me vendimin e Bordit nr. 88, datë 01.06.2018 është refuzuar propozimi i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të BSHS-së, për miratimin e drejtorit të mëparshëm, si Drejtor Ekzekutiv i Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Me vendimin Nr. 105 datës 18.07.2018 u miratua Drejtori i ri Ekzekutiv i BSHS.

**11. Në funksion të inkurajimit dhe rritjes së besimit të konsumatorit në rolin e AMF-së, të merren masa të posaçme të karakterit informues dhe edukues të publikut për investimin në tituj, në lidhje me rrezikun që mbartin këto lloj investimesh dhe veprimtaritë e pa licencuara apo në kundërshtim me ligjin, të shoqërohen nga AMF me vendimmarrje dhe reagime të shpejta dhe institucionale.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Çështjeve Juridike/Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Kapitaleve  
**Afati:** Gjatë vitit 2018

**Plani i Veprimit:** U zbatua plani i veprimit i hartuar në funksion të strategjisë trevjeçare “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”, i cili përmban aktivitete informuese në media e jo vetëm dhe përfshirje në kurikulat mësimore në arsimin para universitar me fokus tregun e titujve. Po vazhdon bashkëpunimi i nisur me Ministrinë e Arsimit në këtë drejtim.

Është realizuar akses *online* për ankesat që mund të kenë konsumatorët për shërbimet që përfitohen nga tregjet nën mbikëqyrje.

Gjithashtu publiku informohet rregullisht nëpërmjet faqes zyrtare të Autoritetit lidhur me rreziqe të mundshme të investimeve në tregun e titujve. Së fundmi Autoriteti ka shtuar dhe Rubrikën **KINI KUJDES**, tek e cila publiku informohet rregullisht, nëpërmjet paralajmërimeve, në lidhje me rrezikun e veprimtarive në fushën e titujve si dhe veprimtari të pa licencuara apo në kundërshtim me ligjin.

Gjatë vitit 2018 në këtë link janë publikuar materialet informuese e edukuese në fushën e titujve si më poshtë:

- Investitorë kujdes ndaj aktivitetit të shoqërisë Fortrade;
- Paralajmërim mbi riskun e investimit në instrumentin “Kontratë për diferencë” (CFD);
- ESMA vendos ndalimin e opsioneve binare si dhe kufizimin e Kontratave për diferencë me qëllim mbrojtjen e investitorit;
- Mbi rreziqet e përdorimit të monedhave virtuale me ofertë fillestare (ICO);
- Investitorë Kujdes ndaj aktivitetit të shoqërisë me emrin FXLider.

Duke pasur në vëmendje rëndësinë për rritjen e edukimit financiar, Autoriteti është angazhuar në veprime konkrete. Edhe gjatë vitit 2018 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka vijuar punën me organizimin e aktiviteteve për zbatimin e Strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje (tetor 2017– tetor 2020)”.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme të kryera nga Autoriteti janë:

Në muajin maj 2018 u zhvillua me sukses dhe pati ndikim pozitiv Konferenca Kombëtare me titull: “Problemet dhe sfidat e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje dhe rëndësia e edukimit financiar”. Në këtë konferencë morën pjesë studentët e Universiteteve të ndryshme, të cilët kontribuan me punimet e tyre apo stafi akademik për çështje të lidhura me tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Gjatë vitit 2018 stafi i AMF-së ka vijuar të jetë prezent në universitete të ndryshme në vend, duke prezantuar institucionin, veprimtarinë e tij si dhe tregjet që mbikëqyren nga AMF, nëpërmjet leksioneve të hapura dhe bashkëbisedimeve. Në universitete janë kryer

anketime nëpërmjet pyetësorëve të cilët mundësojnë mbledhjen e të dhënave rreth nivelit të njohurive të studentëve për AMF-në dhe tregjet nën mbikëqyrje. Këto aktivitete janë finalizuar me nënshkrimin e MoU-ve përkatëse me 7 universitete publike dhe private. Gjithashtu Autoriteti ka ofruar kryerjen e *internshipëve* në AMF për 9 studentë gjatë vitit 2018, si dhe ka koordinuar procesin për mundësimin e kryerjes së praktikave për rreth 300 studentë pranë subjekteve nën mbikëqyrje të AMF-së për vitin 2019.

AMF ka vijuar bashkëpunimi dhe ka rritur prezencën në media të stafit dhe ekspertëve në fushat respektive.

Janë përgatitur dhe publikuar materiale informuese nga ana e AMF si më poshtë:

- Hartim i broshurave informuese (Sigurimi i pronës, Sigurimi i shëndetit; Tregu i Sigurimeve).
- Materiale informative të publikuara në faqen e AMF-së (Tregu i sigurimeve “Pyetjet më të shpeshta”, Çfarë duhet të ketë kujdes konsumatori)

Në vitin 2018 janë nxitur shoqatat për të rritur rolin e tyre përsa i përket edukimit financiar të publikut, të cilat kanë filluar të ushtrojnë aktivitete në publik dhe në media.

**12. Të merren masat e duhura që ligjet e reja që rregullojnë veprimtarinë e tregut të investimeve në tituj mbi kapitalin, të mos referojnë zbutje të kriterëve për licencim të subjekteve që kërkojnë të pajisen me licencë për ushtrim veprimtarie në tregun e titujve mbi kapitalin, apo dobësim të kërkesave për transparencë. Kuadri i ri ligjor, të synojë kufizim apo ndalim të zhvillimit të skemave të investimit jashtë tregjeve të licencuara të paktën për një periudhë pesë vjeçare si dhe një periudhë ndalimi tre deri në pesë vjeçare të lejimit të skemave alternative të investimeve të njohura si skema spekulative me risk të lartë.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Çështjeve Juridike/Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Kapitaleve

**Afati:** Gjatë vitit 2018

**Plani i Veprimit:** Projektligji i ri për titujt i cili është publikuar për konsultim publik ka reflektuar moszbutjen e kriterëve për licencim për firmat e investimeve që operojnë në fushën e tregjeve të kapitalit. Përsa i përket pjesës së dytë të rekomandimit, në projektligjin e ri “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” në lidhje me fondet e investimit, ky rekomandim është pasqyruar tërësisht. Të gjitha sipërmarrjet e investimeve kolektive në letra me vlerë të transferueshme duhet të investojnë brenda kornizave të tregut të rregulluar.

Është shtuar dispozita tranzitore në nenin 240 pika 1, sipas formulimit “**Një fond i investimeve alternative nuk mund të regjistrohet nga Autoriteti, sipas këtij ligji përpara 5 vjetëve nga data e miratimit të këtij ligji**”.

**13. Të rishikohen tarifat që detyrohen të paguajnë subjektet e licencuara, deri në masën që i nevojiten Autoritetit për të siguruar vetë-financimin pas plotësimit të investimeve të domosdoshme në regjistrin online elektronik të sigurimit të detyrueshëm motorik.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Kapitaleve, Departamenti i Çështjeve Juridike,  
**Afati:** Gjatë vitit 2018

**Plani i Veprimit:** U ngrit grupi i punës i cili verifikoi tarifat aktuale dhe propozoi tarifat e reja në përputhje dhe me kuadrin ligjor në fuqi si dhe me nevojat për funksionimin normal të aktivitetit të AMF-së. Ndryshimi i këtyre tarifave rezultoi me ulje të tyre, e cila u reflektua në buxhetin e AMF-së.

**14. Në rregulloret e brendshme të Autoritetit, të përshkruhet qartë nga njëra anë përgjegjësia e Autoritetit në raport me Qendrën e Edukimit për sa i takon hartimit të kurikulave dhe nga ana tjetër mënyra e financimit të Qendrës së Edukimit, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi për sa i takon financimit dhe përdorimit të fondeve të Autoritetit”.**

**Struktura Përgjegjëse:** Departamenti i Çështjeve Juridike  
**Afati:** Gjatë vitit 2018

**Plani i Veprimit:** Në lidhje me statusin e Qendrës së Edukimit, sqarojmë se referuar strukturës organizative të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të miratuar në qershor 2017, Qendra e Edukimit nuk është pjesë e kësaj strukture. Trajnimet kryhen nga vetë Autoriteti, i cili në vijim do të vendosë linjat e bashkëpunimit me grupet e interesit jashtë institucionit për të evidentuar institucionet dhe strukturat e përshtatshme që do të sigurojnë formimin profesional të drejtuesve dhe profesionistëve për fushat që licencohen e mbikëqyren nga Autoriteti dhe përmbushjen e kërkesave për trajnime për delegimin e tyre.

Me anë të vendimit të Bordit Nr. 164 datë 30.07.2018 u miratuan kurikulat për programet e kualifikimit profesional. Nga ana tjetër me vendimin Nr. 163 datë 30.07.2018 të Bordit të AMF-së, u shfuqizuan tarifat që i ngarkoheshin profesionistëve që licencohen/miratojnë nga Autoriteti për trajnimet e kualifikimit profesional bazë dhe në vazhdimësi që kryhen nga Autoriteti. Shfuqizimi i këtyre tarifave vjen në përputhje me ligjin “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” sa i përket financimit dhe përdorimit të fondeve të Autoritetit.

## **MASAT E MARRA NGA AUTORITETI NË ADRESIM TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA KOMITETI MONEYVAL I KE**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit ka krijuar strukturën e nevojshme për koordinimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve, në mënyrë efektive. Kjo strukturë e posaçme për PPP/LFT, është ngritur pranë Departamentit të Çështjeve Juridike, në Drejtorinë e Zbatueshmërisë.

Gjatë periudhës 2016-2018, AMF është angazhuar intensivisht në procesin e raundit të V-të të vlerësimit të vendit tonë nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës, në lidhje me masat e marra kundër PP/FT. Procesi u zhvillua në disa faza si: dërgimi dhe plotësimi i pyetësorëve nga autoritetet e vendit, vizita në vend e grupit të ekspertëve vlerësues dhe takimi i tyre me aktorët publik e privat përgjegjës për çështjet e PP/FT, takimi me grupin e ekspertëve pas draftit të parë të raportit, dhënia e komenteve të vazhdueshme nga autoritetet për draftet e ndryshme të raportit, mbledhja e komenteve nga rrjeti ndërkombëtar i PP/FT dhe përgatitja e argumenteve me shkrim për gjetjet e tyre e më pas diskutimi në seancën plenare të Komitetit MONEYVAL i raportit dhe miratimi i tij nga ky Komitet. Raporti i vlerësimit u miratua në seancën e 56-të plenare të Komitetit MONEYVAL, të zhvilluar në Strasburg në datat 3-6 korrik 2018.

Raporti i Komitetit të Ekspertëve për vlerësimin e masave për PPP/FT, MONEYVAL, la rekomandime për Shqipërinë, në adresim të të cilave u morën një sërë masash nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Më 4 shtator 2018, Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave, miratoi planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL dhe AMF u angazhua aktivisht në adresimin dhe përmbyshjen e këtyre rekomandimeve.

Masat e marra u shoqëruan me ndryshime në aktet Rregullatore të AMF-së, si më poshtë vijon:

*Rregullore nr. 79, datë 31.08.2015 "Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës", u ndryshua me Vendim Bordi nr. 215, datë 31.10.2018;*

*Rregullore nr. 165, datë 23.12.2008 "Për Licencimin e Shoqërive të Brokerimit/ Këshillimit, Brokerit dhe Këshilltarit të Investimeve", u ndryshua me Vendim Bordi nr. 218, datë 31.10.2018;*

*Rregullore nr. 69, datë 26.05.2011 "Për autorizimin e individëve për shitjen e kuotave/aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike", u ndryshua me Vendim Bordi nr.235, datë 26.11.2018;*



*Rregullore nr. 114, datë 11.09.2008 "Për Konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", u ndryshua me Vendim Bordi nr. 47, datë 20.12.2018;*

*Rregullore nr. 58, datë 30.06.2015 "Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", u ndryshua me Vendim Bordi Nr. 24, datë 26.02.2018, me anë të të cilit u shtua Aneks 4 dhe 5, formularët e vetëvlerësimit për subjektet. Nga kategorizimi i riskut në bazë të formularëve të vetëvlerësimit të depozituar në Autoritet për vitin 2017 (off-site), rezultoi nivel i ulët risku; Rregullorja nr. 58 u ndryshua sërish me Vendim Bordi nr. 214, datë 31.10.2018, duke shtuar Udhëzuesin "Për matjen e Rrezikut nga Pastrimi i Parave dhe Financimi i terrorizmit";*

Manuali i Mbikëqyrjes për PPP/FT është ndryshuar me Vendim Bordi nr. 34, datë 27.03.2019, duke shtuar dhe mbikëqyrjen e fondeve të investimeve.

Një kontribut të rëndësishëm për hartimin me sukses të Manualit dhe Udhëzuesit për një vlerësim më të mirë të rrezikut kanë dhënë ekspertët e SECO-s, të cilët kanë dhënë asistencë të vazhdueshme, sidomos në tregun e kapitalit.

Në kuadër të adresimit të rekomandimeve, Autoriteti, ka shtuar inspektimet për PPP/FT, pothuajse në të gjitha subjektet që mbikëqyr. Plani i Inspektimit ashtu sikurse dhe Plani i Veprimit i është dërguar edhe DPPPP-së në mënyrë që të realizohet një koordinim sa më i mirë ndërmjet dy institucioneve. Vetëm gjatë vitit 2018, janë kryer 13 inspektime. Inspektimet janë kryer në bashkëpunim me DPPPP por edhe veçmas nga Autoriteti.

AMF, ka vijuar të mbajë korrespondenca të vazhdueshme me DPPPP-në edhe për subjektet që kërkojnë të licencohen nga Autoriteti. Gjatë vitit 2018, janë dërguar 8 shkresa, DPPPP-së, nga të cilat, kemi marrë përgjigjet përkatëse.

Theksojmë se, fuqizimi dhe bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit e më gjerë kanë qenë në fokus të punës së Autoritetit.

Autoriteti ka marrë asistencë nga Bashkimi Europian dhe Këshilli i Europës në kuadrin e projektit "*Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë*".

AMF është anëtar i Komitetit Drejtues të projektit "Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri". Në kuadër të këtij projekti Autoriteti ka marrë pjesë në trajnime (konferenca, *workshope*), brenda vendit, me tema të ndryshme si: "Mbikëqyrja me bazë rrezikun, si një mbikëqyrje efektive"; "Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse"; "Konferenca ndërkombëtare për transparencën e pronarit përfitues", etj.

Përfaqësues nga Autoriteti kanë marrë pjesë dhe në trajnimin e organizuar nga Akademia e Legjislacionit Evropian (*Academy of European Law*), ERA, në Trier, Gjermani, me temë “Parandalimi i pastrimit të parave dhe shërbimet financiare në BE”.

## **INSPEKTIMET**

AMF, gjatë vitit 2018 ka rritur ndjeshëm inspektimet për tregjet e mbikëqyrura duke realizuar 76 inspektime, kundrejt 22 të realizuara gjatë vitit 2017. Këto inspektime kanë qenë inspektime të plota, me bazë rrezikun, inspektime tematike, inspektime në funksion të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe inspektime për Fondin e Kompensimit. Disa prej tyre janë realizuar edhe në bashkëpunim me institucione të tjera si Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP) apo Banka e Shqipërisë.

Viti 2018 shënon përmbylljen e ciklit të parë të plotë të inspektimeve sipas metodologjisë me fokus rrezikun në të gjithë tregun e sigurimeve bazuar në Manualin e Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku të Shoqërive të Sigurimit. AMF vijoi edhe me kryerjen e gjashtë inspektimeve tematike në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës duke rritur kështu numrin e këtyre inspektimeve krahasuar me vitin 2017.

Fokusi i inspektimeve tematike lidhet me verifikimin e procesit të trajtimit të dëmeve, bazuar në “Manualin praktik të trajtimit të dëmeve”, i përgatitur me asistencën e Bankës Botërore dhe miratuar nga Bordi i Autoritetit në qershor 2018.

Nga inspektimet e kryera u konstatuan raste të moszbatimit të kërkesave rregullatore në fuqi, lidhur me përcaktimin e koeficientit të humbjes së aftësisë për punë, provigjoni i dëmeve pezull, mangësi të procedurave në rregulloret e brendshme të shoqërive të sigurimit për trajtimin e dëmeve.

Gjithashtu, në tregun e kapitaleve dhe fondeve, u krye një inspektim tematik dhe një inspektim i plotë me fokus rrezikun në një prej bankave depozitare, që është depozitar i katër fondeve të investimeve dhe një fondi pensioni. Ky inspektim u realizua në bashkëpunim me DPPPP.

Gjetjet nga inspektimet e kryera konsistuan në masat për zbatimin e kërkesave rregullative, në përshtatjen e sistemeve informatike, si dhe në lidhje me penalitetet që duhet t’i mbahen investitorit/anëtarit të fondit në përputhje me kërkesat ligjore.

U realizuan inspektime në vend pranë tri shoqërive që kryejnë veprimtarinë e agjentit për llogari të shoqërive të huaja të brokerimit, si edhe një inspektim në vend pranë një shoqërie (bankë) me objekt kryesor veprimtarinë e shërbimit të kujdestarisë për titujt e Qeverisë, si dhe respektimin e rregullave në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër terrorizmit.

Rekomandimet për agjentin konsistuan në zbatimin e kërkesave rregullatore, çështje të qeverisjes së shoqërisë, politikën e shpërblimit, etj. Në lidhje me aktivitetin e kujdestarisë, rekomandimet konsistuan në zbatimin e rregullave mbi ndarjen e aseteve të shoqërisë.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të vendimeve të Bordit të Autoritetit u kryen dy inspektime tematike në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës me objekt “Verifikimin e zbatimit të kërkesave të Vendimit të Bordit të Autoritetit”.

Në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet financiare brenda vendit, Autoriteti në vitin 2018 ka realizuar shtatë inspektime të përbashkëta me to, krahasuar me dy inspektime që janë kryer në vitin 2017.

Në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, për herë të parë, u kryen 12 inspektime pranë të gjitha shoqërive të brokerimit, tre bankave broker. Inspektimet u fokusuan në dy drejtime kryesore: mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe përmbushja në mënyrë të vazhdueshme të kushteve të licencimit. Nga inspektimet e kryera u lanë rekomandimet përkatëse, mbi bazën e konkluzioneve të dala për çdo shoqëri, me qëllim marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e situatës. Autoriteti gjatë 2019, ka planifikuar monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë këtyre inspektimeve.

## **ZBATIMI I REKOMANDIMEVE NGA INSTITUCIONE TË TJERA**

Gjatë vitit 2018 AMF ka patur rekomandime nga Autoriteti i Konkurrencës.

Me vendimin Nr. 561 dt. 15.01.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme” Autoriteti i Konkurrencës, vendosi:

T’i rekomandojë AMF-së që brenda afatit 90 ditor:

- a. Të miratojë primin e rrezikut për çdo kompani sigurimi mbështetur në raportin e përgatitur nga aktuari i kompanisë duke mos miratuar dhe orientuar një prim rreziku të njëjtë për të gjithë tregun e MTPL;
- b. Të verifikojë nëse tregtimi i TPL në sistemet e tyre të shitjeve është në përputhje me rregullat e sjelljes së tregut të miratuara nga AMF, me qëllim shmangien e pasojave të padëshiruara për konkurrencën në treg;
- c. Të marrë masat për ndalimin e tregimit të policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
- d. Të marrë masat për të lejuar shfaqjen në sistemet e tregimit që përdoren nga agjentët vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit vepron;
- e. Të ndalojë agjentët të tregtojnë për llogari të kompanive të tjera të sigurimit, për të cilat nuk janë të licencuar;
- f. Në sistemet e tregimit të policave të sigurimit të detyrueshëm të shmangen ndërhyrjet që nuk janë në përputhje me aktet nënligjore dhe rregullat e vendosura nga AMF, me qëllim shmangien e një koordinimi të mundshëm të sjelljes midis ndërmarrjeve konkurrense;
- g. Të parashtrojë përpara Autoritetit të Konkurrencës duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore për çdo rast për të cilin konstaton sjellje antikonkurrense nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

Në zbatim të Vendimit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik TPL e brendshme”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ngriti grupin e punës për ndjekjen e tyre.

Vlen të theksohet që në fillim se në vijim të angazhimit për zbatimin edhe të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së AMF-së për vitin 2017”, AMF ka realizuar një seri inspektimesh me tematika që lidhen me çështje të cilat janë trajtuar dhe në vendimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Më konkretisht, gjatë muajit korrik 2018, AMF realizoi inspektimin “Për verifikimin e sistemeve të shitjes së policave në tregun e sigurimeve”.

Ashtu sikurse është përmendur edhe në raportin e dërguar drejt Autoritetit të Konkurrencës me shkresën 2375/2 datë 31.08.2018 për gjetjet nga verifikimi i kryer për sistemin e shitjes së policave të sigurimit pranë agjentëve, ndërmjetësve dhe zyrave qendrore të shoqërive të sigurimit, “Sistemi elektronik i kontratave të sigurimit të detyrueshëm”, shërben si sistem raportimi i policave të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe jo si sistem i shitjeve të tyre.

Ky sistem nuk gjurmon rrugën e shitjeve të policave si dhe nuk mund të administrojë këtë proces duke filluar nga momenti i lëshimit të policës nga sistemet e shitjeve pranë shoqërive deri në raportimin e policave në sistemin e AMF-së.

Për këtë arsye, plani i punës në zbatim të rekomandimeve lidhet kryesisht me inspektimin në terren nëpër pikat e shitjeve si dhe inspektime në sistemet e shitjeve që vetë shoqëritë e sigurimit administrojnë apo dhe ndërmjetësve dhe veçanërisht të shoqërive të brokerimit. Më poshtë po rendisim rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës dhe veprimet e AMF-së për secilin prej tyre:

*Pika “a”:* Të miratojë primin e rrezikut për çdo kompani sigurimi mbështetur në raportin e përgatitur nga aktuari i kompanisë duke mos miratuar dhe orientuar një prim rreziku të njëjtë për të gjithë tregun e MTPL.

Ndryshimi i nenit 10 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, solli liberalizimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Në bazë të Rregullores nr.110, datë 28.07.2011 "Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", primi i rrezikut miratohet brenda 31 marsit të çdo viti. Kjo është koha e nevojshme nga mbledhja e informacionit, përgatitja e pasqyrave financiare deri në miratimin e primeve të rrezikut nga Autoriteti. Bëjmë me dije gjithashtu që brenda kësaj periudhe miratohen nga Autoriteti dhe provigjonet teknike të shoqërive të sigurimit, të cilët janë elementë që përfshihen në primin e rrezikut.

AMF me Vendimin nr. 14, datë 15.02.2019 ka miratuar ndryshime në Rregulloren nr. 110, datë 28.07.2011 "Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", për realizimin e rekomandimit për miratimin e primit të rrezikut për çdo shoqëri sigurimi. Me Vendimin nr. 62, datë 27.03.2019, Autoriteti miratoi tabelat e primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti për kontratat TPL të sigurimit, për kontratat Kufitare të sigurimit, dhe për kontratat Kartoni Jeshil. Gjithashtu janë miratuar për çdo shoqëri veçmas tabelat e primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti për kontratat TPL të sigurimit.

Shoqëritë janë të detyruara të publikojnë primet e rrezikut si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit në faqen e internetit dhe t'i mbajnë ato të afishuara në faqe gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

*Pika “b”, “c”, “e”, “f”:* Të verifikojë nëse tregtimi i TPL në sistemet e shitjeve të shoqërive të sigurimit është në përputhje me rregullat e sjelljes së tregut të miratuara nga AMF, me qëllim shmangien e pasojave të padëshiruara për konkurrencën në treg.

Në lidhje me këto, AMF do të vazhdojë të kryejë inspektimet pranë shoqërive në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”, të ndryshuar.

Në vijim të rekomandimeve të dala nga inspektimi “Për verifikimin e sistemeve të shitjes të policave në tregun e sigurimeve”, AMF propozoi ndryshimet përkatëse në Rregulloren nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”, të cilat u miratuan me Vendimin e Bordit nr. 188, datë 18.09.2018. ([http://amf.gov.al/pdf/publikime/ Nr188 datë 18.09.2018.pdf](http://amf.gov.al/pdf/publikime/Nr188%20dat%2018.09.2018.pdf))

Ndryshimet e rregullores që lidhen me rekomandimet e vendimit nr. 561 datë 15.10.2018 të Autoritetit të Konkurrencës, konkretisht me pikën “b”, “c”, “e” dhe “f”, po i citojmë më poshtë:

“Shoqëria e sigurimit, agjentët/shoqëritë e agjentëve marrin të gjitha masat për të përshtatur sistemet informatike respektive të shitjeve online të policave për të operuar në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje. Një përdorues i autorizuar nuk mund të kryejë shitjen e policave të sigurimit nga më shumë se një terminal shitjeje dhe vendndodhje.

Shoqëria e sigurimit njofton paraprakisht Autoritetin për sistemet e saj të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik. Këto sisteme duhet të paktën të përmbushin këto kritere:

- Të ofrojnë akses të pakufizuar për shitjen e policave në çdo kohë që agjenti kërkon të lëshojë një policë.
- Të identifikojnë agjentët në mënyrë unike duke përdorur kodin e miratuar nga AMF.
- Çdo agjent i cili ka akses për shitje policash të më shumë se një shoqërie sigurimi duhet të ketë një kopje të marrëveshjes në ambientet e tij, e cila e lejon aksesin në to.

- Sistemi që përdor agjenti për shitjen e policave të detyrueshme duhet të jetë pjesë e sistemit të shoqërisë për të cilin është licencuar duke u lidhur drejtpërdrejtë me të pa ndërhyrje nga sisteme të tjera të paautorizuara.

Shoqëria e sigurimit informon Autoritetin (Drejtoria e TI) për skemën e rrjetit dhe të gjitha sistemeve përgjegjëse për shitjen apo raportimin e policave nëpërmjet një shkresë zyrtare dhe email-it (it@amf.gov.al). Njoftimi kryhet përpara se të ndodhin ndryshimet në rrjet apo në sisteme duke u shoqëruar me qëllimin e ndryshimit.

AMF ka të drejtën që të ushtrojë detyrën e saj në mbikëqyrjen e këtyre sistemeve në çdo kohë duke marrë për bazë këto kritere, por edhe të tjera, bazuar në standardet e auditimit të sistemeve të informacionit dhe teknologjisë.”

Pika “d”: *Të marrë masa për të lejuar shfaqjen në sistemin e tregtimit që përdoren nga agjentët, vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit vepron;*

Lidhur me pikën “d” duhet të saktësojmë që në bazë të Ligjit, nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Neni 194, Veprimtaria e agjentit në sigurime, mund të ushtrohet për disa shoqëri sigurimi.

1. Veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari.
2. Veprimtaria e agjentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.

Ky rekomandim do të zbatohet gjatë inspektimeve ku do të përfshihen dhe pikat “c”, “e” dhe “f”.

Pika “g”: *Të parashtrojë përpara Autoritetit të Konkurrencës duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore për çdo rast për të cilin konstaton sjelljen antikonkurruese nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.*

AMF, në vijim të rregullores së ndryshuar, por edhe në kuadër të rekomandimeve ka realizuar gjatë muajve dhjetor 2018–janar 2019 një seri inspektimesh të kombinuara në pikat e shitjeve të agjentëve për të verifikuar; dokumentacionin e nevojshëm të përdorur prej tyre, sistemet e teknologjisë së informacionit që përdorin për të lëshuar një policë të sigurimit të detyrueshëm motorik, inspektim tematik tek shoqëritë e brokerimit.

Nisur nga sensibiliteti publik dhe shqetësimet e shfaqura herë pas here dhe konstatimet që kanë dalë nga puna e përditshme, i kemi dërguar disa shkresa Autoritetit të Konkurrencës: nr. 1416/1 datë 27.04 .2018 “Mbi një ankesë të depozituar në AMF”, nr. 1725 prot, datë

14.05.2018 dhe nr. 1725/2 Prot, datë 22.05.2018 “Mbi inspektimin te ndërmjetësit në sigurime”, në pikën kufitare të Hanit të Hotit, si dhe nr.1789 Prot, datë 18.05.2018 dhe nr. 2143 Prot, datë 18.06.2018 “Mbi inspektimin tek ndërmjetësit në sigurime” Bankat–Broker, për të cilat jemi në pritje të rezultateve të hetimit.



## **PËRMBLEDHJE E ECURISË SË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE**

### **Tregu i Sigurimeve**

Gjatë vitit 2018, tregu i sigurimeve ka vijuar prirjen e tij për zgjerim, duke raportuar të dhëna pozitive, të cilat tregojnë për një rritje të tij, me strukturë më të diversifikuar dhe të balancuar. Primet shkruara bruto arritën në rreth 16.93 miliardë lekë, ose rreth 5% më shumë se në vitin 2017. Totali i dëmeve të paguara bruto, në vitin 2018, arriti në 6,983 milionë lekë e cila është 1,449 milionë lekë ose 26 % më shumë se në vitin 2017 dhe 47% më shumë se viti 2016.

Sigurimet e detyrueshme motorike vazhduan të dominojnë strukturën e tregut të sigurimeve. Ato sjellin rreth 63.4% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto dhe me një rritje prej 8% krahasuar me një vit më parë.

Pesha specifike e volumit të tregut të sigurimeve në përqindje ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto PBB-së gjatë 2018 rezulton 1.06%, me një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2017. Pavarësisht rritjes së tregut vitet e fundit, ky raport tregon se tregu i sigurimeve ka ende shumë nevojë për zgjerim.

Në tregun e sigurimeve, numri i kontratave në vitin 2018 vijoi rritjen me 5.9% krahasuar me një vit më parë dhe 14% krahasuar me vitin 2016. Numri i kontratave në sigurimet e detyrueshme motorike u rrit me 9.8% krahasuar me vitin 2017 dhe 14% krahasuar me vitin 2016.

Për herë të parë gjatë 2018, raporti dëme-prime (për sigurimet e Jo-Jetës) u rrit me 5% krahasuar me një vit më parë duke arritur mbi 42%, nivel ky i krahasueshëm me vendet e rajonit. Një ndikim pozitiv në këtë raport ka pagesa e dëmeve Fond Kompensimi e cila arriti në rreth 1 miliardë lekë ose 39% më shumë se viti 2017 dhe rreth dy herë më shumë se viti 2016.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës dominoi sigurimi nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 42%, të pasuara nga sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit me 23%.

Primet në sigurimet e Jetës në vitin 2018 patën një ulje me rreth 5%, krahasuar me vitin 2017. Sigurimi i Jetës vazhdon të jetë i lidhur ngushtë me nivelin e kredidhënies, kryesisht për individët. Ky fakt mbështetet dhe me analizimin e produkteve, që patën ndikimin kryesor në rritjen e këtij tregu. Një nga arsytet e uljes vjen nga portofoli “Jetë Debitori”, ku përfitues janë bankat e nivelit të dytë, të cilat i akordojnë kredi individëve.

## **Tregu i Fondeve të Pensionit Vullnetar dhe Fondeve të Investimeve**

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar, megjithëse modest në zhvillimin e tij, ka vijuar prirjen për zgjerim e shprehur kjo në rritjen e vlerës neto të aseteve dhe numrit të anëtarëve. Totali i aseteve neto të këtij tregu më 31.12.2018 është 2.3 miliardë lekë me 25,298 anëtarë. Asetet neto të këtij tregu më 31.12.2018 kanë pësuar një rritje me 33%, ndërsa numri i anëtarëve është rritur me 21% krahasuar me fundin e vitit 2017. Krahasuar me fundin e vitit 2016 rezulton se asetet neto janë rritur me 74%, kurse numri i anëtarëve është rritur me 46%.

Tregu i fondeve të investimeve pësoi një tkurrje prej 6.6% krahasuar me një vit më parë, por një rritje prej 3.8% krahasuar me vitin 2016. Arsytet e tkurrjes mendohet të kenë ardhur si rezultat i kthimeve të ulëta nga investimi, veçanërisht në valutë të huaj si edhe si efekt i kursit të këmbimit. Totali i aktiveve neto nën administrim të fondeve të investimit arriti në 66 miliardë lekë, duke zënë një peshë prej rreth 4% ndaj PBB<sup>1</sup>.

Pesha e tregut të fondeve të investimeve për vitin 2018 në tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF, arriti në rreth 67% duke zënë peshën kryesore në këto tregje. Tashmë ky treg përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri. Për të vlerësuar ndikimin e situatave të jashtëzakonshme dhe opsionet për zgjidhjen e tyre, janë organizuar nga AMF dhe dy simulime, njëri prej tyre me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të depozitave. Në këto simulime kanë marrë pjesë dhe përfaqësues të Bankës Botërore dhe FMN në rolin e vëzhguesit.

## **Tregu i Kapitaleve**

Risia në tregun e kapitaleve për vitin 2018 është fillimi zyrtarisht i veprimtarinë, më 22 shkurt 2018, i Bursës së parë Shqiptare të Titujve-ALSE. Kjo Bursë është me kapital privat dhe e licencuar më 03.07.2017. Sistemi i tregtimit të Bursës vëzhgohet nga AMF në kohë reale, në funksion të mbrojtjes së interesave të investitorëve dhe sigurimit të një tregu të drejtë dhe transparent. Gjatë vitit të parë të aktivitetit të saj, në periudhën shkurt-dhjetor 2018 vlera totale e tregtimit (*on exchange*) në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE arriti në nivelin rreth 1.4 miliardë lekë, ku kanë dominuar transaksionet me bono thesari të kryera midis bankave për llogari të tyre.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive, tregjet që mbikëqyren nga AMF duhet të fokusohen më shumë në drejtim të rritjes së besimit të konsumatorit dhe përmirësimit të shërbimit në tërësi. Për këtë është e nevojshme hartimi i një strategjie kombëtare për edukimin financiar të popullatës, e cila kërkon bashkëpunim ndër-institucional në këtë drejtim.

---

<sup>1</sup> Referuar të dhënave për PBB sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

## **Kapitulli 1 MBROJTJA E KONSUMATORIT**

### **1.1 Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit**

Përmbushja e funksioneve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare udhëhiqet nga objektivi kryesor i mbrojtjes së interesave të investitorëve dhe konsumatorëve. Rritja e nivelit të mbrojtjes së investitorëve dhe konsumatorëve zë një rol qendror në veprimtarinë e Autoritetit.

Për këtë qëllim angazhimi i institucionit gjatë vitit 2018 është fokusuar në:

- Shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve;
- Monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe forcimin e veprimeve parandaluese në sjelljen e tregjeve nën mbikëqyrje dhe subjekteve që operojnë në këto tregje;
- Rritjen e nivelit të informacionit të disponueshëm për publikun;
- Ndërmarrjen e fushatave për rritjen e edukimit financiar të publikut; si dhe
- Asistimin e konsumatorit/investitorit duke i dhënë informacion dhe sqarime sipas kërkesave.

Gjithashtu gjatë vitit 2018 është punuar për të bërë të mundur depozitimin nëpërmjet sistemit *online* të ankesave që mund të kenë konsumatorët për shërbimet që ata përfitojnë nga subjektet të cilët ushtrojnë veprimtarinë në tregjet që mbikëqyren nga Autoriteti, i cili u finalizua dhe u vu në funksionim në muajin shkurt 2019.

#### **1. Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve**

Shqyrtimi i ankesave të konsumatorit/investitorit synon zgjidhjen në mënyrë profesionale, të paanshme e të shpejtë të ankesave të depozituara. Përveç kësaj Autoriteti synon që nëpërmjet shqyrtimit të ankesave të depozituara, të mbledhë dhe analizojë informacione mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara nga subjektet nën mbikëqyrje për konsumatorët e investitorët. Këto të dhëna i shërbejnë institucionit të ndërhyjë në kohë në përmirësimin e politikave dhe proceseve të punës së subjekteve të mbikëqyrura më qëllim parandalimin e sjelljeve jo korrekte ndaj konsumatorit/investitorit.

Gjatë vitit 2018 në Autoritet janë depozituar 82 ankesa të cilat lidhen me kërkesat për dëmshpërblim që rrjedhin drejtpërdrejt nga kontratat e sigurimit, të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit apo me ankesa ndaj operatorëve të tregut të fondeve të investimeve dhe të pensioneve vullnetare.

Pjesa më e madhe e ankesave të depozituara sa i takon llojit të sigurimit lidhet me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, i cili përbën edhe portofolin kryesor të

tregut të sigurimeve. Referuar shkaqeve të ankimit, ka rezultuar se shkak kryesor, është pakënaqësia e të dëmtuarit për vlerën e dëmshpërblimit. Nga verifikimet e bëra nuk kanë rezultuar raste kur aktet e vlerësimit të jenë kryer në shkelje të procedurave ligjore. Gjithsesi, pas kërkesës së Autoritetit për rishikim, shoqëritë e sigurimit kanë proceduar me rishikim të vlerës së dëmshpërblimit apo i kanë ofruar ankimuesit metoda alternative të dëmshpërblimit, siç është riparimi i mjetit në serviset me të cilat shoqëritë kanë marrëveshje bashkëpunimi. Në disa raste, kur shkak i të ankesave ishte i lidhur me afatet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, ka rezultuar se vonesa e pagesës nga shoqëria e sigurimit ka ndodhur për shkak të mosdepozitimit nga ana e ankimuesit të dokumentacionit të nevojshëm për vlerësim apo për pagesë, të tilla si: dokument përfaqësimi, nr. llogari bankare, etj.

Në disa raste, shqyrtimi i ankesave nuk ka vijuar për arsye të mungesës së të dhënave apo për shkak se trajtimi i çështjeve ka qenë jashtë juridiksionit të Autoritetit.

Në përfundim, rreth 58% e ankesave të konsumatorit janë zgjidhur pas ndërhyrjes së Autoritetit.

Rastet e ankesave lidhur me fondet e pensioneve vullnetare lidhen me interpretimin dhe procedurën e zbatueshme në rastet e largimit nga fondi. Pas diskutimeve me subjektet e mbikëqyrura dhe sqarimeve të dhëna, çështja është zgjidhur në favor të palës që ka paraqitur ankimin.

Ankesat që lidhen me fondet e investimeve kanë parashtruar pretendime lidhur me komisionet që aplikohen nga depozitari i fondit të investimeve (bankë). Autoriteti ka ushtruar inspektim dhe për një rast ka urdhëruar depozitarin të mos aplikojë komisione shtesë dhe çështja është zgjidhur në favor të ankimuesit. Ndërsa për rastin e dytë që lidhet me të njëjtën çështje, nga verifikimet e kryera rezultoi se nuk aplikohen komisione shtesë nga depozitari i fondit të investimit.

Përveç ankesave që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e ofruara nga shoqëritë e sigurimit, gjatë vitit 2018 janë depozituar edhe rreth 80 ankesa, që lidhen me pagesat e dëmshpërblimit objekt i Fondit të Kompensimit, të cilat çojnë në 162 totalin e ankesave të depozituara.

Gjatë vitit 2018, Autoriteti ka administruar 20 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në kohë duke i kthyer përgjigje e dhënë sqarimet dhe orientimet e nevojshme. Koha mesatare e trajtimit të kërkesave për informacion varion në 1-2 ditë.

## **2. Monitorimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe forcimi i veprimeve parandaluese në sjelljen e tregjeve nën mbikëqyrje dhe subjekteve që operojnë në këto tregje**

Në funksion të mbrojtjes konsumatore, me qëllim që të sigurohet që veprimtaria promociionale rreth subjekteve të mbikëqyrura dhe produktet që ofrohen në treg të përmbajnë të dhëna të qarta, të vërteta dhe të plotë, Autoriteti ka shqyrtuar e verifikuar përputhshmërinë ligjore për 5 materiale promociionale dhe kushte të kontratave për 4 produkte sigurimi.

Rëndësi të veçantë gjatë vitit 2018 i është kushtuar dhënies së informacionit të plotë konsumatorit. Me qëllim verifikimin e sjelljes ndaj konsumatorit dhe marrjen e masave të nevojshme, Autoriteti ka kryer inspektime të vazhdueshme në subjektet e mbikëqyrura dhe në rastet kur është konstatuar mosdhënie e plotë e informacionit parakontraktual është vijuar me masat mbikëqyrëse përkatëse.

### **3. Rritja e nivelit të informacionit të disponueshëm për publikun**

Shoqëritë që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë kanë detyrimin të kenë faqe zyrtare interneti ku të publikojnë informacion rreth veprimtarisë së shoqërisë dhe produkteve që ajo ofron. Autoriteti, gjatë vitit 2018, i ka kushtuar vëmendje të veçantë monitorimit të përmbushjes në mënyrë efikase të detyrimit për informim. Janë kryer verifikime periodike në periudhat janar, korrik dhe dhjetor 2018. Pas verifikimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme me shoqëritë e sigurimit, situata e informacionit të detyrueshëm për t'u publikuar në fund të vitit paraqitet e përmbushur sipas detyrimeve ligjore.

## **1.2 Edukimi Financiar**

Edukimi financiar i publikut është një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Nëpërmjet rritjes së njohurive dhe ndërgjegjësimi të publikut rreth tregjeve financiare jobankë dhe produkteve të ofruara do të mund të arrijmë të kemi jo vetëm një konsumator të mbrojtur, por edhe të rrisim besimin e konsumatorit dhe zhvillimin e tregut financiar në përgjithësi.

Duke pasur në vëmendje këtë rëndësi, Autoriteti është angazhuar në veprime konkrete për rritjen e besimit dhe edukimit të konsumatorit për tregjet nën mbikëqyrje. Edhe gjatë vitit 2018, Autoriteti ka vijuar punën me organizimin e aktiviteteve për zbatimin e Strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje (tetor 2017–tetor 2020)”. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të kryera nga Autoriteti në kuadër të kësaj strategjie janë:

Në muajin maj 2018 u zhvillua me sukses dhe pati ndikim pozitiv Konferenca Kombëtare me titull: “Sfidat e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe edukimi financiar”. Në këtë konferencë morën pjesë studentë dhe stafi akademik nga Universitete

publike dhe private në vend, të cilët kontribuan me punime të ndryshme për çështje të lidhura me tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit.

Gjatë vitit 2018 stafi i Autoritetit ka vijuar të jetë prezent në universitete të ndryshme në vend, duke prezantuar institucionin, veprimtarinë e tij si dhe tregjet nën mbikëqyrje, nëpërmjet leksioneve të hapura dhe bashkëbisedimeve. Autoriteti ka ofruar kryerjen e praktikave mësimore pranë institucionit për disa studentë, si dhe ka koordinuar procesin për të mundësuar kryerjen e praktikave mësimore të mbi 300 studentëve pranë subjekteve nën mbikëqyrje.

Si pjesë e rëndësishme e strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”, AMF ka kërkuar bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit për fillimin e bisedimeve për përfshirjen në kurikulat mësimore ose në lëndë të veçanta, të tematikave për tregjet nën mbikëqyrje.

Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin dhe ka rritur prezencën e stafit të tij dhe ekspertëve të tregjeve financiare nën mbikëqyrje edhe në media.

Për të rritur mundësinë e informimit të publikut, AMF ka përgatitur dhe publikuar materiale informuese, të cilat renditen:

- Hartim i broshurave informuese (Sigurimi i Pronës, Sigurimi i Shëndetit, Tregu i Sigurimeve);
- Materiale informative të publikuara në faqen e Autoritetit (Tregu i sigurimeve “Pyetjet më të shpeshta”, Çfarë duhet të ketë kujdes konsumatori?).

### **1.3 Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun**

Përgjatë vitit 2018, Autoriteti ka vijuar zbatimin e Strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit për tregjet nën mbikëqyrje”, duke realizuar aktivitete dhe pasqyrime publike e mediatike. Objektivi i tij ka qenë gjithnjë rritja e informacionit për qytetarët për tregjet nën mbikëqyrje, si edhe ndërgjegjësimi i tyre për rolin që AMF ka në mbrojtje të konsumatorit. Aktivitetet e ndryshme të organizuara nga Autoriteti përfshijnë konferenca, seminare kombëtare dhe rajonale, si edhe pasqyrime mediatike të dedikuara për aktivitetet e AMF-së.

Gjatë vitit 2018, AMF ka nënshkruar marrëveshje me universitete publike dhe private në vend duke i dhënë kështu një përmasë tjetër komunikimit publik dhe informimit të grupmohës më aktive, të të rinjve në vend. Gjatë takimeve me studentë e pedagogë dhe në orët e hapura të leksioneve është pasqyruar roli mbikëqyrës dhe rregullator për tregun e sigurimeve, pensioneve private vullnetare, fondet e investimeve dhe letrave me vlerë. Me

grupe të përcaktuara të studentëve, sidomos nga fakultetet juridike dhe të ekonomisë së këtyre universiteteve, AMF realizoi një anketim për matjen e njohurive financiare të tregjeve nën mbikëqyrje. Rezultatet e përpunuara nga anketimi janë publikuar në mediat e specializuara ekonomike, revistat Monitor dhe Bankieri. Një pjesë e tyre u bënë publike dhe në një konferencë të përbashkët të organizuar nga shoqata e bankave për rritjen e përfshirjes financiare në vend. Nga anketimi, vihet re se informacioni për tregun e sigurimeve është më i lartë se për tregun e letrave me vlerë, fondeve të pensioneve private vullnetare dhe fondeve të investimeve. Megjithatë, edhe për tregun e sigurimeve, informacioni është kryesisht i lidhur me sigurimet e detyrueshme, sidomos sigurimin e automjeteve. Rezultatet e këtij anketimi, i shërbyen AMF-së për të rivendosur fokusin e trajtimit në grupet e të rinjve dhe për tregjet specifike financiare jobankare.


Mediat i bënë një pasqyrim të zgjeruar konferencës së parë kombëtare të zhvilluar nga AMF për edukimin financiar. Në konferencë u paraqitën mbi 30 punime nga studentë të universiteteve publike dhe private, të cilët kishin studiuar aspekte të veçanta të ecurisë dhe sfidave për zhvillimin e tregjeve financiare jobankare. AMF, pas konferencës organizoi një emision televiziv në rubrikën “Auditor Arsimi” në Televizionin Publik Shqiptar. Në diskutimin televiziv u përfshinë studentë e pedagogë pjesëmarrës dhe fitues të çmimeve në konferencë, si edhe përfaqësuesit e shoqatave të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së. Programi televiziv i shërbeu shtrirjes më të gjerë të informacioneve për tregjet dhe mundësive që ofron Autoriteti për përfshirjen e studentëve në bashkëpunim me AMF-në për realizimin e praktikave mësimore.

Autoriteti ka ruajtur një komunikim të hapur, transparent e të drejtpërdrejtë me median, duke i dhënë përparësi edhe komunikimit në rrjetet sociale, si në faqen zyrtare në Facebook ashtu dhe në faqen zyrtare *online*. Rritja e komunikimit është shoqëruar me rritje të besimit të qytetarëve, që kanë adresuar çështje të ndryshme pranë Autoritetit, i cili i ka shqyrtuar ato sipas afateve ligjore.

Gjatë vitit 2018, faqja zyrtare e Autoritetit në Facebook është rritur gradualisht, duke zgjeruar audiencën e saj. Përgjatë një viti u shënua thuajse dyfishim i numrit të pëlqimeve në faqe. Gjatë vitit të kaluar, në faqe janë hedhur postime të ndryshme (lajme të shkurtra me foto, albume fotografike, grafikë të shoqëruar me përshkrime të shkurtra, video, njoftime të ndryshme, etj.). Sipas të dhënave ka një dyfishim të numrit të klikimeve/leximeve dhe përdoruesve në faqe, krahasuar me një vit më parë. Sa i përket gjeografisë së ndjekësve të faqes, shumica janë nga Shqipëria (Tirana) dhe më pas Italia, SHBA, Greqia, etj. Pjesa më e madhe e ndjekësve janë të grupmoshës 25-44 vjeç.

**Grafik 1: Të dhëna për përfshirjen mesatare të ndjekësve në faqen e Facebook-ut, viti 2018**


(Në  
numër)



Edhe gjatë vitit 2018, tendenca rritëse e numrit të klikimeve në faqen zyrtare të AMF-së në Facebook dhe në faqen zyrtare *online* ka shkuar paralel me zhvillimet e tanishme të medias në vend, ku komunikimet dixhitale po zëvendësojnë gradualisht komunikimet me mediat tradicionale, duke u shndërruar në formën prioritare të komunikimit.

Duke iu referuar informacioneve të publikuara në faqen *online*, pjesa më e madhe e përdoruesve kërkojnë informacione lidhur me kuadrin ligjor, rregulloret, vendimet e miratuara nga Bordi i AMF-së, si edhe direktivat e ndryshme. Mbi 46% e klikimeve në faqen *online* janë kryer për leximin e lajmeve dhe publikimet e ndryshme. Një pjesë e rëndësishme e përdoruesve të faqes, rreth 20%, kanë klikuar në seksionin e Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik për të verifikuar policat e sigurimit.

**Grafik 2: Struktura e klikimeve në faqen online të AMF-së, 2018**



(Në

%)



Faqja *online* është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe në këtë mënyrë ajo i shërben edhe investitorëve apo analistëve të huaj si burim informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private vullnetare dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja vizitohet edhe nga vizitorë jashtë vendit dhe pjesa më e madhe e tyre janë nga vende si SHBA, Kanada, Angli, Maltë, Francë, Itali, Rusi, etj.

Pasqyrimi në median tradicionale ka vijuar edhe gjatë vitit 2018 me informacione për aktivitetet e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje. Tematikat më të shpeshta të pasqyruara në media gjatë vitit 2018 lidhen me tregun e sigurimeve, në veçanti sigurimet motorike dhe projektligji i ri për sigurimet. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe Fondit të Kompensimit, aty ku mediat kanë raportuar trendin rritës të pagesave, pas vendimeve të njëpasnjëshme të marra nga Bordi i AMF-së. Mediat i kushtuan interes pasqyrimin të komunikimeve publike të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetarit të Bordit të Autoritetit.

Një tjetër çështje e pasqyruar gjerësisht në media lidhet me format e reja të investimeve, platformat e tregimit *online*, si edhe investimet në monedhat virtuale. Nëpërmjet krijimit të një rubrike të posaçme në faqen *online* dhe në rrjetin social Facebook, AMF i këshilloi investitorët të jenë të kujdesshëm kur të vendosin të investojnë në platformat *online*, në monedhat virtuale duke njohur më parë rreziqet dhe duke patur një kulturë të nevojshme financiare për të marrë vendime të tilla investimi. Autoriteti publikon në mënyrë të vazhdueshme edhe paralajmërimet që vijnë nga institucionet ndërkombëtare apo vendet partnere.

# I. MBIKËQYRJA E INTEGRUAR E TREGJEVE FINANCIARE JOBANKARE

## 2 Kapitulli 2 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Investimeve

### 2.1 Tregu i Fondeve të Investimeve

Industria e fondeve të investimeve në Shqipëri filloi aktivitetin në vitin 2012. Gjatë këtyre viteve ky sektor ka kaluar përmes ndryshimeve të rëndësishme strukturore, duke përbërë kështu një hap pozitiv përpara drejt zhvillimit të tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe mbështetjes së tregut financiar në përgjithësi.


Në këto kushte, në fokusin e punës mbikëqyrëse të Autoritetit gjatë vitit 2018 ka qenë forcimi i mëtejshëm i tregut të fondeve të investimeve nëpërmjet përmirësimit të administrimit të rreziqeve, me të cilat përballen këto fonde dhe rritjes së transparencës së tyre.

#### 2.1.1 Struktura e Tregut

Gjatë vitit 2018, në tregun e fondeve të investimit ushtruan aktivitetin e tyre pesë fonde investimi, dy prej të cilëve të licencuar gjatë vitit 2018. Fondet e tregut të investimeve administrohen nga 3 shoqëri administruese që janë Raiffeisen Invest sh.a., Credins Invest sh.a. dhe WVP Fund Management Tirana, e licencuar në janar 2018. Shoqëritë Raiffeisen Invest sh.a. dhe Credins Invest sh.a. kryejnë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar, ndërkohë që shoqëria WVP Fund Management Tirana kryen veprimtarinë e administrimit vetëm për fondet e investimit.

**Grafik 3: Peshë që zënë asetet neto të secilit Fond Investimi në treg 31.12.2018**

(Në %)



### 2.1.2 Pozicioni Financiar dhe Mbikëqyrja e Tregut

Që nga fillimi i veprimtarisë së fondit të parë të investimeve në vitin 2012, tregu i fondeve të investimeve është rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe ky treg tashmë përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri.

Në vitin 2018 ky treg ka arritur një nivel stabil kryesisht për fondet e para të licencuara nga AMF, të cilët kanë pësuar rënie në asetet e tyre si pjesë normale e aktivitetit, rënie e cila ka ndikuar dhe në rënien e tregut për vitin 2018. Kështu në vitin 2018, asetet neto të tregut të fondeve të investimeve arritën në 66.09 miliardë lekë. Krahësuar me vitin 2017 asetet neto të fondeve të investimeve gjatë vitit 2018 pësuan një rënie prej 6.6 miliardë lekë ose 9.1% më pak. Kjo rënie e aseteve mendohet të ketë ndodhur si rezultat i pranisë së një ambienti me norma të ulëta të interesit, sidomos në valutë të huaj. Kursi i këmbimit ka ndikuar në rënien e vlerës së aseteve të njërit prej fondeve të investimit në euro dhe në nivel tregu ky ndikim është 0.84%. Numri i anëtarëve në fondet e investimeve është 29,421 nga të cilët 99.96% janë investitorë individualë.

Investimet e tregut të fondeve të investimeve konsistojnë në Obligacione Qeveritare brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, Bono Thesari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Obligacione të shoqërive jashtë vendit, kuota në fonde investimi si dhe aksione në shoqëri të huaja. Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, të cilat përbëjnë 61.2% të aseteve të këtij tregu.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet vlera fillestare e kuotës për secilin fond investimi si dhe vlera e saj në fund të vitit 2017 dhe 2018.

**Tabelë 1: Vlera e kuotës së fondeve të investimeve më 31.12.2018**

*(Në lekë)*

| <i>Përshkrimi</i>                   | <i>Vlera fillestare e vlerës neto të aseteve për kuotë</i> | <i>Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2017</i> | <i>Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2018</i> |
|-------------------------------------|------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|--------------------------------------------------|
| Raiffeisen Prestigj                 | 1,000                                                      | 1,435                                            | 1,496                                            |
| Raiffeisen Invest EURO <sup>2</sup> | 14,000                                                     | 15,547                                           | 14,197                                           |
| Credins Premium                     | 1,000                                                      | 1,137                                            | 1,219                                            |
| WVP Top Invest                      | 1,000                                                      | -                                                | 898                                              |
| Raiffeisen Vizion                   | 1,000                                                      | -                                                | 1,018                                            |

<sup>2</sup> Vlerat e Raiffeisen Invest EURO janë konvertuar me kursin në periudhën përkatëse

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ecuria e portofolit të tregut të fondeve të investimit gjatë tremujorëve të vitit 2018.

**Tabelë 2 : Të dhëna mbi portofolin e fondeve të investimeve, sipas periudhave tremujore të vitit 2018**

| Përshkrimi                                  | Vlera (në mln. lekë) |               |               |               |
|---------------------------------------------|----------------------|---------------|---------------|---------------|
| Periudha                                    | 31.03.'18            | 30.06.'18     | 30.09.'18     | 31.12.'18     |
| <b>Asetet neto të fondeve</b>               | <b>68,797</b>        | <b>66,461</b> | <b>65,637</b> | <b>66,087</b> |
| <b>Totali i aseteve të fondeve</b>          | <b>69,127</b>        | <b>66,635</b> | <b>65,820</b> | <b>68,124</b> |
| <i>nga të cilët:</i>                        | -                    | -             | -             | -             |
| Obligacione Qeveritare                      | 42,723               | 42,293        | 41,560        | 41,725        |
| Obligacione të Shoqërive                    | 3,167                | 2,671         | 2,678         | 2,060         |
| Bono Thesari                                | 13,335               | 11,496        | 10,288        | 11,912        |
| Investime në kuota të fondeve të investimit | 3,275                | 2,884         | 2,650         | 2,686         |
| Aksione në shoqëri të huaja                 | 73                   | 78            | 86            | 78            |
| Mjete Monetare                              | 5,844                | 6,478         | 7,742         | 8,937         |
| Asete të tjera                              | 710                  | 735           | 816           | 726           |
| <b>Totali i Detyrimeve të Fondeve</b>       | <b>330</b>           | <b>174</b>    | <b>183</b>    | <b>2037</b>   |


Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ndryshimi i portofolit të tregut të fondeve të investimit të vitit 2018 kundrejt vitit 2017 si dhe pesha që secili nga përbërësit e portofolit zë në totalin e aktiveve si në vitin 2017, ashtu dhe në vitin 2018.

**Tabelë 3: Ndryshimi në përbërjen e portofolit të fondeve të investimeve, 31.12.'16-31.12.'18**

| Përshkrimi                                  | Vlera (në mln. lekë) |               |               | Ndryshimi (në %)    |                     | Pjesa ndaj totalit (në %) |             |             |
|---------------------------------------------|----------------------|---------------|---------------|---------------------|---------------------|---------------------------|-------------|-------------|
| Periudha                                    | 31.12.'16            | 31.12.'17     | 31.12.'18     | 31.12.'16-31.12.'17 | 31.12.'17-31.12.'18 | 31.12.'16                 | 31.12.'17   | 31.12.'18   |
| <b>Asetet neto të fondit</b>                | <b>65,429</b>        | <b>72,717</b> | <b>66,087</b> | <b>11.14</b>        | <b>(9.12)</b>       |                           |             |             |
| <b>Totali i aseteve të fondeve</b>          | <b>65,613</b>        | <b>72,921</b> | <b>68,124</b> | <b>11.14</b>        | <b>(6.58)</b>       | <b>100</b>                | <b>100</b>  | <b>100</b>  |
| <i>nga të cilët:</i>                        | -                    | -             | -             | -                   | -                   | -                         | -           | -           |
| Obligacione Qeveritare                      | 42,234               | 44,700        | 41,725        | 5.84                | (6.66)              | 64.37                     | 61.30       | 61.25       |
| Obligacione të Shoqërive                    | 2,830                | 3,854         | 2,060         | 36.18               | (46.55)             | 4.32                      | 5.28        | 3.02        |
| Bono Thesari                                | 9,404                | 12,912        | 11,912        | 37.30               | (7.74)              | 14.33                     | 17.71       | 17.49       |
| Investime në kuota të fondeve të investimit | 2,173                | 3,618         | 2,686         | 66.50               | (25.76)             | 3.31                      | 4.96        | 3.94        |
| Aksione në shoqëri të huaja                 | -                    | -             | 78            | -                   | -                   | -                         | 0.00        | 0.11        |
| Mjete Monetare                              | 8,295                | 7,101         | 8,937         | (14.39)             | 25.86               | 12.64                     | 9.74        | 13.12       |
| Debitorë                                    | 677                  | 736           | 726           | 8.71                | (1.36)              | 1.03                      | 1.01        | 1.07        |
| <b>Totali i Detyrimeve të Fondeve</b>       | <b>184</b>           | <b>204</b>    | <b>2037</b>   | <b>10.87</b>        | <b>899</b>          | <b>0.28</b>               | <b>0.28</b> | <b>2.99</b> |


**Grafik 4: Struktura e asetëve të fondeve të investimeve 31.12.2017**

(Në %)



**Grafik 5: Struktura e asetëve të fondeve të investimeve 31.12.2018**


(Në %)



Në kuadër të respektimit të kërkesave të rregullores së likuiditetit, shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit që investojnë në tregje jo aktive të mbajnë likuiditet deri në 1 muaj, minimalisht 10%. Siç shihet dhe në grafikun e mëposhtëm maturimi deri në një muaj i tregut të fondeve të investimit është 17.95%.

**Grafik 6: Profili i Investimit të tregut të fondeve të investimit 31.12.2018**

(Në %)



### 2.1.3 Inspektime

Në vijim të ndryshimeve të bëra me Vendimi e Bordit nr. 173, datë 30.11.2017 në Rregulloren nr. 128, datë 06.10.2011, “Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, si dhe duke marrë shkas nga një ankesë e një investitori, Autoriteti kreu një inspektim në një prej bankave depozitare, me objekt zbatimin nga kjo e fundit të ndryshimeve në rregulloren e sipërpërmendur. Në vijim të inspektimit Autoriteti dha rekomandimet përkatëse si dhe ka ndjekur ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Gjithashtu, në tetor 2018, Autoriteti kreu një inspektim të plotë në një bankë depozitare, e cila shërben si Depozitar i një fondi pensioni dhe disa fonde investimi përfshirë dy fondet e investimit të licencuara gjatë vitit 2018. Ky inspektim u krye në bashkëpunim edhe me DPPP-në për çështje që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjetjet dhe rekomandimet e dala nga ky inspektim i janë komunikuar bankës depozitare sipas procedurës. AMF po ndjek ecurinë e zbatimit të tyre sipas afateve të përcaktuara në raportin e inspektimit.

## 2.2 Tregu i Kapitaleve

Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE, e licencuar nga AMF me Vendimin nr. 88, datë 03.07.2017, u bë operative më 22 shkurt të vitit 2018. Në mbështetje të kushtit kufizues të përcaktuar në licencë për vitin e parë të aktivitetit, gjatë vitit 2018, aktiviteti i Bursës u përqendrua në tregtimin e letrave me vlerë të Qeverisë së R.Sh. Për shkak të volumeve modeste të tregtimit, sesionet e tregtimit në Bursën ALSE u zhvilluan 2 herë në javë. Volumet modeste të tregtimit u shoqëruan me një numër të kufizuar anëtarësh. Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE e mbylli vitin 2018 me katër anëtarë: Banka Credins, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Tirana dhe Banka Ndërkombëtare Tregtare. Objektivi afat-shkurtër i Bursës është rritja e mëtejshme e numrit të anëtarëve, si një element kryesor dhe i domosdoshëm për mirëfunksionimin e veprimtarisë së Bursës dhe zbatimin e parimit të ekzekutimit më të mirë të urdhërave të klientit, apo reflektimin sa më real të çmimit të tregut.

AMF, në statusin e vëzhguesit të sistemit të tregtimit, ka ndjekur në kohë reale transaksionet e Bursës në çdo seancë tregtimi.

### Volumi i tregtimit në Bursë

Gjatë vitit të parë të aktivitetit të saj, në periudhën shkurt-dhjetor 2018 vlera totale e tregtimit në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE arriti në nivelin 1.38 miliardë lekë, realizuar në 68 transaksione.

Në një analizë të përgjithshme të karakteristikave të zhvillimit të tregtimit, në Bursën Shqiptare të Titujve (*on-exchange*)<sup>3</sup> për periudhën shkurt-dhjetor 2018, kanë dominuar:

- Transaksionet mes bankave;
- Transaksionet në oraret zyrtare;
- Transaksionet në bono thesari;
- Transaksionet në valutën lekë.

Vlera e tregtuar e bonove të thesarit është 57.54% përkundrejt vlerës 42.46% të obligacioneve qeveritare.

Parë në këndvështrimin e maturimit, nga Bonot e Thesarit titujt më aktivë janë ato me maturim 12-mujor, të ndjekura nga bono thesari 6-mujore. Ndërsa nga obligacionet e thesarit, titujt më aktivë në tregtim janë ato me maturim 5-vjeçar dhe 10-vjeçar, të ndjekura nga obligacionet 2-vjeçare. Pjesa më e madhe e transaksioneve janë të ekzekutuara në monedhën lekë, krahasuar me shumë pak transaksione në tituj të nominuar në euro.

---

<sup>3</sup> Në periudhën shkurt - dhjetor 2018 vlera gjithsej e tregtimit në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE arriti në nivelin 2.57 miliardë Lekë. Nga ky total, në Bursë janë tregtuar rreth 1.4 miliardë Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 1,17 miliardë Lekë është tregtuar jashtë orarit zyrtar.

Në tabelën më poshtë jepet informacioni mbi transaksionet e kryera në Bursë midis Bankave dhe ato të kryera për llogari të klientëve, ku vihet re se dominojnë transaksionet midis bankave për llogari të portofolit të tij.

**Tabelë 4: Transaksionet e kryera në Bursë midis Bankave dhe ato të kryera për llogari të klientëve**

| Lloji i Transaksionit | Shkurt - Dhjetor 2018 |                             |
|-----------------------|-----------------------|-----------------------------|
|                       | Nr.Transaksioneve     | Volumi në vlerë i tregtimit |
| <b>Ndërbankare</b>    | <b>61.76%</b>         | <b>62.64%</b>               |
| <b>Për Klientët</b>   | <b>38.24%</b>         | <b>37.36%</b>               |
| <i>Individë</i>       | 7.35%                 | 1.83%                       |
| <i>Pers.Juridikë</i>  | 30.88%                | 35.53%                      |

### Kuadri rregullator i Bursës

Hartimi i kuadrit të nevojshëm rregullator për funksionimin e tregut të kapitaleve ka qenë në fokus të organeve drejtuese të Bursës Shqiptare të Titujve dhe Autoritetit. Gjatë vitit 2018, Autoriteti miratoi disa akte të përgatitura nga Bursa, si më poshtë:

1. *Rregulloren për Mbikëqyrjen dhe Monitorimin në Bursën Shqiptare të Titujve*, me Vendimin nr. 165, datë 31.08.2018. Rregullorja konsiston në vendosjen e rregullave të monitorimit dhe mbikëqyrjes për parandalimin, identifikimin, përcaktimin dhe marrjen e masave kundër praktikave të paligjshme të tregtimit nga anëtarët, brokerat e anëtarëve dhe klientët e tyre. Vendosja e rregullave për mbikëqyrje dhe monitorim të transaksioneve në Bursë i shërben objektivit për një treg të drejtë dhe eficient, si dhe mbrojtjes së interesave të investitorëve nëpërmjet parandalimit të praktikave abuzive. Kjo rregullore përcakton parimet kryesore të mbikëqyrjes dhe përcaktimin e niveleve (strukturave) të mbikëqyrjes.

2. *Udhëzim mbi Mënyrën e Tregtimit, Klerimit dhe Shlyerjes së Transaksioneve në Bursën ALSE*, miratuar me Vendimin nr. 91, datë 13.06.2018. Ky udhëzim përcakton disa detaje teknike në lidhje me tregtimin e titujve në sistemin e tregtimit të Bursës.

3. *Listën e ndryshuar të tarifave dhe komisioneve të Bursës*, miratuar me Vendimin nr. 91, datë 13.06.2018. Gjatë vitit të parë të aktivitetit, Bursa vendosi të përjashtojë anëtarët e saj nga detyrimi për të paguar tarifat dhe komisionet.

### Tregu me pakicë i titujve të Qeverisë



Segmenti më aktiv i tregut të titujve mbetet tregu me pakicë i titujve të Qeverisë. Tregu me pakicë përfshin tregtimin e titujve të Qeverisë të R.Sh. ndërmjet shoqërive të licencuara të brokerimit (kryesisht bankave) dhe investitorëve ( individë ose personave juridikë). Tregu me pakicë dominohet nga blerjet e bankave në tregun primar të titujve të Qeverisë, në emër dhe për llogari të investitorit. Aktiviteti në tregun sekondar është ende i ulët.

Edhe gjatë vitit 2018, në zbatim të Rregullores nr. 22, datë 26.03.2009 “Për Tregun me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë së RSH-së” shoqëritë e licencuara për të kryer transaksione në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë kanë raportuar periodikisht në Autoritet dhe në platformën GSRM transaksionet e kryera në këtë treg. Kjo platformë vazhdoi të funksionojë dhe të përmbushë rolin e saj në funksion të rritjes së transparencës në kuotimet dhe dhënies së informacionit të plotë për publikun dhe investitorët institucionalë mbi transaksionet në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë.

Volumi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2018 u dominua në masën 70.6% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 29.4% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 87.8% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari. Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për vitin 2018 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 48.5% dhe 34.5% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2018, dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.85% të të gjitha transaksioneve në këtë treg. Transaksioni i llojit “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2018, ka pasur një rritje prej 484 milionë lekë ose 10.32% krahasuar me vitin 2017. Ndërkohë edhe numri i transaksioneve është rritur në masën 0.68%.

Transaksioni i llojit “Blerje para afatit të maturimit” gjatë vitit 2018, ka pasur një rritje prej 694 milionë lekë ose 27% dhe gjithashtu, një rritje në numrin e transaksioneve në masën 0.1%, krahasuar me vitin 2017. Vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të këtyre dy llojeve transaksionesh të marra së bashku me rreth 1,177 milionë lekë, krahasuar me vitin 2017.

**Tabelë 5: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë**

| <i>Lloji i Transaksionit</i> |                                | <i>Vlera nominale<br/>(në mln. lekë)</i> |                  | <i>Ndryshimi<br/>(në %)</i> |
|------------------------------|--------------------------------|------------------------------------------|------------------|-----------------------------|
|                              |                                |                                          |                  |                             |
| Viti                         |                                | 2017                                     | 2018             | ‘17/‘16                     |
| A                            | <b>Blerje në tregun primar</b> | <b>48,556.49</b>                         | <b>25,640.09</b> | <b>(47.20)</b>              |
|                              | <i>Individë</i>                |                                          |                  | <i>(4.92))</i>              |

|          |                                                      |                  |                  |                |
|----------|------------------------------------------------------|------------------|------------------|----------------|
|          |                                                      | 26,119.69        | 24,833.70        |                |
|          | <i>Persona juridikë</i>                              | 22,436.80        | 806.39           | (96.41)        |
| <b>B</b> | <b>Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar</b> | <b>4,685.59</b>  | <b>5,169.33</b>  | <b>10.32</b>   |
|          | <i>Individë</i>                                      | 4,291.69         | 3,983.53         | (41.41)        |
|          | <i>Persona juridikë</i>                              | 393.90           | 1,185.80         | 201.04         |
| <b>C</b> | <b>Blerje para afatit të maturimit</b>               | <b>2,568.48</b>  | <b>3,262.01</b>  | <b>27.00</b>   |
|          | <i>Individë</i>                                      | 2,551.48         | 2,668.21         | 4.57           |
|          | <i>Persona juridikë</i>                              | 17.00            | 593.80           | 3,392.94       |
| <b>D</b> | <b>Vendosje e bonos si kolateral</b>                 | <b>773.16</b>    | <b>488.56</b>    | <b>(36.81)</b> |
|          | <i>Individë</i>                                      | 506.16           | 296.56           | 75.20          |
|          | <i>Persona juridikë</i>                              | 267.00           | 192.00           | (28.09)        |
| <b>E</b> | <b>Shlyerje e vlerës nominale në maturim</b>         | <b>24,046.12</b> | <b>18,250.39</b> | <b>(24.10)</b> |
|          | <i>Individë</i>                                      | 22,944.28        | 17,615.80        | (23.22)        |
|          | <i>Persona juridikë</i>                              | 1,101.84         | 634.59           | (42.41)        |

### **Tregu i Obligacioneve të Shoqërive Aksionare (Obligacionet e Emetuara me Ofertë Private)**

Duke filluar nga nëntori 2011, tregu i obligacioneve të korporatave nëpërmjet ofertave private ka qenë aktiv. Obligacionet e emetuar nga shoqëritë aksionare me ofertë private u ofrohen investitorëve institucionalë, aksionerëve të vetë emetuesve apo deri 100 individëve. Këto obligacione karakterizohen nga norma interesi fikse, maturime afatgjata dhe kupona gjysmë-vjetore. Disa nga obligacionet e emetuar kanë patur tiparin e konvertueshmërisë në aksione të zakonshme. Shuma totale e obligacioneve të korporatave që u janë ofruar investitorëve nga viti 2011 deri në fund të vitit 2018 ka qenë rreth 11,300 milionë lekë. Edhe gjatë vitit 2018, Autoriteti vijoi me miratimin e prospekteve për emetimin e obligacioneve të paraqitura nga një shoqëri dhe nga institucione financiare (bankë dhe institucion mikrokredie, gjithsej 4 emetime). Gjatë vitit 2018 vlera totale e emetimeve të miratuara arriti në 1,343 milionë lekë, ndërsa shuma e nënshkruar arriti në 1,236 milionë lekë. Baza investitore blerëse e obligacioneve të korporatave përbëhet nga investitorë institucionalë dhe individë.

## 2.3 Aktiviteti i Licencimit

Gjatë vitit 2018, Autoriteti me Vendim Bordi nr. 14, datë 31.01.2018 licenoi shoqërinë administruese të fondeve të investimit “WVP Fund Management Tirana” sh.a., për të kryer veprimtari administrimi të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si dhe krijimin e fondit të investimit “WVP Top Invest”, i administruar nga “WVP Fund Management Tirana” sh.a., shoqëri me kapital të huaj.

Gjatë vitit 2018 u licencuan 3 brokera fizikë për shoqëritë komisionere. Deri në fund të vitit 2018 në tregun e titujve rezultojnë 17 shoqëri komisionere, 29 broker individë, 2 shoqëri këshillimi për investime, 3 këshilltarë individë, 3 agentë të lidhur, 9 kujdestarë të letrave me vlerë, 1 regjistrar që përfaqësohet nga Qendra e Regjistrimit të Aksioneve.

**Tabelë 6: Subjekte të tjera që veprojnë në tregun e titujve 2012-2018**


(Në numër)

|                                            | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|--------------------------------------------|------|------|------|------|------|------|------|
| <b>Subjekte</b>                            |      |      |      |      |      |      |      |
| Bursa Shqiptare e Titujve                  | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 1    | 1    |
| Shoqëri komisionere                        | 13   | 13   | 13   | 14   | 15   | 17   | 17   |
| Broker fizik në shoqëri komisionere        | 18   | 18   | 18   | 19   | 21   | 26   | 29   |
| Kujdestarë të titujve të Qeverisë së R.Sh. | 8    | 8    | 8    | 8    | 8    | 9    | 9    |
| Regjistrues aksionesh                      | 1    | 1    | 1    | 1    | 1    | 1    | 1    |
| Shoqëri këshillimi për investime në tituj  | 0    | 0    | 1    | 1    | 2    | 2    | 2    |
| Këshilltar për investime në tituj          | 0    | 0    | 1    | 1    | 3    | 3    | 3    |
| Agjent i lidhur                            | 1    | 1    | 1    | 2    | 2    | 4    | 3    |

## 2.4 Qeverisja

Në mbështetje të kërkesave ligjore dhe nënligjore, struktura e organizimit dhe drejtimit të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit vullnetar, paraqitet në skemën më poshtë:

**Grafik 7: Skema e strukturës aktuale të drejtimit të shoqërive të administrimit të fondeve të pensione dhe investimeve**



**Tabelë 7: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit vullnetar**

| <i>Subjekte</i>                                               | <i>Numër</i> |
|---------------------------------------------------------------|--------------|
| <b>Shoqëri administruese</b>                                  | <b>4</b>     |
| <b>Aksionarë gjithsej</b>                                     | <b>11</b>    |
| <i>Klasifikimi i aksionerëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i> |              |
| nën 10%                                                       | 3            |
| mbi 10% nën 33 %                                              | 3            |
| mbi 33% nën 50%                                               | 1            |
| mbi 50%                                                       | 4            |

**Tabelë 8: Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës**

| <i>Subjekte</i>           | <i>Numër</i> |
|---------------------------|--------------|
| <b>Aksionarë gjithsej</b> | <b>11</b>    |
| <i>nga të cilët</i>       |              |
| Aksionarë të huaj         | 7            |
| Aksionarë vendas          | 4            |

**Tabelë 9: Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit**

| <i>Subjekte</i>           | <i>Numër</i> |
|---------------------------|--------------|
| <b>Aksionarë gjithsej</b> | <b>11</b>    |
| <i>nga të cilët</i>       |              |
| Aksionarë individ         | 5            |
| Aksionarë shoqëri         | 6            |

**Tabelë 10: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore***(Në numër)*

| <i>Arsyeja e Ndryshimit të Statutit</i> | <i>2013</i> | <i>2014</i> | <i>2015</i> | <i>2016</i> | <i>2017</i> | <i>2018</i> |
|-----------------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Statut i ri/ndryshime të tjera          | -           | 1           | 2           | 2           | -           | -           |
| Rritje kapitali                         | 1           | 1           | -           | -           | 1           | 2           |
| Ndryshim i strukturës aksionere         | 1           | 1           | -           | -           | 1           | -           |

Shoqëritë që operojnë në tregun e titujve janë të organizuara në përputhje me Ligjin “Për shoqëritë tregtare”. Ndërkohë kërkesat për emërimin e administratorëve apo anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës/Administrimit janë të përcaktuara në Ligjin “Për Titujt” apo në bazën rregullative të Autoritetit.

Për një qeverisje sa më të mirë të shoqërive që veprojnë në tregun e titujve, i është kushtuar kujdes pëmbushjes së kërkesave nga personat që mbajnë pozicione drejtuese në shoqëri. Risi për vitin 2018 ka qenë realizimi i intervistave për personat që emërohen administratorë apo anëtarë të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, me qëllim arritjen e një përfundimi mbi përshtatshmërinë dhe aftësinë e tyre.

## **2.5 Inspektimi i Shoqërive**

Autoriteti kreu gjatë periudhës prill-maj 2018 inspektimin në vend, pranë tri shoqërive, të cilat janë miratuar nga AMF për të kryer veprimtarinë e agentit për llogari të shoqërive të huaja të brokerimit që administrojnë platforma të tregtimit online.

Objekti i inspektimit ishte veprimtaria e agentit të brokerit të huaj nga momenti i miratimit nga AMF deri në fund të 3-mujorit të parë të vitit 2018 si dhe respektimi i rregullave në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër terrorizmit.

Respektimi i rregullave për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër terrorizmit u inspektua nga një grup i veçantë, me përfaqësues nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe përfaqësues nga Autoriteti.

Inspektimi u fokusua tek zbatimi i procedurave të brendshme për komunikimin dhe njohjen e klientit; evidentimin e vendndodhjes së klientëve me të cilët komunikohet, verifikimin me zgjedhje të telefonatave të regjistruara, nivelin e komisioneve të përfituara dhe pagesat e stafit, si dhe çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e agjentit. Pas gjetjeve të konstatuara, grupi i inspektimit propozoi rekomandimet përkatëse.

Gjatë muajit tetor-nëntor 2018 Autoriteti realizoi gjithashtu një inspektim në vend pranë një shoqërie (bankë) me objekt kryesor veprimtarinë e shërbimit të kujdestarisë për titujt e Qeverisë për periudhën janar 2017-shtator 2018, si dhe respektimin e rregullave në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër terrorizmit. Inspektimi u fokusua tek: Struktura organizative e njësisë së kujdestarisë; Procedurat/manualët në lidhje me shërbimin e kujdestarisë; Procedura të menaxhimit të rrezikut për shërbimin e kujdestarisë; Procedura të njohjes së klientit dhe të parandalimit të pastrimit të parave e luftës kundër terrorizmit; Sistemi që përdoret për shërbimin e kujdestarisë; Tarifat/komisionet e shërbimit të kujdestarisë (transparenca me klientët, ankesa në lidhje me tarifat/komisionet); Auditimi i veprimtarisë së kujdestarisë; Plani i Rimëkëmbjes dhe vazhdimësisë së Biznesit (*Disaster Recovery and Business Continuity Plan*) për veprimtarinë e kujdestarisë.

Në fund të procesit të inspektimit, gjetjet dhe rekomandimet e propozuara nga Autoriteti iu komunikuan shoqërisë dhe zbatueshmëria e tyre po ndiqet nga Autoriteti në përputhje me afatet kohore të lëna në raportin e inspektimit.

## **2.6 Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor e Rregullativ**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në ushtrim të funksioneve rregullative dhe mbikëqyrëse të tregjeve financiare jobankare, ka hartuar dy projektligje që lidhen me tregun e kapitaleve dhe fondet e investimeve. Projektligjet “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe “Për tregun e kapitaleve”, u hartuan në kuadër të projektit SECO të Qeverisë Zviceriane me objekt forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së, e me fokus në zhvillimin e tregut të kapitaleve. Projektligjet janë konsultuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me Bankën e Shqipërisë, me Shoqatën e Bankave, me grupet e interesit, me shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve e fondeve të investimeve, me aktorët e tregut të titujve, si Bursa, shoqëri brokerimi, etj.

Sa i takon kuadrit rregullator për vitin 2018 dolën akte të reja si edhe u amenduan aktet ekzistuese, si më poshtë:

## **Rregullore të reja**

Rregullorja nr. 16, datë 31.01.2018 “Për formularin e kërkesës, përmbajtjen e dokumentacionit për miratim prospekti për emetimin e obligacioneve”, e cila përcakton mënyrën e aplikimit për miratim të prospektit të emetimit të obligacioneve me ofertë private dhe publike, si dhe dokumentacionin përkatës.

Rregullorja nr. 21, datë 06.02.2018 “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve”, e cila përmban rregulla për shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në lidhje me administrimin e likuiditetit të fondeve të investimeve.

Rregullorja nr. 57, datë 29.03.2018 “Mbi transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar”, e cila vendos rregulla për transaksionet e portofolit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të kryera me palë të lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar, në emër ose drejtpërdrejtë me subjektet e përcaktuara si palë e lidhur me shoqërinë e administrimit të SIK, si dhe me depozitarin e fondit të investimit ose sipërmarrjen e investimeve kolektive.

## **Amendime të akteve ekzistuese**

Me Vendimin nr. 259, datë 28.12.2018, Bordi miratoi një ndryshim në Rregulloren nr. 21, datë 06.02.2018 “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve”, ndryshim i cili lidhet me afatin e raportimit në Autoritet të ndryshimeve të modelit të provës së rezistencës, nga ana e shoqërive administruese të SIK.

Me Vendimin nr. 235, datë 26.11.2018, Bordi me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të raporteve të MONEYVAL të Këshillit të Evropës, miratoi shtesat e ndryshimet në Rregulloren nr. 69, datë 26.05.2011 “Për autorizimin e individëve për shitjen e kuotave/aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike”.

Me Vendim nr. 218, datë 31.10.2018, Bordi miratoi shtesat e ndryshimet në Rregulloren nr. 165, datë 23.12.2008 “Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të investimeve”.

Me Vendimin nr. 142, datë 30.07.2018, Bordi miratoi ndryshimet në Rregulloren nr. 89, datë 27.06.2016 "Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar". Ndryshimet kishin të bënin me përditësimin e emërtimeve të rregullores me ligjin për auditimin ligjor. Gjithashtu, ndryshimet kishin të bënin edhe me unifikimin e rregulloreve të AMF-së për audituesit e jashtëm, në drejtim të afateve të depozitimit të kërkesës, dokumentacionit që dorëzohet në AMF, miratimit/refuzimit nga AMF, etj., si për auditimin e shoqërive të sigurimeve ashtu edhe auditimin e shoqërive administruese të SIK dhe FP.

Me Vendimin nr. 89, datë 13.06.2018, Bordi miratoi ndryshimet në Rregulloren nr. 127, datë 06.10.2011 "Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve". Kështu, ndryshuan afatet për dorëzimin e raporteve dhe u shtua një raportim i ri, ai për transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar, si dhe u përcaktuan afatet për dorëzimin e tyre.

### **Marrëveshja midis AMF dhe Bankës së Shqipërisë**

Me Vendimin nr. 189, datë 27.09.2018, Bordi miratoi marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare "Për bashkëpunimin për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të shlyerjes së titujve dhe shtëpive të klerimit të titujve" dhe autorizoi Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja përcakton kushtet, procedurat, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në procesin e licencimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes së sistemeve të shlyerjes së titujve dhe shtëpive të klerimit të titujve.

#### **2.6.1 Masat Korrigjuese dhe Administrative**

Gjatë vitit 2018 nuk janë marrë vendime për masa korrigjuese dhe administrative përse i përket tregut të kapitaleve dhe atij të fondeve të investimit, por referuar inspektimit të kryer pranë një banke depozitare të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, Autoriteti ka urdhëruar bankën të marrë masa të veçanta që të rimbursojë të gjithë investitorët e fondeve të investimit të cilët kanë kryer shlyerje, në mënyrë të tillë që investitori në përfundim të procesit të rimbursimit të marrë të gjithë vlerën e komisionit të paguar gjatë procesit të shlyerjes. Ky proces ka përfunduar për pjesën më të madhe të investitorëve, ndërsa për pjesën e mbetur ka vijuar ndjekja e rekomandimeve të lëna nga inspektimi.

## **3 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve**

### **3.1 Struktura e Tregut të Sigurimeve**

Në vitin 2018 në total tregu, volumi i primeve të shkruara bruto nga shoqëritë e sigurimit rezultoi 16,930 milionë lekë, me një rritje prej 732 milionë lekë ose 4.5% më shumë se një vit më parë. Në këtë volum primesh 15,785 milionë lekë ose 93.2% e totalit të primeve i përket tregut të Jo-Jetës dhe 1,144 milionë lekë ose 6.7% tregut të Jetës.


Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës shënoi rritje prej rreth 5.3% ndërsa volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës shënoi ulje në masën




5% krahasuar me vitin 2017. Pra, tregu ka ruajtur të njëjtin konfigurim në vite, ku sigurimet e Jetës kanë një volum primesh të ulët krahasuar me ato të Jo-Jetës.

Numri i kontratave të sigurimit të lidhura në total tregu në vitin 2018, arriti në 1,309,143 me një rritje prej rreth 5.9% krahasuar me vitin 2017.

**Grafik 8: Primi i shkruar bruto, sipas llojit të sigurimit Jo-Jetë dhe Jetë, viti 2018**  
(Në mln. lekë)



**Grafik 9: Ndarja e primit të shkruar bruto sipas linjës biznesit të Jo-Jetës për vitin 2018**  
(Në %)




Sigurimi i detyrueshëm motorik zë 68% të tregut të Jo-Jetës me një volum primesh 10,733 milionë lekë dhe me një rritje prej 7.7% krahasuar me një vit më parë. Sipas grafikut të

mësipërm vendin e dytë në ndarjen e tregut e zë portofoli “Zjarri e dëmtime në pronë” me një volum primesh 2,096 milionë lekë ose me një rritje në volum primesh prej 9%.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e aksidenteve dhe shëndetit në vitin 2018 arritën 1,134 milionë lekë ose 4.7% më pak se një vit më parë.

**Grafik 10: Ndarja e tregut - Sigurimi i Jo-Jetës për vitin 2018**


(Në %)



Në volumin e primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jetës pjesën më të madhe e zë sigurimi “Jetë Debitori” me 723 milionë lekë ose 38.6% më shumë se një vit më parë.

**Grafik 11: Ndarja e tregut - Sigurimi i Jetës për vitin 2018**

(Në %)




**Tabelë 11: Volumi i primeve në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në 2017**

| <b>Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore</b> | <b>Primi i Shkruar Bruto (Mln. Euro)</b> | <b>Primi i Shkruar Bruto / GDP</b> | <b>Primi i Shkruar</b> | <b>Raporti i primit të sigurimit të Jetës ndaj totalit të tregut (%)</b> |
|----------------------------------------------|------------------------------------------|------------------------------------|------------------------|--------------------------------------------------------------------------|
| Bosnje Hercegovina                           | 349                                      | 2.18                               | 100                    | 20.40                                                                    |
| Bullgari                                     | 1,126                                    | 2.23                               | 159                    | 20.40                                                                    |
| Estoni                                       | 427                                      | 1.86                               | 326                    | 21.37                                                                    |
| Hungari                                      | 3,057                                    | 2.48                               | 312                    | 48.60                                                                    |
| Kosovë                                       | 87                                       | 1.36                               | 47                     | 2.87                                                                     |
| Kroaci                                       | 1,205                                    | 2.49                               | 290                    | 32.47                                                                    |
| Letoni                                       | 646                                      | 2.41                               | 331                    | 22.45                                                                    |
| Lituani                                      | 793                                      | 1.89                               | 281                    | 29.17                                                                    |
| Mal i Zi                                     | 82                                       | 1.94                               | 131                    | 17.27                                                                    |
| Maqedoni                                     | 146                                      | 1.45                               | 70                     | 16.11                                                                    |
| Poloni                                       | 14,950                                   | 3.15                               | 394                    | 39.39                                                                    |
| Republika Ceke                               | 5,906                                    | 2.99                               | 558                    | 38.17                                                                    |
| Rumani                                       | 2,125                                    | 1.13                               | 108                    | 20.79                                                                    |
| Serbi                                        | 789                                      | 2.08                               | 112                    | 24.35                                                                    |
| Shqipëri *                                   | 133                                      | 1.05                               | 46                     | 6.75                                                                     |
| Slovaki                                      | 2,135                                    | 2.51                               | 393                    | 50.27                                                                    |
| Sloveni                                      | 2,179                                    | 5.04                               | 1,055                  | 29.99                                                                    |
| <b>Totali</b>                                | <b>36,123</b>                            | <b>2.60</b>                        | <b>299</b>             | <b>36.54</b>                                                             |

\*Te dhenat për Shqipërinë janë për vitin 2018


**Grafik 12: Primi i shkruar bruto/GDP (Penetrimi në %) për vitin 2017**  
(në %)



## Dëme të paguara bruto


Totali i dëmeve të paguara bruto në vitin 2018 në tregun e sigurimeve kapi shifrën 6,983 milionë lekë e cila është 1,449 milionë lekë ose rreth 26.2 % më shumë se në vitin 2017.

**Grafik 13: Dëme të paguara bruto në total**




**Grafik 14: Ndarja e dëmeve të paguara bruto sipas linjës së biznesit, viti 2018**

*(Në %)*



**Grafik 15: Dëme të paguara bruto sipas linjës së biznesit në vite**

(Në lekë)



### 3.2 Pozicioni Financiar

Në zbatim të kuadrit rregullator ekzistues, AMF ka mbikëqyrur dhe analizuar tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit gjatë vitit 2018. AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesave ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij.

#### Fondi i Garancisë

Fondi i garancisë është një shumë në mjete monetare (vlera e së cilës është përcaktuar në nenin 81 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”) e depozituar nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit në një llogari bankare qëllimore me të njëjtin emër, në bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku shoqëria ka selinë qendrore të saj, e detyrueshme për t’u disponuar nga siguruesi që nga çasti i fillimit të veprimtarisë dhe në vazhdim. Shoqëritë e sigurimit zotërojnë Fondin e Garancisë të investuar në “depozita qëllimore” me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe në bono thesari. Fondi i Garancisë në nivel tregu për 11 shoqëri siguri dhe një shoqëri risigurimi duhet të jetë 4,440 milionë lekë.

Në 31.12.2017 Fondi i Garancisë së shoqërive të sigurimit, në nivel tregu është investuar në depozita me afat maturimi jo më pak se 1 vit pranë bankave tregtare si dhe në letra me vlerë. Nga shqyrtimi i të dhënave të raportimeve financiare të 31.12.2018, të pasqyruara në tabelat

Totali i aktiveve në periudhën 31.12.2018 ka qenë 31,512 milionë lekë dhe krahasuar me vitin 2017, ky zë është rritur me 933 milionë lekë ose 3.1%. Kjo rritje vjen vetëm nga sektori i sigurimit Jo-Jetë, i cili u rrit me 989 milionë lekë ose 3.3 %, ndërsa tregu i sigurimit të Jetës ka pësuar një rënie prej 56 milionë lekë ose -1.7%.


**Tabelë 12 : Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Aktivet**

(Në mln. lekë)

|                             | 31.12.'14     | 31.12.'15     | 31.12.'16     | 31.12.'17     | 31.12.'18     |
|-----------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| <b>Totali i aktiveve</b>    | <b>24,451</b> | <b>27,610</b> | <b>29,422</b> | <b>30,579</b> | <b>31,512</b> |
| Jeta                        | 4,009         | 3,857         | 3,287         | 3,382         | 3,326         |
| Jo-Jeta                     | 20,442        | 23,752        | 26,135        | 27,197        | 28,186        |
| <b>Totali i investimeve</b> | <b>15,721</b> | <b>18,996</b> | <b>18,811</b> | <b>19,409</b> | <b>20,655</b> |
| Jeta                        | 2,684         | 2,904         | 2,743         | 2,839         | 2,821         |
| Jo-Jeta                     | 15,175        | 16,092        | 16,068        | 16,570        | 17,834        |

**Grafik 16: Totali i aktiveve sipas linjës së biznesit në vite**

(Në mln.lekë)




Investimet dominuan totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit. Këto investime në 31.12.2018, paraqiten me një vlerë prej 20,655 milionë lekë. Rritja e investimeve nga viti i kaluar në vlerë absolute ka qenë 1,246 milionë lekë ose 6.4%.

Investimet janë përqendruar në depozita me afat në institucione krediti (banka), Letra me vlerë të Qeverisë shqiptare dhe në toka dhe ndërtesa. Depozitat zënë peshën kryesore me 33.5%, duke u ndjekur nga toka dhe ndërtesa me rreth 10.6% dhe Letra me vlerë të Qeverisë me 8.4%.


**Grafik 17: Totali i investimeve sipas linjës së biznesit në vite**

(Në mln. lekë)



**Grafik 18: Struktura e Aktivit**

(Në %)



Peshën kryesore në strukturën e pasivit të shoqërive të sigurimit e mbartin zërat e provigjoneve teknike, ku llogariten provigjonet për primin e pafituar për pjesën që i përket periudhës së rrezikut pas datës së mbylljes së vitit financiar dhe provigjonet e dëmeve, si dhe “kapitalet e veta” të cilat përfaqësojnë interesin e mbetur në aktivet e entitetit pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të tij.

**Tabelë 13 : Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Pasivi**

(Në mln. lekë)

|                                         | 31.12.'14     | 31.12.'15     | 31.12.'16     | 31.12.'17     | 31.12.'18     |
|-----------------------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| <b>Totali i Pasivit</b>                 | <b>24,451</b> | <b>27,610</b> | <b>29,688</b> | <b>30,579</b> | <b>31,512</b> |
| Jeta                                    | 4,009         | 3,857         | 3,287         | 3,382         | 3,326         |
| Jo-Jeta                                 | 20,442        | 23,752        | 26,401        | 27,197        | 28,186        |
|                                         | <b>2,014</b>  | <b>2,015</b>  | <b>2,016</b>  | <b>2,017</b>  | <b>2,018</b>  |
| <b>Provigjonet teknike bruto</b>        | <b>11,191</b> | <b>14,014</b> | <b>15,568</b> | <b>15,840</b> | <b>16,390</b> |
| Jeta                                    | 1,522         | 1,605         | 1,690         | 1,702         | 1,726         |
| Jo-Jeta                                 | 9,667         | 12,409        | 13,878        | 14,138        | 14,664        |
| <b>Totali i kapitaleve të veta</b>      | <b>9,954</b>  | <b>10,120</b> | <b>9,688</b>  | <b>9,418</b>  | <b>10,657</b> |
| Jeta                                    | 1,988         | 1,782         | 1,503         | 1,542         | 1,510         |
| Jo-Jeta                                 | 7,966         | 8,338         | 8,185         | 7,876         | 9,148         |
| <b>Totali i kapitalit të nënshkruar</b> | <b>8,156</b>  | <b>8,196</b>  | <b>7,721</b>  | <b>6,953</b>  | <b>7,365</b>  |
| Jeta                                    | 1,359         | 1,227         | 1,234         | 1,221         | 1,230         |
| Jo-Jeta                                 | 6,797         | 6,969         | 6,487         | 5,732         | 6,135         |


Provigjonet teknike bruto kanë patur një trend pozitiv rritjeje për periudhën 2014-2018. Ky trend pozitiv ka vazhduar edhe në vitin 2018, ku provigjonet teknike bruto në total për tregun e sigurimeve krahasuar me vitin 2017 janë rritur me 550 milionë lekë ose 3.5%. Rritjen më të madhe e ka pasur sektori i sigurimit të Jo-Jetës me 526 milionë lekë ose 3.7%, ndërsa sektori i sigurimit të Jetës është rritur me 24 milionë lekë ose 1.4% të vlerës që ky zë ka pasur në periudhën 2017. Trendi pozitiv i rritjes së provigjoneve teknike në vlerë absolute është reflektuar edhe në peshën specifike që ky zë përfaqëson në totalin e pasivit e paraqitur edhe në grafikun më poshtë. Në vitin 2018, pesha specifike e provigjoneve teknike në strukturën e Pasivit të tregut të sigurimeve ishte 52%, duke u rritur me 0.2% nga periudha e kaluar financiare.

Kapitalet e veta, si rrjedhojë e mbajtjes së fitimit të periudhës, rritjes së rezervave të rivlerësimit të kapitalit, si dhe shtesës së kapitalit themeltar të shoqërive të sigurimit në 2018 pësuan rritje me 13.1% krahasuar me vitin 2017. Kjo rritje pasqyrohet dhe në rritjen e peshës specifike të këtij zëri në strukturën e pasivit të tregut të sigurimeve duke shkuar në 32.6% nga 30.8% që zinte në vitin 2017.



**Grafik 19: Struktura e Pasivit**

(Në %)




Sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” aktivet në mbulim të provigjoneve teknike janë aktivet e shoqërisë së sigurimit, të cilat shërbejnë për mbulimin e përgjegjësisë të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe që mbulojnë humbje, si pasojë e rreziqeve që lindin nga ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, për të cilat kjo e fundit detyrohet të krijojë provigjone teknike.

Aktivët në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në 31.12.2018 për tregun e sigurimeve në total janë në vlerën 16,666 milionë lekë, ku për tregun e sigurimit të Jo-Jetës janë në vlerën 14,776 milionë lekë dhe për tregun e sigurimit të Jetës në vlerën 1,890 milionë lekë.

**Grafik 20: Struktura e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike**


(Në %)



Rezultati financiar neto i tregut të sigurimeve për vitin 2018 është pozitiv në vlerën 703 milionë lekë, ku për tregun e sigurimit Jo-Jetë rezultoi në vlerën 542.6 milionë lekë dhe për tregun e sigurimit të Jetës rezultoi në vlerën 160.4 milionë lekë.

**Grafik 21: Rezultati financiar për tregun e sigurimeve sipas linjës së biznesit**


(Në mln. lekë)



Raporti dëme/prime neto për tregun e sigurimit të Jo-Jetës, përfshirë dhe pagesat bruto për Fondin e Kompensimit, është në masën 42.2%, duke u rritur me 4.9% krahasur me vitin 2017. Ndërkohë që raporti i kombinuar për tregun e sigurimit Jo-Jetë është në masën 97.2% në nivele të pranuar.

**Grafik 22: Raporti dëme prime/raporti i kombinuar, përfshirë pagesat për Fondin e Kompensimit**

(Në %)



### **3.1 Inspektimi në shoqëritë e sigurimeve**

#### **Inspektime të plota me fokus rrezikun**

Edhe gjatë vitit 2018, Autoriteti vijoi me inspektimin e plotë në vend në tri shoqëri sigurimi të Jetës sipas metodologjisë me fokus rrezikun, bazuar në Manualin e Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit. Inspektimi u përqendrua në strukturimin e procedurave të inspektimit dhe hartimin e planit të intervistave me nivelet e drejtimit të shoqërive të sigurimit. Gjithashtu u vlerësuan rreziqet e pranishme sipas aktiviteteve të biznesit në shoqëritë e inspektuara, si dhe administrimi dhe mitigimi i këtyre rreziqeve nga drejtuesit e lartë të shoqërisë. Me inspektimin e plotë në vend në shoqëritë e sigurimit të jetës, u plotësua dhe cikli i plotë i inspektimeve sipas metodologjisë me fokus rrezikun në të gjithë tregun e sigurimeve. Në mënyrë më të detajuar këto inspektime u përqendruan në:

- Vlerësimin e rrezikut të kreditit në marrëdhënie me risiguruesit, mbledhjen e primeve dhe aktivitete të tjera të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut të sigurimit, duke u fokusuar kryesisht tek marrja në sigurim dhe rreziqet e përgjegjëseve, si dhe aktivitete të tjera të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut operacional, duke u fokusuar tek provigjonet, vlerësimi i dëmeve, procedurat e trajtimit të dëmeve, sistemet e teknologjisë së informacionit, performanca operationale, si edhe aktivitete të tjera të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut rregullator dhe strategjik në drejtim të vlerësimit të Fondit të Garancisë;
- Vlerësimin e fuqisë së kapitalit dhe cilësisë së fitimeve;
- Vlerësimin e elementëve të veçantë të aktiveve të pasqyrave financiare të shoqërisë;
- Menaxhimin e rrezikut, sistemet e kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe mbikëqyrjen e veprimtarisë nga nivelet drejtuese të shoqërisë.

Në përfundim të inspektimeve, Autoriteti hartoi profilin e rrezikut për shoqëritë e inspektuara, i cili përfaqëson vlerësimin e tij për secilin nga rreziqet e shoqërisë në tregun të sigurimeve. Inspektimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun përqendrohet në përgjegjësitë e këshillit mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit në drejtim të ruajtjes së sigurisë dhe stabilitetit financiar të shoqërisë.

#### **Inspektime Tematike**

Gjatë vitit 2018 janë kryer 8 inspektime tematike në shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë duke rritur numrin e tyre krahasuar me vitin 2017 ku u kryen 3 inspektime tematike. Këto inspektime kanë pasur objekt verifikimin e procesit të trajtimit të dëmeve në 6 inspektime

dhe zbatimin e rekomandimeve të vendimeve të Bordit të Autoritetit në 2 inspektive. Inspektive tematike në shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë me objekt inspektimi procesin e trajtimit të dëmeve, në përputhje me kërkesat e manualit të ri të dëmeve. Konkretisht u kryen verifikime në lidhje me:

- Rregullat e brendshme, procedurat dhe struktura e administrimit të dëmeve nga shoqëria në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Procedurat e komunikimit me kërkuesin e dëmshpërblimit, përfshirë kërkesat për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve të dëmeve;
- Sistemet e informacionit të administrimit të dëmeve dhe saktësia e të dhënave;
- Praktikrat e provigjonimit të dëmeve, dëmet e papaguara, pagesat e dëmeve si dhe shpenzimet për trajtimin e dëmeve;
- Dëmet e refuzuara, ankesat e përfituesve dhe rastet e mashtrimit;
- Zbatimi i vendimeve të Bordit dhe rekomandimeve të lëna nga Autoriteti në inspektimet e mëparshme;

#### **Problematikat kryesore nga këto inspektive rezultuan si më poshtë:**

- Mungesë e procedurave dhe rregulloreve të brendshme të shoqërive kryesisht lidhur me trajtimin e dëmeve për produktet vullnetare si dhe lidhur me komunikimin midis departamenteve për rakordimin e dëmeve
- Mungesa në dokumentacionin e dosjeve të dëmeve sipas kërkesave të Rregullores Nr. 53, datë 25.06.2009 (e ndryshuar).
- Moszbatimi i kërkesave të nenit 11, të Rregullores Nr. 53, datë 25.06.2009 (e ndryshuar) lidhur me kryerjen e vlerësimit të dëmeve vetëm nga vlerësues të dëmeve të licensuar nga Autoriteti.
- Mos funksionim i plotë dhe i saktë i programeve informatike për bazën e të dhënave të dëmeve që përdoren në llogaritjen e provigjoneve teknike.
- Moszbatimi i kërkesave të Rregullores nr. 9, datë 25.01.2016 “Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti” lidhur me provigjonimin e dëmeve pezull.
- Moszbatimi i kërkesave të pikave 3 dhe 4 të nenit 17, të Rregullores Nr. 53 datë 25.06.2009 (e ndryshuar), lidhur me përcaktimin e koeficientit të humbjes së aftësisë për punë, si element i rëndësishëm në llogaritjen e vlerës së dëmit shëndetësor.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të vendimeve të Bordit të Autoritetit u kryen 2 inspektive tematike në shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë me objekt “Verifikimin e zbatimit të kërkesave të Vendimit të Bordit të Autoritetit”.

## Inspektime të përbashkëta

Gjatë vitit 2018 janë kryer 7 inspektime të përbashkëta me institucione të tjera nga 2 që janë kryer në vitin 2017.


- AMF bazuar në Manualin e Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave, miratuar me Vendim Bordi nr. 136, datë 29.09.2016 ka kryer 3 inspektime me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Këto inspektime janë kryer paralelisht me inspektimet me fokus rrezikun pranë shoqërive të Jetës, të cilat janë subjekte të ligjit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- 2 inspektime me Bankën e Shqipërisë pranë 2 bankave tregtare me objekt verifikimin në vend të policave të sigurimit me përfitues bankat, të vlerave monetare të shoqërisë së sigurimit dhe verifikimin e praktikave të dëmeve pezull me përfitues Bankat;
- 2 inspektime tematike me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve pranë shoqërive të sigurimit në kuadër të marrëveshjes me këtë institucion.

## 3.2 Provigjonet Teknike

Në kuadrin e analizës së shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit, AMF vlerëson, nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme dhe në përputhje me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mjaftueshmëria e provigjoneve teknike, vlerësohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të rrezikut.

Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike ndër vite shfaq një tendencë në rritje, duke ruajtur dhe strukturën e aktivitetit Jetë dhe Jo-Jetë. Kështu, në vazhdimësi, peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, e cila reflektohet edhe në strukturën e tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjonit teknik të dëmeve dhe primeve, duke reflektuar përpjekjet e vazhdueshme të Autoritetit në drejtim të përmirësimit të këtij treguesi. AMF ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjonit teknik të dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni i marrë nga palë të treta (gjykatat, për dëmet në proces gjyqësor) lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë.

**Grafik 23: Provigjoni teknik bruto***(Në mln. lekë)***Provigjoni Teknik Bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik (MTPL)**

Provigjoni teknik bruto për produktin e MTPL-së zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Për 31.12.2018 ky tregues ka pësuar rritje krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 73% kundrejt 69% që rezultoi në fund të vitit 2017. Kjo, për shkak të rritjes që kanë pësuar provigjonet teknike bruto për tregun e Jo-Jetës krahasuar me fundin e vitit 2017. Struktura e provigjoneve teknike reflektohet edhe në strukturën e tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, me një përqendrim të lartë në sigurimin e detyrueshëm.

**Tabelë 14: Pesha e dhe struktura provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm***(Në mln. lekë)*

| <i><b>Pesha e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm</b></i>         | <i><b>2012</b></i> | <i><b>2013</b></i> | <i><b>2014</b></i> | <i><b>2015</b></i> | <i><b>2016</b></i> | <i><b>2017</b></i> | <i><b>2018</b></i> |
|--------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Provigjone bruto total MTPL                                                    | 4,903              | 5,876              | 7,606              | 8,259              | 9,757              | 9,824              | 10,710             |
| Provigjone bruto total Jo-Jeta                                                 | 7,375              | 7,980              | 9,663              | 12,410             | 13,866             | 14,138             | 14,707             |
| Pesha specifike (në %) e sigurimeve të detyrueshme kundrejt totalit për tregun | 66%                | 74%                | 79%                | 67%                | 70%                | 69%                | 73%                |
| <i><b>Struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të</b></i>                 | <i><b>2012</b></i> | <i><b>2013</b></i> | <i><b>2014</b></i> | <i><b>2015</b></i> | <i><b>2016</b></i> | <i><b>2017</b></i> | <i><b>2018</b></i> |

|                                      |      |      |      |      |      |      |      |
|--------------------------------------|------|------|------|------|------|------|------|
| <b>detyrueshëm</b>                   |      |      |      |      |      |      |      |
| Provigjoni teknik për dëmet MTPL     | 56%  | 52%  | 53%  | 52%  | 52%  | 52%  | 54%  |
| Provigjoni i primit të pafituar MTPL | 44%  | 48%  | 47%  | 48%  | 48%  | 48%  | 46%  |
| Provigjone bruto total MTPL          | 100% | 100% | 100% | 100% | 100% | 100% | 100% |

Përsa i përket strukturës së provigjonit teknik të sigurimit të detyrueshëm në vazhdimësi vërehet që peshën më të lartë e mban provigjoni teknik i dëmeve në krahasim me provigjoniin e primit të pafituar. Edhe gjatë 2018 është ruajtur e njëjta strukturë ndarjeje, në linjë me ecurinë e tarifimit të produkteve të ofruara të sigurimit të detyrueshëm motorik, tregues i cili shfaq efektin e tij tek provigjoni i primit të pafituar.

### **Primet e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik**

#### **Primi i rrezikut**

Në kuadrin e projektit të Bankës Botërore *First Initiative*, lidhur me liberalizimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik, shoqëritë e sigurimit janë njohur dhe kanë pranuar modelin e llogaritjes së primit të rrezikut për kontratën e sigurimit të detyrueshëm motorik TPL, metodologji e cila është përshtatur dhe përdorur edhe në vlerësimin e primit të rrezikut për kontratën e sigurimit të Kartonit Jeshil dhe atë Kufitar.

Bazuar në kërkesat e kësaj metodologjie, ku elementët kryesorë për përcaktimin e primit të rrezikut, janë frekuenca dhe kostoja mesatare e dëmeve, shoqëritë e sigurimit marrin në konsideratë inflacionin e dëmit ndër vite si dhe bëjnë projeksionin e tij për periudhat e ardhshme financiare, element ky i rëndësishëm në përcaktimin e një vlere sa më të saktë të primit të rrezikut të ardhshëm.

Autoriteti, mbi bazën e të dhënave të shoqërive të sigurimit, llogarit primin e rrezikut në nivel tregu për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik brenda datës 31 mars të çdo viti. pasardhës. Në vijim, shoqëritë e sigurimit llogaritin nivelin e provigjoneve teknike të primit të pafituar të sigurimit të detyrueshëm motorik, duke u kujdesur që njëherazi:

- i. Provigjonet teknike të llogariten për çdo policë siguri;
- ii. Vlera e provigjoneve teknike të jetë të paktën sa vlera më e lartë midis primit të rrezikut të llogaritur nga vetë shoqëria e sigurimit dhe primit të rrezikut në nivel tregu të llogaritur nga Autoriteti.

#### **Primi mesatar i sigurimit**

Primi i paguar nga të siguruarit përfshin primin e rrezikut, pjesën e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet, si dhe pjesën e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit.

Primi mesatar i paguar nga të sigurvearit për sigurimin e detyrueshëm motorik është i pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

**Tabelë 15: Primi mesatar për sigurimin e detyrueshëm motorik**

| Lloji i sigurimit      | Primi Mesatar (në lekë) |        |        | Ndryshimi në % | Ndryshimi në % |
|------------------------|-------------------------|--------|--------|----------------|----------------|
| Viti                   | 2016                    | 2017   | 2018   | 18/^17-1       | 18/^16-1       |
|                        |                         |        |        |                |                |
| Sigurimi i Detyrueshëm | 15,841                  | 15,700 | 15,398 | (1.9)          | (2.9)          |
| TPL e Brendshme        | 18,209                  | 18,128 | 18,534 | 2.2            | 1.8            |
| Karton Jeshil          | 13,012                  | 13,125 | 10,512 | (19.9)         | (23.8)         |
| Kufitare               | 7,875                   | 6,910  | 6,648  | (3.8)          | (18.5)         |
|                        |                         |        |        |                |                |

Në sigurimin TPL e brendshme primi mesatar arriti afërsisht 18,534 lekë me një rritje prej 2.2% krahasuar me vitin 2017.

Në sigurimin Karton Jeshil, primet e shkruara Bruto në vitin 2018, kanë patur një rritje prej 1.65% krahasuar me vitin 2017 dhe 5.83% krahasuar me vitin 2016. Numri i kontratave në vitin 2018 pati një rritje prej 26.82% krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë kjo rritje u shoqërua me një prim mesatar 20% më të ulët se viti 2017, të shpjeguar sipas faktorëve:

- Rreth 7 % e ndryshimit të primit të sigurimit vjen si pasojë e kursit të këmbimit dhe;
- Rreth 13% si pasojë e lëshimit të policave të veçanta për të sigurvearit që udhëtojnë drejt Republikës së Malit të Zi, territor në të cilin limitet e përgjegjësisë janë më të ulëta se vendet e BE.

Polica kufitare ka pësuar një rënie të lehtë me rreth 3.7% krahasuar me vitin 2017.



## Risigurimet

Bazuar në kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore të miratuara nga Autoriteti, shoqëria e sigurimit është e detyruar të risigurojë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të siguruar që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit.

Për produkte dhe raste të veçanta sigurimi, shoqëritë e sigurimit kanë kryer transferim të rrezikut, me anë të kontratave të risigurimit fakultativ, për të zbutur efektet financiare të dëmeve të mëdha dhe ato të mundshme.

### Risigurimi fakultativ

Risigurimi fakultativ nënkupton transferimin e një pjese të një rreziku të veçantë të siguruar nga shoqëria e sigurimit tek shoqëria e risigurimit, sipas një kontrate të veçantë të risigurimit.

Strategjia e ndjekur nga tregu i sigurimit për transferimin e rrezikut, në përgjithësi, është realizuar nëpërmjet bashkësigurimit (kalimit të një pjese të rrezikut të kontratës së sigurimit në një kompani tjetër sigurimi), kalimit në risigurim të portofoleve të sigurimit, si dhe mbulimit me risigurim fakultativ të kontratave të veçanta.

Në bazë të kërkesave rregullatore, shoqëritë e sigurimit, raportojnë në Autoritet programin e risigurimit. Bazuar në funksionin e saj mbikëqyrës, AMF ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave specifike të lidhura, duke synuar të sigurojë stabilitetin e vazhdueshëm financiar në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kriteret e lidhura me cilësinë e risiguruesve.

Marrëveshjet risiguruese në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë të formës jo proporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim humbjeje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguruese të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe të tipit *Quota Share*.

Primet e ceduara në risigurim për 31.12.2018 rezultojnë:

- Për totalin e tregut të sigurimeve në vlerën prej 2.87 miliardë lekë ose sa 16.99% e vlerës së primeve të shkruara bruto në nivel tregu;
- Për sigurimin e Jo-Jetës në vlerën prej 2.83 miliardë lekë ose sa 17.96% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën prej 41.67 milionë lekë ose sa 3.64% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës.


Vlera e primeve të ceduara në risigurim krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017:

- Në nivel tregu, është ulur me rreth 206 milionë lekë ose 6.70%;

- Për sigurimin e Jo-Jetës, është ulur me rreth 212 milionë lekë ose 6.98%;
- Për sigurimin e Jetës, është rritur me rreth 6 milionë lekë ose 16.86%.


**Grafik 24: Ecuria e primeve të ceduara në risigurim për periudhën 2011 – 2018**

(Në mln. lekë)




**Grafik 25: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, total i tregut**

(Në %)




**Grafik 26: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto Jo-Jetë**

(Në %)



**Grafik 27: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto Jetë**

(Në %)



Pjesëmarrësit kryesorë në kontratat e risigurimit, sikurse edhe gjatë viteve të kaluara për sigurimin e Jo-Jetës kanë qenë *VIG Re*, *UNIQA Re*, *Munich Re*, *Hannover Re*, *Swiss Re*, *Partner Re*, *Scor*, *Lloyd's syndicates*, etj. Për sigurimin e Jetës, shoqëria e vetme risiguruese e përfshirë në këtë program është *Scor Global Life*. Më shumë se 90% e partnerëve risigurues të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BB nga *Standard & Poors*, nga ku mbi 60% kanë klasifikim më të lartë se A.

## Raportet e vetëvlerësimit të rreziqeve (ORSA)

Në zbatim të kërkesave dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 18, datë 28.04.2015 për “Rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”, shoqëritë e sigurimit gjatë vitit 2017 kanë paraqitur raportin vjetor mbi vlerësimin e rreziqeve të shoqërisë. Autoriteti ka analizuar raportet e vetëvlerësimit të shoqërive të sigurimit, ku vëmendje e veçantë i është kushtuar shqyrtimit të:

- Strategjive, me anë të të cilave përcaktohet qasja e shoqërisë së sigurimit për të trajtuar zonat e veçanta të rrezikut dhe detyrimet ligjore e rregullatore;
- Politikave, me anë të të cilave përcaktohen procedurat dhe kërkesat e tjera që janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, drejtuesit e lartë ekzekutivë, funksionarët kryesorë dhe punonjësit e shoqërisë së sigurimit;
- Procese, me anë të të cilave zbatohen strategjitë dhe politikat e shoqërisë së sigurimit;
- Kontrolle, me anë të të cilave sigurohet që strategjitë, politikat dhe proceset ekzistojnë, mbikëqyren dhe funksionojnë në përmbushje të objektivave.

Në vijim të analizimit të raporteve të vetëvlerësimit, në kuadër të mbikëqyrjes dhe të monitorimit, u bë i mundur nga Autoriteti një vlerësim perspektiv për aftësinë paguese të shoqërive të sigurimit, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin në të ardhmen të këtij raporti.

### Mbi amendimin e koeficientëve të llogaritjes së shumës së kapitalizuar

Gjatë vitit 2018 me Vendimin e Bordit nr. 72, datë 04.04.2018, është amenduar Rregullorja nr. 53 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Ndryshimet e miratuara kanë hyrë në fuqi në 1 korrik 2018 dhe do të zbatohen në të gjitha rastet e llogaritjes së dëmeve shëndetësore (pasurore) që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Këto ndryshime lidhen me përcaktimin e tabelës së përditësuar në lidhje me koeficientët e llogaritjes së shumës së kapitalizuar. Koeficientet e rinj janë të ndarë sipas gjinive dhe bazohen në dy elementë:

- Jetëgjatësinë mesatare të ardhshme të individëve, e llogaritur në bazë të tabelave të mortalitetit;
- Normën e interesit të përdorur për kapitalizimin.

Sa më e lartë të jetë jetëgjatësia mesatare e individëve, aq më i lartë është koeficienti i shumës së kapitalizuar, ndërsa sa më e lartë të jetë norma e interesit të marrë në konsideratë aq më i ulët është koeficienti i shumës së kapitalizuar.

Koeficientet e përdorur deri tani i referoheshin koeficienteve të publikuar nga studimet mbi popullsinë në vitin 1922 të publikuar në Itali, të cilët janë përfutur nga Cencus i popullsisë në periudhën 1901–1911. Me përditësimin e të dhënave të jetëgjatësisë nga INSTAT, aktuarët e AMF-së kanë llogaritur koeficientet e rinj (të anuiteteve të përjetshme).

Amendimi i Rregullores nr. 53, në funksion të mbrojtjes konsumatore, do të ketë ndikim në dëmshpërblimin e palëve të dëmtuara, pasi vlera e dëmeve shëndetësore pritet të rritet në mënyrë të konsiderueshme.

Shqipëri operojnë dy shoqëri sigurimi me kapital vendas pjesë e të njëjtit grup sigurimi. Gjithshtu, operojnë edhe katër shoqëri sigurimi të cilat janë pjesë e grupeve ndërkombëtare të sigurimit, Uniq Insurance Group (UIG) dhe Vienna Insurance Group (VIG), me kapital të huaj austriak.

Autoriteti, në kuadër të një mbikëqyrjeje efektive të grupeve të sigurimit, në përputhje edhe me parimet themelore të sigurimit (ICP) sipas ICP 23 “Për mbikëqyrjen e grupeve”, të hartuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me mbikëqyrësit e shteteve ku operojnë shoqëritë e sigurimit me kapital shqiptar dhe mbikëqyrësit e grupeve të sigurimit ndërkombëtar që operojnë në Shqipëri.

Gjatë vitit kalendarik 2018, përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare morën pjesë në takimet e përvitshme të kolegjeve të mbikëqyrjes të grupeve të sigurimeve UNIQA Insurance Group (UIG), Vienna Insurance Group (VIG), të cilat organizohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Austrisë (FMA). Kolegjet e mbikëqyrjes kanë si qëllim shkëmbimin e informacionit në lidhje me ecurinë e grupeve të sigurimit, në funksion të një mbikëqyrjeje financiare sa më efektive. Përfaqësuesit e AMF-së raportuan gjithashtu pranë FMA-së mbi mbarëvajtjen e veprimtarive të shoqërive të sigurimit, pjesë e grupeve UIG, VIG, që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri, mbi prezantimin e rreziqeve që karakterizojnë funksionimin e tyre në tregun shqiptar, si dhe sjelljen në vëmendje të çështjeve dhe problematikave të konstatuara, si nga mbikëqyrja në distancë *off-site*, ashtu edhe nga mbikëqyrja në vend *on-site*.

Në vijimësi si edhe në zbatim të Strategjisë 2018 - 2022 Autoriteti me Vendimin e Bordit nr. 250, datë 28.12.2018, miratoi Udhëzimin Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”. Objekti i këtij udhëzimi metodologjik është vendosja e rregullave të përgjithshme dhe një sistemi bashkëpunimi midis institucioneve mbikëqyrëse, si Kolegj Mbikëqyrës të Grupit të Sigurimit, me qëllim shkëmbimin e informacionit në funksion të mbikëqyrjes efektive në nivel grupi për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të huaja.

Rregullat e përgjithshme të vendosura nga ky udhëzim, vendosin disa standarde se si do të kryhet raportimi, format e raportimit dhe afatet kohore të tij. Shoqëria e kontrolluar në një grup sigurimi i raporton Autoritetit.

### **3.4 Qeverisja e Shoqërive të Sigurimit**

Shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar janë të organizuara sipas sistemit me një dhe me dy nivele qeverisjeje. Në shoqëritë me një nivel qeverisjeje, këshilli i administrimit ushtron funksionet e administrimit dhe të mbikëqyrjes, ndërsa tek shoqëritë me dy nivele qeverisjeje, këshilli mbikëqyrës ushtron funksione mbikëqyrjeje dhe

administratori, apo bordi i drejtorëve, ushtron funksione administrimi. Gjatë vitit 2018, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo riemërime në përbërjen e këshillave mbikëqyrës të katër shoqërive të sigurimi, si dhe ka miratuar emërime në organet drejtuese të tyre.

**Tabelë 16: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit**

| Subjekte                                                      | Numër     | %     |
|---------------------------------------------------------------|-----------|-------|
| Shoqëri sigurimi                                              | <b>11</b> |       |
| Aksionarë gjithsej                                            | <b>35</b> |       |
| <i>Klasifikimi i aksionerëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i> |           | 100   |
| nën 10%                                                       | 18        | 51.43 |
| mbi 10% nën 20%                                               | 1         | 2.86  |
| mbi 20% nën 33 %                                              | 1         | 2.86  |
| mbi 33% nën 50%                                               | 3         | 8.57  |
| mbi 50%                                                       | 12        | 34.29 |
| <i>Klasifikimi i aksionerëve sipas vendit të origjinës:</i>   |           | 100   |
| Aksionarë të huaj                                             | 2         | 6     |
| Aksionarë vendas                                              | 33        | 94    |
| <i>Klasifikimi i aksionerëve sipas statusit</i>               |           | 100   |
| Aksionarë individë                                            | 30        | 85.71 |
| Aksionarë shoqëri                                             | 5         | 14.29 |

### Miratime të ndryshimeve statutore të shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2018, AMF ka miratuar kërkesat e shoqërive të sigurimit në lidhje me ndryshimet statutore, sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabelë 17: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutor**

(Në numër)

| Arsyeja e Ndryshimit të Statutit | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|----------------------------------|------|------|------|------|------|------|
| Statut i ri/ndryshime të tjera   | 2    | 6    | 4    | 4    | 2    | 3    |
| Rritje kapitali                  | 3    | 5    | 2    | 2    | 1    | 3    |
| Ndryshim i strukturës aksionere  | 2    | 3    | 3    | 4    | 1    | 1    |

### 3.5 Aktiviteti Licencues

Gjatë vitit 2018, aktiviteti licencues i Autoritetit në tregun e sigurimeve u fokusua në licencimin e veprimtarisë së:

- Ndërmjetësimit në sigurime (broker/agjent);
- Vlerësuesit të dëmeve në sigurime;
- Aktuarëve në sigurime.

Në procesin licencues AMF është kujdesur që kërkesat dhe procedurat e zbatuara për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë aktivitet në fushën e ndërmjetësimit të jenë të qarta, objektive dhe transparente. Rregullorja nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar si dhe Rregullorja nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, e vënë theksin tek rritja e profesionalizmit dhe integritetit të personave që do të ushtrojnë aktivitetin në ndërmjetësimin e produkteve të sigurimit.

#### Ndërmjetësit në Sigurime

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime ushtrohet nga brokera dhe shoqëri brokerimi, agjentë, shoqëri agjentësh, subjekte të tjera, banka dhe subjekte financiare jobankë, të licencuara nga Autoriteti mbi bazën e rregullave të miratuara për çdo kategori. Edhe gjatë vitit 2018, si rezultat i zhvillimeve në tregun e sigurimeve ka vijuar interesi i subjekteve për licencimin në tregun e ndërmjetësimit.

#### Brokerimi në sigurime

Në tregun e sigurimeve aktualisht operojnë 15 shoqëri brokerimi dhe 4 banka me veprimtari brokerimi. Të dhënat mbi numrin e brokerave të licencuar në sigurime gjatë 2018 jepen në tabelën e mëposhtme:

**Tabelë 18: Të dhëna mbi brokera të licencuar në sigurime**

(Në numër)

| Statusi i Brokerit | Të licencuar në vitin 2017 | Licenca të reja në vitin 2018 | Tërhequr licenca gjatë vitit 2018 | Të licencuar në fund të vitit 2018 |
|--------------------|----------------------------|-------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| Shoqëri brokerimi  | 16                         | 3                             | -                                 | 19                                 |
| -nga këto banka:   | 3                          | 1                             | -                                 | 4                                  |
| Broker fizikë      | 36                         | 17                            | 1                                 | 52                                 |

Nga 15 shoqëritë e brokerimit, 9 prej tyre dhe një bankë, ushtrojnë veprimtari vetëm në fushën e sigurimit të Jo-Jetës, ndërsa 4 shoqëri ushtrojnë veprimtari brokerimi në sigurime

të Jetës, të Jo-Jetës dhe risigurime, 3 shoqëritë e tjera, si edhe 3 bankat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të dy fushat e sigurimit, të Jetës dhe Jo-Jetës.

**Tabelë 19: Shoqëri brokerimi sipas klasave të sigurimit**

(Në numër)

| Viti                                        | 2013     | 2014     | 2015     | 2016      | 2017      | 2018      |
|---------------------------------------------|----------|----------|----------|-----------|-----------|-----------|
| Shoqëri brokerimi Jo-Jetë                   | 5        | 4        | 5        | 6         | 8         | 9         |
| Shoqëri brokerimi Jo-Jetë dhe Jetë          | 2        | 2        | 2        | 5         | 5         | 6         |
| Shoqëri brokerimi Jo-Jetë, Jetë, Risigurime | 1        | 2        | 2        | 3         | 3         | 4         |
| <b>Totali</b>                               | <b>8</b> | <b>8</b> | <b>9</b> | <b>14</b> | <b>16</b> | <b>19</b> |

### Veprimtaria e agjentit në sigurime

Gjatë vitit 2018 vijoi puna për miratimin e personave fizikë për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime të Jo-Jetës, në bazë të kërkesave të ardhura nga shoqëritë e sigurimeve të Jo-Jetës. Gjatë vitit 2018 u licencuan 274 persona fizikë (agjentë) në sigurime, nga të cilët 242 për herë të parë. Në këtë proces u përfshinë edhe 16 subjekte financiare jobankë dhe subjekte të tjera me aktivitet financiar dhe tregtar.

**Tabelë 20: Të dhëna mbi agjentë të licencuar në sigurime**

(Në numër)

| Statusi i agjentit     | Të licencuar në fund të vitit 2017 | Rinovim licence në 2018 | Licenca të reja në 2018 | Përfunduar afati i licencës në 2018 | Tërheqje licence, ndërprerje kontrate në 2018 | Të licencuar në fund të vitit 2018 |
|------------------------|------------------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------------------|-----------------------------------------------|------------------------------------|
| Persona juridikë       | 14                                 | 16                      | -                       | -                                   | -                                             | 30                                 |
| Nga ky numër, në banka | -                                  | 3                       | -                       | -                                   | -                                             | 3                                  |
| Person fizikë          | 420                                | 242                     | 32                      | 18                                  | 39                                            | 637                                |

### Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, bazuar në kuadrin rregullator, në dispozitat e Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, licencën vlerësuesit e dëmeve në sigurime. Gjatë vitit 2018, AMF miratoi 7 licenca të reja për vlerësues të dëmeve në sigurime dhe rinovoi 1 licencë ekzistuese. Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, sipas statusit të vlerësuesit (i punësuar/i pavarur) dhe llojit të licencës (për dëme materiale dhe/ose shëndetsore) jepen në tabelën e mëposhtme.

**Tabelë 21: Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve të licencuar në sigurime**

(Në numër)



| Vlerësues sipas statusit/llojit të licencës | Të licencuar në fund të vitit 2017 | Rinovim licence në 2018 | Licenca të reja në 2018 | Përfunduar afati i licencës në 2018 | Tërheqje licence, në 2018 | Të licencuar në fund të vitit 2018 |
|---------------------------------------------|------------------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------------------|---------------------------|------------------------------------|
| <b>Sipas statusit të personit</b>           |                                    |                         |                         |                                     |                           |                                    |
| Të pavarur                                  | 36                                 | 1                       | 3                       | 4                                   | -                         | 36                                 |
| Të punësuar                                 | 36                                 | -                       | 4                       | 2                                   | -                         | 38                                 |
| Licencë joaktive                            | 5                                  | -                       | -                       | 1                                   | -                         | 4                                  |
| <b>Sipas llojit të Licencës</b>             |                                    |                         |                         |                                     |                           |                                    |
| Dëme materiale                              | 3                                  | -                       | 1                       | 1                                   | -                         | 3                                  |
| Dëme shëndetsore                            | 16                                 | 1                       | 2                       | 2                                   | -                         | 17                                 |
| Dëme materiale+shëndetsore                  | 58                                 | -                       | 4                       | 4                                   | -                         | 58                                 |
| <b>TOTALI</b>                               | <b>77</b>                          | <b>1</b>                | <b>7</b>                | <b>7</b>                            | <b>-</b>                  | <b>78</b>                          |

## Aktuarë në sigurime

Gjatë vitit 2018, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të kërkesave të nenit 222, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe Rregullores nr. 57, datë 28.04.2016 “Mbi trajnimet e vazhdueshme profesionale dhe rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar”, miratoi autorizimin e 3 personave për të ushtruar veprimtarinë e aktuarit të autorizuar në sigurime, për një periudhë 3 vjeçare, nga të cilët, një për herë të parë dhe dy të tjerët për rinovimin e licencës së aktuarit.

### Testimet profesionale në fushën e sigurimeve

Në zbatim të kërkesave rregullative, licencimi i profesionit të brokerit në sigurime, apo i vlerësuesit të dëmeve në sigurime është i lidhur me kalimin me sukses të testit për njohuritë profesionale në fushën përkatëse. Gjatë vitit 2018, Autoriteti ka organizuar 2 testime për aplikantët që kërkuan të pajisen me licencën e brokerit në sigurime dhe 2 testime për vlerësuesit e dëmeve. Qëllimi i organizimit të testimeve ka qenë çertifikimi i njohurive profesionale, me synim kryerjen e shërbimeve financiare nga profesionistë që njohin legjislacionin dhe fushën e aktivitetit ku do të operojnë.

## 3.6 Ndërmjetësit në Sigurime

Bazuar në legjislacionin e sigurimeve në fuqi, ndërmjetës në sigurime janë të gjithë personat fizikë apo juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësit, që përfshin veprimtarinë e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së veprimeve të tjera përgatitore deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënia e asistencës gjatë periudhës së

vlefshmërisë së kontratës, përkundrejt pagesave dhe komisioneve të përcaktuara sipas dispozitave ligjore.

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ushtrohet nga:

- **Agjentë persona fizikë**, shoqëri agentësh, bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, si dhe subjekte të tjera, kur shitja e produkteve të sigurimit nga këto subjekte, përputhet apo plotëson veprimtarinë parësore tregtare të tyre;
- **Brokera persona fizikë**, shoqëri brokerimi, banka dhe/ose dega e bankës së huaj në Shqipëri, institucione financiare jobankare.

### **Mbikëqyrja e agentëve**

Gjatë vitit 2018, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, me qëllim të mbikëqyrjes së veprimtarisë së agentëve/punonjësve të shoqërisë të miratuar, ka ushtruar disa inspektime në pikat e shitjeve të shoqërive të sigurimit, që ushtrojnë veprimtarinë e shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm TPL, për të verifikuar zbatimin nga ana e tyre gjatë aktivitetit të shitjes së policave të sigurimit, të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”.

Nga verifikimi në vend, pranë pikave të shitjes, të mënyrës së ushtrimit të aktivitetit të shitjes së policave nga personat që kryenin atë aktivitet, janë konstatuar edhe raste të shkeljeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për të gjitha shkeljet e konstatuara janë hartuar relacione për Bordin e Autoritetit, i cili ka marrë masa disiplinore duke aplikuar në dy raste heqjen e licencës së agentit, ndërsa në gjashtë raste pezullimin e licencës për një periudhë 6-mujore. Përveç kësaj, disa nga shkeljet e konstatuara i janë bërë të ditura me shkresë edhe Autoritetit të Konkurrencës.

Gjatë vitit 2018 në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Policinë e Shtetit është ushtruar dhe një inspektim i përbashkët në pikën e kalimit kufitar të Portit të Durrësit, lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, nga mjetet me regjistrim të huaj që hynë në territorin e vendit tonë.

Nga ky inspektim i përbashkët u konstatua se, ekzistonte një numër mjetesh të cilët ishin të pasiguruara, me policë siguri fallce dhe Karton Jeshil të pavlefshëm. Ky numër shkonte në rreth 8% të numrit total të mjeteve të kontrolluara, çka do të thotë një rrezik potencial për rritjen e Fondit të Kompensimit, në rast të dëmeve të shkaktuara nga këto mjete.

Lidhur me këtë problematikë të dalë nga ky inspektim, ju dërgua një shkresë drejtuesve më të lartë të Policisë së Shtetit, ku ju kërkua ndërhyrja e tyre, për marrjen e masave të duhura për ndryshimin e situatës, bazuar në detyrimin ligjor, të përcaktuar sipas nenit 34, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ku përcaktohet se: monitorimi i përmbushjes së detyrimit të pajisjes së drejtuesve të mjeteve motorike me regjistrim të huaj, kryhet nga personat e autorizuar për kontrollin e kufirit të Republikës së Shqipërisë.

### **Mbikëqyrja e shoqërive të brokerimit**

Gjatë vitit 2018, për herë të parë, u ushtrua inspektim pranë të gjitha shoqërive të brokerimit, të cilat ishin të licencuara duke filluar nga viti 2008.

Inspektimi u fokusua në dy drejtime kryesore:

- Përmbushja në mënyrë të vazhdueshme të kushteve të licencimit;
- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve.

Gjatë këtij viti është ushtruar inspektim edhe në 3 bankat e nivelit të dytë, që ushtrojnë edhe veprimtarinë si broker në sigurimin e Jetës ku janë shqyrtuar çështje si mbrojtja e konsumatorëve, sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Ligjit nr.52/2014 si edhe verifikimi i zbatimit të rregullave të brendshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime.

Nga inspektimet e kryera në të gjitha shoqëritë e brokerimit dhe bankat e nivelit të dytë rezultuan disa problematika, për të cilat u lanë rekomandimet përkatëse, me qëllim marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e situatës, si dhe u përgatit një relacion për Bordin e Autoritetit.

### **3.7 Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS)**

**Drejtoria e Zbatueshmerisë në lidhje me BSHS ka marrë vendimet si më poshtë:**

- Shtesë në Rregulloren nr. 36 datë 21.03.2012 “Për krijimin llogaritjen financimin administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, ndryshime të cilat lidhen me problematikën e akumulimit në BSHS të detyrimeve të fondit të kompensimit;
- Është marrë gjohë ndaj drejtorit ekzekutiv të BSHS-së si dhe është refuzuar kandidatura e riemërimit të drejtorit ekzekutiv të BSHS-së.

Gjatë vitit 2018, janë marrë disa vendime që lidhen me Fondin e Kompensimit si më poshtë:

## **Pagesat e dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit**

U hartua një plan i posaçëm për zgjidhjen e problematikave të BShS dhe Fondit të Kompensimit. Në muajin maj 2018 është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Gjatë vitit 2018 u monitoruan zbatimet e vendimeve të Bordit lidhur me shlyerjen e detyrimeve që u përkasnin shoqërive, publikimi i personave përfitues për praktikën e miratuara të papaguara administrative, kontrolli i pagesave të kryera sipas konkluzioneve të inspektimit dhe shtesës së Fondit të Kompensimit. Janë propozuar në Bord dhe janë marrë masa ndaj shoqërive për rastet e konstatuara për moszbatim të vendimeve të AMF-së.

Në zbatim të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, e ndryshuar, për nxjerrjen e saktë të raporteve të dëmeve objekt i fondit të kompensimit, në muajin janar të 2019 pranë BSHS-së funksionon Sistemi Elektronik i Administrimit të Dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, ku AMF ka të drejtë shikueshmërie për çdo rast evidentimin e statusit të dosjes, në mbrojtje të interesave dhe të drejtave të konsumatorëve.

Lidhur me monitorimin e praktikave të përfunduara, AMF me vendimin nr. 156 datë 30.07.2018, ka bërë ndryshime të rregullores nr. 36, datë 21.03.2012 “Për Krijimin, Llogaritjen, Financimin, Administrimin e Fondit të Kompensimit dhe Kryerjen e Pagesave të Dëmeve”, ku në nenin 6 pika 1.1 përcaktohet se nëse Byroja nuk bën shpërndarjen e praktikave të dëmeve të Fondit të Kompensimit tek shoqëritë e sigurimit, anëtarë të saj sipas vlerave respektive të detyrimit të tyre, shpërndarja për pagesë tek shoqëritë e sigurimit do të bëhet nga Autoriteti. Byroja brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni nga Autoriteti të shpërndarjes së praktikës do të vijojë me dërgimin e autorizimit dhe kopjen e praktikës tek shoqëria e sigurimit e caktuar nga Autoriteti.

Masa të tjera të marra nga AMF janë:

- Ndjekja e proceseve gjyqësore për të cilat informohet nga Byroja, duke marrë pjesë si palë dëgjuese në mënyrë që të verifikohet ndjekje e rregullt e proceseve;
- Miratimi i drejtorit të ri të BSHS-së;
- Miratimi i disa rregulloreve nga ana e BSHS-së që lidhen me përmirësimin e procedurave të ndjekjes së praktikave, objekt i Fondit të Kompensimit.

### 3.8 Fondi i Kompensimit

Gjatë vitit 2018, janë marrë disa vendime që lidhen me Fondin e Kompensimit si më poshtë:

#### **Për miratimin e kontributeve të Fondit të Kompensimit**

**Korrik 2018**, Bordi ka marrë Vendimin nr. 155, datë 30.07.2018, “Për miratimin e kontributeve shtesë të Fondit të Kompensimit të vitit 2018”, sipas së cilës është miratuar shtesa e Fondit të Kompensimit për vitin 2018, për pagesat e dëmeve për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim, në vlerën rreth 182 milion lekë. Ky vendim është marrë referuar rezultateve të inspektimit të kryer në vend, gjatë periudhës 21-30 maj 2018, pranë shoqërive të sigurimit si dhe verifikimeve më datë 8 qershor pranë BSHS-së lidhur me praktikatat që dispononte BSHS të kthyera nga shoqëritë e sigurimit.

**Tetor 2018**, Bordi me Vendimin nr. 219, datë 31.10.2018 ka miratuar shtesë të Fondit të Kompensimit për vitin 2018, në vlerën prej rreth 275 milion lekë, për ngjarjet deri 31.12.2013, me qëllim vijimin e pagesave të këtyre ngjarjeve.

Ky vendim është marrë referuar propozimeve të ardhura nga BSHS me shkresën nr. 5997 prot, datë 17.10.2018, ku është depozituar për miratim Vendimi nr. 21, datë 11.10.2018, “Për miratimin e shtesës për Fondin e Kompensimit për vitin 2018”, është hartuar relacioni dhe propozimi përkatës.

**Dhjetor 2018**, Bordi me Vendimin nr. 260, datë 28.12.2018, ka miratuar Fondin e Kompensimit të vitit 2019. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 45, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2012, Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3, shkronja b e këtij neni dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Vlera e Fondit të Kompensimit për vitin 2019, i është referuar të dhënave të paraqitura nga BSHS në mbledhjen e datës 18 dhjetor 2018, për ngjarjet deri 31.12.2013 si dhe inspektimit të kryer pranë shoqërive të sigurimit, sipas programit të inspektimit 4083, datë 11.12.2018, për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim.

#### **Fondi i Kompensimit dhe pagesat e dëmeve**

Janë kryer 3 inspektime në vend në të gjithë shoqëritë e sigurimit dhe tek BSHS për praktikatat e Fondit të Kompensimit. Konkluzionet e dala nga inspektimi i kanë shërbyer përcaktimit të saktë të detyrimit të fondit të kompensimit si dhe pagesës së dëmeve, me qëllim mosakumulimin e tyre.

Strukturat e AMF-së kanë bërë monitorimin e ndarjes së praktikave të përfunduara të Fondit të Kompensimit, duke kërkuar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rregullores

përkatëse. Për Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave duke filluar nga data 26.09.2018, janë përgatitur informacione 2 javore lidhur me pagesat Fondit të Kompensimit. Për vitin 2018 pagesat janë në vlerën mbi 1,009 milionë lekë, të cilat janë verifikuar me konfermat bankare gjatë inspektimit të kryer në janar 2019.

Gjithashtu në këtë inspektim janë verifikuar dhe marrëveshjet e lidhur nga shoqëritë e sigurimit të cilat rezultojnë në vlerën prej rreth 205 milionë lekë.

Janë kryer inspektime tematike në vend në të gjithë shoqëritë e sigurimit dhe tek BSHS, për praktikën që i përkasin dëmeve me objekt Fond Kompensimi, lidhur me autorizimet e lëshuara nga BSHS dhe konfirmimet e pagesave nga shoqëritë për detyrimet sipas vendimeve të Bordit të AMF.

Në muajin dhjetor 2018 Autoriteti ka miratuar vlerën e Fondit të Kompensimit për vitin 2019, vendim, i cili tashmë ka futur në normalitet Fondin e Kompensimit duke zgjidhur problematikën e trashëguar nga viti 2002.

Autoriteti po monitoron ndarjen e praktikave që përfundojnë të Fondit të Kompensimit, vendimet e formës së prerë të gjykatave në zbatim të afateve të përcaktuar në Rregulloren e administrimit të këtij fondi, pagesat sipas marrëveshjeve të deklaruara nga shoqëritë si dhe zbatimin e vendimeve të Autoritetit.

### **Inspektime lidhur me Fondin e Kompensimit**

Gjatë vitit 2018 janë kryer 36 inspektime tematike, përkatësisht 4 inspektime pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit nga 2 të kryera në vitin 2017, si dhe 4 inspektime në secilën nga 8 shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë me fokus dëmet objekt i Fondit të Kompensimit, nga 1 inspektim i kryer në secilën prej tyre në vitin 2017. Këto inspektime kanë konsistuar në çështjet më thelbësore që kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave të dëmeve sipas kërkesave rregullatore, kontrollin e dokumentacionit fizik për dëmet me vlera të larta në BSHS, përputhshmërinë e tyre me të dhënat e raportuara, vlerësimin e sigurisë dhe vlefshmërisë së programeve informatike të përdorura nga BSHS për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave, ndjekjen e padive të regresit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparshme të Autoritetit. Edhe njësisia e Auditit të brendshëm në AMF ka audituar procedurat e ndjekura që lidhen me pagesat e Fondit të Kompensimit.

### **3.9 Zbatueshmëria dhe Kuadri Ligjor e Rregullativ**

#### **Akte të reja**

Rregullorja nr. 56, datë 29.03.2018 “Mbi formën dhe përmbajtjen e detajuar të informimit të kreditorëve të njohur të shoqërisë së sigurimit”, e cila vendosi rregulla për formën dhe përmbajtjen e detajuar të informimit të kreditorëve të njohur të shoqërisë së sigurimit në rastet e likuidimit të detyrueshëm. Udhëzimi nr.250, datë 28.12.2018 “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”. Objekti i këtij udhëzimi metodologjik është caktimi i rregullave të përgjithshme dhe i një sistemi bashkëpunimi midis institucioneve mbikëqyrëse, si Kolegji Mbikëqyrës i Grupit të Sigurimit, me qëllim shkëmbimin e informacionit në funksion të mbikëqyrjes efektive në nivel grupi për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të huaja.

Manuali praktik për mbikëqyrjen e veprimtarisë së risigurimit, u miratua me vendimin e Bordit nr. 140, datë 30.07.2018.

Rregullorja nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”, e cila përcakton procedurat e funksionimit, identifikimit dhe raportimit të të dhënave të shitjes të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik në Regjistrin Elektronik Online të shitjeve, të instaluar në Qendrën e Informacionit pranë AMF-së.

Vendimi nr. 55, datë 29.03.2018 për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përlllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

Manuali praktik mbi inspektimin në vend për dëmet motorike dhe të pronës, i cili erdhi si nevojë e pasjes së një udhëzimi/orientimi të qartë për inspektimet tematike në terren, përsa i përket inspektimit të dëmeve. Ky manual ishte pjesë e projektit FIRST, ku me asistencën e ekspertëve të Bankës Botërore është punuar në drejtim të zhvillimit të mbikëqyrjes sa më efektive të tregut të sigurimeve. Ky manual u miratua me vendimin e Bordit nr. 97, datë 13.06.2018.

#### **Amendime të akteve ekzistuese**

Amendimet në Rregulloren nr. 37, datë 28.05.2015 "Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit", të aprovuara me vendimin e Bordit nr. 141, datë 30.07.2018 kishin të bënin me azhornimin e emërtimeve me ligjin për auditimin ligjor si edhe me unifikimin e rregulloreve të AMF-së për auditimin e jashtëm, në drejtim të afateve të depozitimit të kërkesës, dokumentacionit që dorëzohet në AMF, miratimit/refuzimit nga AMF etj., si për auditimin e shoqërive të sigurimeve ashtu edhe të shoqërive administruese të SIK dhe FP.

Miratimi i disa ndryshimeve dhe shtesave në Rregulloren nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, me vendimin e Bordit nr. 215, datë 31.10.2018, i shërben forcimit të kriterëve të ushtrimit të veprimtarisë së agjentit si edhe mbikëqyrjes së tyre. Ndryshimet erdhën si rrjedhojë edhe e zbatimit të rekomandimeve, raporteve MONEYVAL të Këshillit të Evropës.

Shtesa në Rregulloren nr. 2, datë 25.01.2016 “Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime”, u miratua me Vendimin nr. 73, datë 04.04.2018 dhe përcaktoi rregullin për depozitimin në Autoritet të projektpasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës nga ana e shoqërisë së agjentëve dhe shoqërisë së brokerimit.

Ndryshimet në Rregulloren nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”, u aprovuan me vendimin e Bordit nr. 188, datë 18.09.2018.

Ndryshimi në Rregulloren nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, u miratua me Vendimin e Bordit nr. 168, datë 31.08.2018, dhe konsistoi në përcaktimin e njësisë përgjegjëse për shqyrtimin e raportimeve periodike të Byrosë, ndjekjen e zbatimit të afateve të raportimit të Byrosë. Ndërsa me Vendimin e Bordit nr. 240, datë 12.12.2018, u shtua në këtë Rregullore "Statistika mujore dhe progresive për dëmet Fond Kompensimi".

Shtesat dhe ndryshimi në Rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", u miratuan me Vendimin e Bordit nr. 72, datë 04.04.2018, dhe kanë të bëjnë me llogaritjen e dëmit moral dhe ekzistencial si edhe me koeficientët e llogaritjes së shumës së kapitalizuar.

Shtesa në Rregulloren nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, u miratua me Vendimin e Bordit nr. 156, datë 30.07.2018. Domosdoshmëria për ndërhyrje në këtë rregullore, lindi si rezultat i mosrespektimit nga ana e BSHS-së e vendimeve që lidhen me Fondin e Kompensimit.

Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Institutit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve Itali (IVASS) dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare u aprovua me Vendimin nr. 1, datë 09.01.2018 dhe u autorizua Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv për nënshkrimin e kësaj marrëveshje.



## **Marrëveshje AMF-Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)**

Me Vendimin nr. 187, datë 18.09.2018, Bordi miratoi marrëveshjen AMF-QKB “Për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni”. Qëllimi i marrëveshjes është përcaktimi i rregullave dhe procedurave të ushtrimit të së drejtës së aksesit në të dhënat e aksesueshme në Regjistrin Tregtar që mbahet dhe administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për nevoja të ushtrimit të funksioneve ligjore nga ana e Autoritetit. Bashkëpunimi midis QKB-së dhe AMF-së, u realizua me qëllim shkëmbimin e informacioneve për çdo veprim regjistrimi në regjistrin tregtar të subjekteve nën juridiksionin e AMF-së, për të cilat ligji kërkon miratim/konfirmim paraprak nga ana e AMF-së, për ushtrimin e veprimtarisë, për sigurinë, garantimin në marrjen e informacionit, si dhe ruajtjen e integritetit të databazave nga palët.

### **3.10 Masat Korrigjuese dhe Administrative**

Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së si dhe ligji “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” parashikojnë masa korrigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave e veprimeve që përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore ose akteve të Autoritetit.

Masat mbikëqyrëse, korrigjuese e sanksionuese janë vendosur nga Autoriteti në mënyrë të paanshme, transparente duke respektuar parime të efektshmërisë, vazhdimësisë, dhe proporcionalitetit me rrethanën apo veprimin që përbën shkelje dhe ndikim mbi interesat e të siguruarve.

Masat e marra nga Autoriteti janë bazuar në inspektimet në vend, kontrollin mbi dokumente, verifikim të informacionit.

Bordi i AMF-së, gjatë periudhës janar-dhjetor 2018, ka marrë gjithsej 34 vendime për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura. Si rezultat i gjetjeve nga inspektimet dhe performancës jo të mirë financiare, masat juridike të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi janë: shtimi i mjeteve për plotësim të kërkesave rregullative për kapitalin minimal të kërkuar, mbulimi me aktive i provigjoneve teknike, kufizim përdorimi të aktiveve të shoqërisë, revokim licence, pezullim ushtrim veprimtarie, gjoba monetare dhe çështje të tjera. Vendimet e detajuara sipas llojit të masave administrative paraqiten si më poshtë:

**Tabelë 22: Proceset gjyqësore të ndjekura nga AMF për vitin 2018***(Në numër)*

| <b>Masa administrative gjatë vitit 2018</b> |                      |                   |                                                 |                                                                |                      |                                  |                             |                                        |
|---------------------------------------------|----------------------|-------------------|-------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|----------------------|----------------------------------|-----------------------------|----------------------------------------|
| <i>Përshkrimi i masës.</i>                  | Treguesit Financiarë | Raporti mi në AMF | Monitorimi i moszbatimit të vendimeve të bordit | Inspektim sipas metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun | BSHS/Fond kompensimi | Vlerësimi dhe dëmeve në sigurime | Agjent/punonjës në sigurime | Broker/S hoqëri brokerim i në sigurime |
| <b>Vendime Bordi</b>                        | <b>3</b>             | <b>13</b>         | <b>4</b>                                        | <b>3</b>                                                       | <b>4</b>             | <b>1</b>                         | <b>2</b>                    | <b>4</b>                               |
| <i>Urdhër eliminim shkelje</i>              | 3                    |                   | 4                                               | 3                                                              |                      |                                  |                             | 3                                      |
| <i>Masa korrigjuese</i>                     |                      | 1                 |                                                 |                                                                |                      |                                  |                             |                                        |
| <i>Gjobë</i>                                |                      | 13                | 1                                               |                                                                | 3                    |                                  |                             |                                        |
| <i>Refuzim Emërimi</i>                      |                      |                   |                                                 |                                                                | 1                    |                                  |                             |                                        |
| <i>Tërheqje licence</i>                     |                      |                   |                                                 |                                                                |                      |                                  | 1                           |                                        |
| <i>Pezullim licence</i>                     |                      |                   |                                                 |                                                                |                      | 1                                | 1                           | 1                                      |

Gjatë vitit 2018, janë ankimuar në gjykatë 9 vendime Bordi dhe vijon gjykimi për 13 vendime të Bordit të AMF-së. AMF ka ndjekur me rigozitet proceset e ankimit dhe mbrojtjes gjyqësore në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor. Gjatë vitit 2018, Autoriteti ka ndjekur 22 procese gjyqësore.

**Tabelë 23: Proceset gjyqësore të ndjekura nga AMF për vitin 2018***(Në numër)*

| Totali    | Të mbartura | Të reja (gjatë 2018) |
|-----------|-------------|----------------------|
| <b>22</b> | <b>13</b>   | <b>9</b>             |

Gjatë vitit 2018, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë janë gjykuar 9 çështje, ndaj të cilave është bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Nga këto 9 çështje 3 janë fituar në shkallë të parë nga paditësit, dhe 6 çështje janë fituar nga AMF, AMF ka bërë ankim në apel në lidhje me dy vendime, ndërsa një vendim nuk mund të ankimohej pasi përjashtohet nga procedura e ankimit referuar Nenit 45 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin e funksionimit të gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Nga totali i 13 çështjeve të mbartura, 6 çështje janë për shqyrtim në gjykatën Administrative të Apelit dhe 7 çështje priten të gjykohen në Gjykatën e Lartë. Numri total i çështjeve që priten të shqyrtohen në Gjykatën Administrative të Apelit janë

12, nga të cilat 6 janë të mbartura. Numri total i çështjeve që priten të gjykohen në Gjykatën e Lartë janë 7.

Autoriteti nuk ka patur asnjë kallzim penal gjatë vitit 2018.

## **4 Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare**

### **4.1 Struktura e Tregut**

Skema e organizimit dhe funksionimit të pensioneve private vullnetare, e sanksionuar me Ligjin nr. 10197 datë 10.12.2009 ka krijuar hapësirat e nevojshme për të stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të përfituar një pension shtesë.

Edhe gjatë vitit 2018, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre 3 fonde pensioni vullnetar, të administruar nga tre shoqëri administruese, përkatësisht “Raiffeisen Invest” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Raiffeisen”, “Sigal-Life Uniqa Group Austria” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Sigal”, si dhe “Credins Invest” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Credins Pension”.

Zhvillimet në këtë treg, që nga hyrja në fuqi e ligjit kanë patur një dinamikë pozitive. Gjithsesi, vlera neto e aseteve të këtij tregu është në masë të papërfillshme kundrejt PPB në Shqipëri.

### **4.2 Pozicioni Financiar**

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar që prej fillimit të aktivitetit të tij, ka patur tendencë në rritje, përsa i përket aseteve që menaxhon, si dhe numrit të kontribuesve. Totali i aseteve neto të këtij tregu më 31.12.2018 është mbi 2,289 milionë lekë me një numër prej 25,298 anëtarësh. Asetet neto të këtij tregu më 31.12.2018 kanë pësuar një rritje me 32.51%, ndërsa numri i anëtarëve është rritur me 20.77% krahasuar me fundin e vitit 2017. Ndërkohë, nëse do krahasojmë këto dy tregues me fundin e vitit 2016 rezulton se, asetet neto janë rritur me 73.58%, kurse numri i anëtarëve është rritur me 46.09%. Ecuria e vlerës neto të aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar për tre vitet e fundit jepet në tabelën e mëposhtme:


**Tabelë 24: Asetet neto të фондеве të pensionit vullnetar**

| <i>Përshkrimi</i>           | <i>Vlera (mln. lekë)</i> |             |             | <i>Ndryshimi (në %)</i>         |                                 |                                 |
|-----------------------------|--------------------------|-------------|-------------|---------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| <i>Periudha</i>             | <i>2016</i>              | <i>2017</i> | <i>2018</i> | <i>31.12.'16-<br/>31.12.'17</i> | <i>31.12.'17-<br/>31.12.'18</i> | <i>31.12.'16-<br/>31.12.'18</i> |
| Asetet neto të tregut të FP | 1,318.74                 | 1,727.54    | 2,289.10    | 31                              | 32.51                           | 73.58                           |

Siç shihet nga tabela e mësipërme, ritmi i rritjes së aseteve neto të tregut të фондеве të pensionit vullnetar për periudhën 31.12.2017-31.12.2018 është më i lartë se ai për periudhën 31.12.2016-31.12.2017.


Në 31.12.2018 fondi i pensionit vullnetar “Sigal” zë peshën më të madhe të këtij tregu përse i përket vlerës së aseteve neto 47.43%, kurse fondi i pensionit vullnetar “Raiffeisen” dhe fondi i pensionit vullnetar “Credins Pension” zënë respektivisht 27.21% dhe 25.36% të tregut, siç shihet edhe në grafikun e mëposhtëm.

**Grafik 28: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të фондеве të pensionit më 31.12.2018**  
(Në %)



Në grafikun e mëposhtëm është pasqyruar ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të фондеве të pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit.

**Grafik 29: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensionit vullnetar**  
(Në %)



Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet vlera e kuotës për secilin fond pensioni vullnetar gjatë tre viteve të fundit.

**Tabelë 25: Vlera e kuotës së fondeve të pensionit vullnetar**

(Në lekë)

| <i>Fondi i pensionit</i> | <i>Vlera e aseteve neto për kuotë 2016</i> | <i>Vlera e aseteve neto për kuotë 2017</i> | <i>Vlera e aseteve neto për kuotë 2018</i> |
|--------------------------|--------------------------------------------|--------------------------------------------|--------------------------------------------|
| Sigal                    | 1,297                                      | 1,350                                      | 1,394                                      |
| Raiffeisen               | 1,544                                      | 1,635                                      | 1,724                                      |
| Credins Pension          | 1,305                                      | 1,354                                      | 1,406                                      |

Nga tabela e mësipërme mund të shihet se vlera e aseteve neto për kuotë për secilin nga fondet e pensionit ka pasur një tendencë në rritje. Në fund të vitit 2018 vlera e aseteve neto për kuotë e fondit të pensionit “Sigal” është rritur me 3.26% krahasuar me fundin e vitit 2017, kurse për fondin e pensionit vullnetar “Raiffeisen” dhe “Credins Pension” ky tregues është rritur respektivisht me 5.44% dhe 3.84%. Në krahasim me fundin e vitit 2016 ky tregues për fondet e pensionit të sipër përmendura është rritur me 7.48% për “Sigal”, 11.66% për “Raiffeisen” dhe 7.74% për “Credins Pension”.

Asetet e këtij tregu në 31.12.2018 janë në vlerën 2,303.26 milionë lekë dhe janë investuar në obligacione të Qeverisë Shqiptare. Këto asete janë rritur me 32.91% krahasuar me 31.12.2017, kurse në krahasim me 31.12.2016 ato kanë shënuar një rritje me 73.78%.

Investimet në obligacione të R.Sh.-së përbëjnë 95.96% të totalit të aseteve të tregut të fondeve të pensionit dhe janë rritur me 34.62% krahasuar me fundvitin 2017, kurse në krahasim me fundin e vitit 2016 kanë shënuar një rritje me 76.07%. Pjesa tjetër e aseteve e këtij tregu konsiston në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe në llogari të arkëtueshme.

Struktura e aseteve të këtij tregu gjatë tre viteve të fundit dhe ndryshimi i kësaj strukture jepet në tabelat e mëposhtme.

**Tabelë 26: Struktura e aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit**

| <i>Përshkrimi</i>                                  | <i>Vlera (mln. lekë)</i> |                  |                  |
|----------------------------------------------------|--------------------------|------------------|------------------|
| <b>Periudha</b>                                    | <b>31.12.'16</b>         | <b>31.12.'17</b> | <b>31.12.'18</b> |
| <b>Asetet neto të fondeve të pensionit</b>         | <b>1318.74</b>           | <b>1,727.54</b>  | <b>2,289.10</b>  |
| <b>Totali i aseteve të fondeve</b>                 | <b>1325.36</b>           | <b>1,732.94</b>  | <b>2,303.26</b>  |
| <i>nga të cilët:</i>                               |                          |                  |                  |
| Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare | 46.31                    | 58.44            | 47.73            |
| Obligacione Thesari të RSH                         | 1,255.29                 | 1,641.76         | 2,210.16         |
| Depozita bankare                                   | 0.00                     | 0.00             | 0.00             |
| Asete të tjera                                     | 23.76                    | 32.74            | 45.37            |
| <b>Totali i Detyrimeve të Fondeve</b>              | <b>6.62</b>              | <b>5.4</b>       | <b>14.16</b>     |

**Tabelë 27: Ndryshimi i strukturës së aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar më 31.12.2018 krahasuar me 31.12.2017**

| <i>Përshkrimi</i>                                  | <i>Vlera (Në mln. lekë)</i> |                   | <i>Ndryshimi (Në %)</i>    | <i>Pjesa ndaj totalit (Në %)</i> |                  |
|----------------------------------------------------|-----------------------------|-------------------|----------------------------|----------------------------------|------------------|
| <b>Periudha</b>                                    | <b>31.12.2017</b>           | <b>31.12.2018</b> | <b>31.12.'17-31.12.'18</b> | <b>31.12.'17</b>                 | <b>31.12.'18</b> |
| <b>Asetet neto të fondeve të pensionit</b>         | <b>1,727.54</b>             | <b>2,289.10</b>   | <b>32.51</b>               |                                  |                  |
| <b>Totali i aseteve të fondeve</b>                 | <b>1,732.94</b>             | <b>2,303.26</b>   | <b>32.91</b>               | <b>100</b>                       | <b>100</b>       |
| <i>nga të cilët:</i>                               |                             |                   |                            |                                  |                  |
| Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare | 58.44                       | 47.73             | -18.33                     | 3.37                             | 2.07             |
| Obligacione Thesari të RSH                         | 1,641.76                    | 2,210.16          | 34.62                      | 94.74                            | 95.96            |
| Depozita bankare                                   | 0.00                        | 0.00              | -                          | 0.00                             | 0.00             |
| Asete të tjera                                     | 32.74                       | 45.37             | 38.58                      | 1.89                             | 1.97             |
| <b>Totali i Detyrimeve të Fondeve</b>              | <b>5.4</b>                  | <b>14.16</b>      | <b>162.22</b>              | <b>0.31</b>                      | <b>0.61</b>      |

Gjatë vitit 2018, totali i investimeve të fondeve të pensionit ka qenë mbi 2,210 milionë lekë dhe këto investime konsistojnë në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë (95.96% ndaj totalit të aseteve).


Investimet e tregut të pensioneve kanë shënuar një rritje me 34.62% krahasuar me 31.12.2017, kurse në krahasim me 31.12.2016 ato janë rritur me 76.07%. Ecuria e investimeve gjatë tre viteve të fundit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

**Tabelë 28: Vlera e investimeve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar (në mln. lekë)**

| <i>Përshkrimi</i>                    | <i>Vlera (mln. lekë)</i> |             |             |
|--------------------------------------|--------------------------|-------------|-------------|
| <i>Periudha</i>                      | <i>2016</i>              | <i>2017</i> | <i>2018</i> |
| Totali i investimeve të tregut të FP | 1,255.29                 | 1,641.76    | 2,210.16    |

Duke qenë se detyrimet e fondeve të pensionit vullnetar janë afatgjata, pasi anëtarët mund të tërhiqen kur arrijnë moshën e pensionit, atëherë dhe politika e investimeve për të tre fondet e pensionit, të cilët operojnë në treg është afatgjatë duke mbartur në këtë mënyrë dhe rrezikun e tregut. Kështu kjo politikë e investimeve të fondeve të pensionit ka synuar në maturime 3, 5, 7 dhe 10 vjeçare siç mund të shihet dhe në grafikun më poshtë:

**Grafik 30: Ndarja sipas maturimit të investimeve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar më 31.12.2018** (Në %)



Në grafikun më sipër vihet re se pjesën më të madhe e zënë investimet në obligacione me afat maturimi 7 vjeçar dhe 10 vjeçar përkatësisht në masat 32.86% dhe 56.70%. Ky fakt tregon se fondet e pensionit vullnetar synojnë të ndërtojnë një portofol të përbërë kryesisht nga letra me vlerë afatgjatë.


Numri i anëtarëve që kanë kontribuar në fondet e pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit si dhe ndryshimi në përqindje për këto periudha pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

**Tabelë 29: Numri i anëtarëve sipas fondeve të pensionit vullnetar**

| <i>Përshkrimi</i> | <i>Numri i anëtarëve në FP</i> |               |               | <i>Ndryshimi (në %)</i>    |                            |
|-------------------|--------------------------------|---------------|---------------|----------------------------|----------------------------|
| <i>Periudha</i>   | <i>2016</i>                    | <i>2017</i>   | <i>2018</i>   | <i>31.12.'16-31.12.'17</i> | <i>31.12.'17-31.12.'18</i> |
| Sigal             | 5,794                          | 6,066         | 7,067         | 4.69%                      | 16.50%                     |
| Raiffeisen        | 2,653                          | 2,800         | 2,911         | 5.54%                      | 3.96%                      |
| Credins Pension   | 8,870                          | 12,081        | 15,320        | 36.20%                     | 26.81%                     |
| <b>Total</b>      | <b>17,317</b>                  | <b>20,947</b> | <b>25,298</b> | <b>20.96%</b>              | <b>20.77%</b>              |

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, numri i anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar ka ardhur duke u rritur. Në grafikun më poshtë është pasqyruar ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar e shprehur në përqindje për fundvitin 2018.


**Grafik 31: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar më 31.12.2018**  
(Në %)



Në grafikun më poshtë është pasqyruar ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit.




**Grafik 32: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar**



Në fund të vitit 2018, ishin 14,643 anëtarë të tregut të fondeve të pensionit vullnetar që janë përfshirë në planet individuale të pensionit vullnetar, ndërsa 10,655 anëtarë janë përfshirë në planet profesionale të pensionit vullnetar, të krijuara nga punëdhënësit për punonjësit e tyre.

Në grafikun më poshtë është paraqitur ndarja e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit për fundvitin 2018, ku 57.88% e anëtarëve të këtij tregu bëjnë pjesë në planet individuale të pensionit, kurse 42.12% e tyre bëjnë pjesë në planet profesionale të pensionit.


**Grafik 33: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar më 31.12.2018**  
(Në %)



Në fund të vitit 2018, ishin 14,643 anëtarë të tregut të fondeve të pensionit vullnetar që janë përfshirë në planet individuale të pensionit vullnetar, ndërsa 10,655 anëtarë janë përfshirë në planet profesionale të pensionit vullnetar, të krijuara nga punëdhënësit për punonjësit e tyre.

Në grafikun më poshtë është paraqitur ndarja e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit për fundvitin 2018, ku 57.88% e anëtarëve të këtij tregu bëjnë pjesë në planet individuale të pensionit, kurse 42.12% e tyre bëjnë pjesë në planet profesionale të pensionit.

**Grafik 34: Ndarja e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit më 31.12.2018**



Pjesa më e madhe e anëtarëve të fondeve të pensionit vullnetar “Sigal” dhe atë “Raiffeisen” janë përfshirë në planet profesionale të pensionit përkatësisht 79.55% dhe 69.53%, ndërsa 80.36% e anëtarëve të fondit të pensionit vullnetar “Credins Pension” janë përfshirë në planet individuale të pensionit.

Tabela më poshtë tregon ndarjen e anëtarëve në secilin prej fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve individuale dhe profesionale të pensionit për fundvitin 2018.


**Tabelë 30: Ndarja e anëtarëve të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit më 31.12.2018**

| <i>Fond Pensioni</i> | <i>Numri i anëtarëve në planet individuale të pensionit</i> | <i>Numri i anëtarëve në planet profesionale të pensionit</i> |
|----------------------|-------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|
| Sigal                | 1,445                                                       | 5,622                                                        |
| Raiffeisen           | 887                                                         | 2,024                                                        |
| Credins Pension      | 12,311                                                      | 3,009                                                        |
| <b>Total</b>         | <b>14,643</b>                                               | <b>10,655</b>                                                |

Kontributet e derdhura në fondet e pensionit vullnetar në 31.12.2018 kanë shënuar një rritje me 47.05% krahasuar me fundin e vitit 2017, kurse në krahasim me fundin e vitit 2016 ato janë rritur me 59.41%.

Totali i tërheqjeve nga fondet e pensionit për periudhën 31.12.2018 ka qenë 86,015,992 lekë, gjë që përfaqëson 3.76% të totalit të aseteve neto të tregut. Tërheqjet e parakohshme nga fondet e pensionit për periudhën 31.12.2018 zënë 65.76% ndaj totalit të tërheqjeve gjithsej, ndërsa tërheqjet nga mbushja e moshës për pension përbëjnë 34.24% të totalit të tërheqjeve nga fondet e pensionit. Tërheqjet nga mbushja e moshës së pensionit janë kryesisht tërheqje të menjëhershme 31.53% dhe tërheqje mujore 2.71%, siç mund të shihet nga grafiku më poshtë.

**Grafik 35: Tërheqjet nga fondet e pensionit vullnetar më 31.12.2018**



### 4.3 Mbikëqyrja dhe Analiza e Rreziqeve të Tregut

Në kuadrin e metodologjisë mbikëqyrëse me bazë rrezikun, gjatë vitit 2018 u krye inspektim në vend pranë një njësie të depozitarit të fondeve të pensionit dhe fondeve të investimit. Objekti i këtij inspektimi ishte vlerësimi i nivelit të rreziqeve të njësisë së depozitarit, mbështetur në parimet me të cilat duhet të përputhet aktiviteti i tij. Këto parime janë pjesë e zbatimit të metodologjisë së re mbikëqyrëse për fondet e pensioneve vullnetare, asaj me bazë rreziku, e cila u hartua dhe u miratua në vitin 2016. Nëpërmjet kësaj metodologjie evidentohen rreziqet më të mëdha që prekin këtë treg dhe njëkohësisht strategjitë që duhen ndjekur për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm.

Qasja e ndjekur gjatë inspektimit pranë njësisë së depozitarit ishte shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar paraprakisht nga njësia e depozitarit, zhvillimi i intervistave me punonjës që mbajnë pozicione kryesore në njësinë e depozitarit si dhe verifikimi ose testimi në vend në lidhje me çështje të ndryshme. Pas përfundimit të inspektimit, mbi bazën e gjetjeve të identifikuara, u vlerësua përputhshmëria e aktivitetit të njësisë së depozitarit me parimet me të cilat duhet të përputhet aktiviteti i tij dhe niveli i rreziqeve të njësisë së depozitarit. Nga gjetjet e këtij inspektimi AMF ka lënë rekomandimet përkatëse, për të cilat njësia e depozitarit ka punuar për t'i përmbushur.

Metodologjia me bazë rrezikun, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për gjykimin e vlerësimit të rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e *Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit*, i cili ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2016 me miratimin e Metodologjisë së re mbikëqyrëse.

Gjatë mbledhjeve të Komitetit të Rrezikut në vitin 2018 janë prezantuar matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem dhe u dakordësua vlerësimi i këtyre rreziqeve, duke identifikuar rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë në sistem. Kështu, si rreziku më i madh në kushtet e Shqipërisë u identifikua rritja e pjesëmarrjes së kontribuesve në sistem, gjë që ka lidhje edhe me rritjen e besueshmërisë në sistem. Komiteti i Rrezikut, duke pasur si objektiv zbutjen e rreziqeve, miraton planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

### 4.4 Kuadri Ligjor dhe Rregullativ

Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, edhe gjatë vitit 2018, nuk pati zhvillime të procedurave drejt miratimit të tij.

Nuk ka akte të reja, por vetëm amendim të një rregulloreje, asaj nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”. Amendimet që u miratuan me Vendimin nr. 142, datë 30.07.2018,

kishin të bënin me azhornimin e emërtimeve të rregullores me ligjin për auditimin ligjor. Gjithashtu, ndryshimet konsistuan edhe në unifikimin e rregulloreve të AMF-së për audituesit e jashtëm, në drejtim të afateve të depozitimit të kërkesës, dokumentacionit që dorëzohet në AMF, miratimit/refuzimit nga AMF etj, si për auditimin e shoqërive të sigurimeve ashtu edhe auditimin e shoqërive administruese të SIK dhe FP.

## **5 Bashkëpunimi institucional dhe projektet**

### **5.1 Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka një rol të rëndësishëm për zhvillimin dhe ruajtjen e stabilitetit të qëndrueshëm financiar të vendit. Bashkëpunimi i rregullatorëve të ndryshëm ekonomikë dhe financiarë është konsideruar mjaft i rëndësishëm për ecurinë e tregjeve financiare. Për t'i shërbyer këtij bashkëpunimi edhe gjatë vitit 2018 janë thelluar marrëdhëniet me institucionet më të rëndësishme financiare në vend apo institucione e grupe të tjera interesi, veprimtaria e të cilëve lidhet direkt ose indirekt me aktivitetin mbikëqyrës apo rregullator.

Në funksion të rivitalizimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të punës kërkimore në AMF dhe me qëllim marrjen e eksperiencës në fushën kërkimore në muajin maj 2018 u zhvillua takim ndërmjet AMF-së dhe BSh-së. Gjatë takimit, Banka e Shqipërisë ndau me AMF eksperiencën e saj në fushën kërkimore dhe ku në kuadër të këtij takimi u ra dakord se Banka e Shqipërisë do të mundësoje duke vënë në dispozicion për Autoritetin të gjithë literaturën e saj pranë Bibliotekës së Bankës. Ky bashkëpunim është në fokus të Autoritetit ndaj do të thellohet dhe forcohet edhe më tej në të ardhmen.

### **5.2 Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar**

#### **Partneritete dhe anëtarësime në organizata ndërkombëtare**

AMF është anëtare e **Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, (IAIS)**, që prej vitit 2001. Themeluar në vitin 1994, IAIS përfaqëson rregullatorët dhe mbikëqyrësit e më shumë se 200 juridiksioneve në rreth 140 vende. Objektivat e saj janë mbikëqyrja sa më efektive e industrisë së sigurimeve për zhvillimin dhe ruajtjen e tregjeve, si dhe mbrojtjen e të siguruarit, si dhe të kontribuojë në stabilitetin financiar global. Ky anëtarësim ka ndihmuar në thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar mes autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve.

Gjatë vitit 2018, AMF vazhdoi pjesëmarrjen në mënyrë aktive në aktivitetet e IAIS. Këto janë disa nga aktivitetet e IAIS, ku AMF ka marrë pjesë si anëtare e kësaj organizate.

Në Konferencën e 25-të vjetore të IAIS-it, në muajin nëntor 2018, AMF prezantoi iniciativat e ndërmarra për të rritur edukimin financiar në vend, në kuadër të Strategjisë së miratuar nga Bordi i Autoritetit për të rritur besimin e konsumatorëve në tregjet nën mbikëqyrje. Gjithashtu, AMF vazhdoi pjesëmarrjen në mënyrë aktive në aktivitete të tjera të organizuara nga IAIS. Më poshtë vijojnë disa nga aktivitetet kryesore të IAIS, ku AMF ka marrë pjesë si anëtare e kësaj organizate:

**Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IAIS**

- Mbledhjet e Komiteteve dhe Konferencës Vjetore të IAIS-it;
- Mbledhjet e Komiteteve dhe Nënkomiteteve të IAIS-it dhe konferenca globale e sigurimeve;
- Takimi Rajonal i IAIS për Evropën Qëndrore, Lindore dhe Transkaukazinë.

AMF është anëtare me të drejta të plota në **Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë, (IOSCO)** dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s që prej vitit 2009. Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë është organizmi ndërkombëtar që mbledh së bashku rreth 95% të rregullatorëve të letrave me vlerë në gjithë botën dhe njihet si hartues i standardeve globale për sektorin e letrave me vlerë. IOSCO zhvillon, zbaton dhe promovon respektimin e standardeve të njohura ndërkombëtare për rregullimin e letrave me vlerë.

AMF ka qenë e angazhuar në plotësimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja në këtë organizatë dhe vazhdon të plotësojë kuadrin rregullator, me qëllim përafrimin me standardet e parimet e IOSCO-s. AMF është gjithashtu pjesëmarrëse aktive në Komitetin Evropian të IOSCO-s (*European Regional Committee, ERC*) dhe anëtare e Komitetit të Tregjeve në Rritje e Zhvillim (*Growth and Emerging Markets Committee, GEM*).

Më poshtë është një përmbledhje e pjesëmarrjes së AMF-së në aktivitetet e organizuara nga IOSCO gjatë vitit 2018.

**Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOSCO**

- Mbledhjet e Komiteteve të IOSCO-s (*GEM*);
- Seminar “Mbi mbrojtjen e investitorit nëpërmjet mbikëqyrjes, inspektimeve dhe ekzaminimeve”.

AMF është anëtare e **Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS)**, që prej vitit 2006. IOPS është organizatë e pavarur ndërkombëtare, e cila përfaqëson ato institucione që janë përfshirë në mbikëqyrjen e marrëveshjeve të pensioneve private. IOPS aktualisht ka 87 anëtarë dhe vëzhgues që përfaqësojnë 76 vende dhe territore në të gjithë botën.

#### **Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOPS**

- Seminari Ndërkombëtar i IOPS
- Mbledhja e Përbashkët e Grupit të Punës dhe Seminari kërkimor i IOPS/OECD mbi Pensionet Private;
- Forumi Global OECD/IOPS “Mbi kujdesin për të ardhmen e pensioneve;
- Mbledhja e Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive, Mbledhja e Përgjithshme

Pjesëmarrja e AMF-së në këto aktivitete konsiston në angazhimin për hartimin e dokumenteve politikë dhe studimorë. Gjatë vitit 2018, AMF ka vazhduar kontributin e saj si pjesëmarrëse në plotësimin e dokumenteve dhe pyetësorëve të ndryshëm, duke dhënë informacion lidhur me praktikën e ndjekur aktualisht në tregjet e mbikëqyrura nga AMF. Anëtarësimi në këto organizata i ofron mbështetje Autoritetit në zgjidhjen e problematikave dhe çështjeve të lidhura me tregjet nën mbikëqyrje.

Projektet strategjike dhe rritja e kapaciteteve institucionale të AMF-së janë mbështetur edhe gjatë vitit 2018 nëpërmjet bashkëpunimit dhe marrëdhënieve efektive me institucionet ndërkombëtare, financiare dhe donatorët. Kështu, gjatë vitit 2018, AMF ka bashkëpunuar me Bankën Botërore, Sekretariatën Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), organizatën A2II, dhe FSVC.

Banka Botërore mbetet një partner i rëndësishëm strategjik që mbështet Autoritetin në vite, në përmbushje të misionit themelor. Edhe gjatë vitit 2018, Banka Botërore vijoi të mbështesë Autoritetin në zbatimin e projektit të asistencës teknike “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i fokusuar në zhvillimin e tregut të kapitaleve”. Banka Botërore, nëpërmjet ekspertizës dhe ekspertëve të saj, ka ndjekur në vazhdimësi zhvillimin e këtij projekti të rëndësishëm, i cili është i financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike Zvicerane (SECO) përmes Grantit (*Trust Fund Grant*).

Gjithashtu, gjatë vitit 2018 Autoriteti i mbështetur nga Banka Botërore vazhdoi zbatimin e projektit “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar”, i cili synon të mbështesë dhe ndihmojë rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të rregullatorëve financiarë (AMF dhe B.SH.) në monitorimin dhe zbatimin e një cilësie të lartë të raportimeve financiare bazuar në IFRS si dhe në përgatitjen e mjeteve, duke dhënë udhëzime dhe rekomandime për rishikimin e cilësisë dhe për përmirësimin e praktikave të komunikimit me auditorët i cili ndihmon Autoritetin për vlerësimin e raporteve të auditit të jashtëm të shoqërive nën mbikëqyrje.

Gjatë vizitave zyrtare të misioneve të Bankës Botërore në Tiranë, përfaqësuesit e Bankës Botërore kanë shprehur vlerësimin e saj të konsiderueshëm lidhur me punën e kryer nga AMF në kuadër të zbatimit të projektit. Stafi i AMF-së në bashkëpunim me konsulentët e projektit dhe mbështetjen e Bankës Botërore kanë punuar intensivisht për të realizuar

produktet e projektit me një cilësi të lartë dhe brenda afateve. Ky bashkëpunim i suksesshëm pritet për të arritur finalizimin e projektit në tremujorin e parë të vitit 2019.

### **Bashkëpunimi me Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare (FSVC)**

Një partner shumë i rëndësishëm për AMF-në është dhe Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC/USAID). Ndër vite kjo organizatë ka ndihmuar AMF-në në projekte të ndryshme, për forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator, si edhe zhvillimin e burimeve njerëzore. Edhe gjatë vitit 2018, AMF dhe FSVC kanë thelluar bashkëpunimin duke vijuar me projektet si Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm (*Early Warning System*), Memorandumin mbi bashkëpunimin mes AMF-së dhe FSVC-së.

#### **AMF thëllon bashkëpunimin me Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare**

Janar 2018 - Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi një takim me përfaqësues të Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare, FSVC-së. Objekti i takimit ishte thellimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe nisja e projekteve të përbashkëta midis dy institucioneve. Përfaqësuesit e FSVC-së u shprehën të gatshëm për thellimin e bashkëpunimit me Autoritetin duke rritur edhe numrin e projekteve të përbashkëta.

Qershor 2018 - u nënshkrua Memorandum Mirëkuptimi midis AMF-së dhe FSVC-së, pas miratimit nga Bordi i AMF-së sipas Vendimit 93, datë 13.06.2018.

Gjatë vitit 2018, Autoriteti ka pasur në vëmendje zgjerimin dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe me autoritetet homologe, duke marrë pjesë në takimet apo veprimtaritë e organizuara për njohjen dhe përditësimin me tendencat më të fundit mbikëqyrëse dhe rregullatore si dhe shkëmbimit të përvojave të ndërsjella.

### **Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA)**

Një partner mjaft i rëndësishëm i AMF-së në zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje prej vitesh është Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (*FMA*). Bashkëpunimi me FMA-në, është konsoliduar ndër vite edhe materializuar me takime të shpeshta të drejtuesve të lartë të institucioneve, si edhe të stafeve teknike. Prej vitit 2009, të dy institucionet kanë një marrëveshje mirëkuptimi, e cila u nënshkrua pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri, duke u konkretizuar me shkëmbim përvoje dhe punë të përbashkët në mbikëqyrjen e grupeve austriake që operojnë në Shqipëri.

Në këtë kuadër, një delegacion i nivelit të lartë drejtues i AMF-së bëri një vizitë pune në muajin dhjetor 2018, në Austri pranë zyrave të FMA, dhe zhvilloi takime me drejtues të lartë të këtij Autoriteti. Gjatë takimeve u diskutua për çështje të rëndësishme të interesit të përbashkët, si dhe u pasqyruan zhvillimet e fundit për tregjet e sigurimeve



të Austrisë dhe Shqipërisë. Për më tepër, takimet u përqendruan në zhvillimet e reja të tregut të sigurimeve gjatë zbatimit të *Solvency II* në tregjet e mbikëqyrura.

AMF është pjesëmarrëse e rregullt e kolegjeve mbikëqyrëse të “*UNIQA Insurance Group*” (UIG) dhe “*Vienna Insurance Group*” (VIG). Ekspertët e departamentit të mbikëqyrjes të AMF-së në vitin 2018 morën pjesë në mbledhjet dyditore të Kolegjit të Mbikëqyrjes të Grupit UIG dhe atij të Grupit VIG.

Mbi këtë bazë janë ndërtuar marrëdhënie të suksesshme ndërmjet dy institucioneve, duke u konkretizuar me shkëmbim përvoja dhe me nënshkrimin në vitin 2016 të **Marrëveshjes së Koordinimit për Kolegjet Mbikëqyrëse VIG**, e cila ka për qëllim të përcaktojë rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të këtij Grupi, shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave profesionale midis tyre, bashkëpunim sa më efikas ndërmjet anëtarëve të Grupit dhe kompanisë mëmë, si dhe një konsultim për procesin e vendimmarrjes ndërmjet anëtarëve të Grupit.

## **IVASS dhe CONSOB – ITALI**

Në kuadrin e zgjerimit të marrëdhënieve dypalëshe me autoritetet homologe, drejtues të nivelit të lartë të AMF-së, në janar të vitit 2018 zhvilluan takime pune të nivelit të lartë me zyrtarë të Institutit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Italisë (IVASS), dhe Komisioni Kombëtar për Ruajtjen e Pensioneve (COVIP). Në këto takime u diskutua mbi forcimin e marrëdhënieve midis dy autoriteteve rregullatore nëpërmjet asistencës teknike, trajnimeve, si dhe u dakordësua hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes së re dypalëshe të mirëkuptimit ndërmjet AMF dhe IVASS.

Në takimet me përfaqësues të Komisionit Italian për Shoqëritë dhe Bursën (CONSOB) u diskutua për nënshkrimin e një marrëveshje të re mirëkuptimi midis dy autoriteteve bazuar në ndryshimet ligjore të kuadrit mbikëqyrës dhe rregullativ të këtyre dy institucioneve.

Në muajin tetor me ftesë të IVASS, një delegacion i AMF-së mori pjesë në konferencën e tretë vjetore mbi aplikimin e *Solvency II*, konferencë e cila u organizua nga IVASS.

## **Bashkëpunimi Rajonal**

Edhe në vitin 2018 ka vijuar bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit, nëpërmjet takimeve të përbashkëta pune, shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave në aspektin rregullator e mbikëqyrës, me synim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo bankarë.

### **Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Kroacisë (HANFA)**

Një partner i rëndësishëm i AMF-së në zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje prej vitesh është dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Kroacisë (HANFA) vend i cili është dhe anëtar i BE-së dhe aplikon *Solvency II*.

Duke u nisur edhe nga roli i leadershipit në rajon, në muajin prill drejtuesit ekzekutiv të AMF-së morën pjesë në një takim të nivelit të lartë pranë ambienteve të HANFA në Zagreb me përfaqësuesit e HANFA, takim i cili ishte shumë pozitiv për rolin që AMF ka në rajon. Në muajin nëntor drejtuesit ekzekutiv të HANFA realizuan një vizitë pune pranë ambienteve të AMF-së ku u ritheksua nevoja për një marrëdhënie sa më të qëndrueshme dhe shkëmbim eksperiencash ndërmjet dy institucioneve.

### **Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës të Maqedonisë Veriore (ISA)**

AMF ka bashkëpunuar ngushtë me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ISA). Marrëveshja e Mirëkuptimit midis dy institucioneve, e cila është në veprim që prej vitit 2010, ndikon pozitivisht në efikasitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të industrisë së sigurimeve të dy vendeve, sidomos në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë të shoqërive shqiptare të sigurimit në territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore.

Në shkurt 2018 me iniciativën e ISA dhe XPRIMM Media, përfaqësues të AMF morën pjesë në Konferencën Rajonale për aktuarët në sigurime e cila u mbajt në Shkup si dhe në muajin korrik u zhvillua një takim pune i specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit të AMF-së me autoritetet homologe në Maqedoni për shkëmbim eksperiencash në fushën e TI-së.

Në dhjetor 2018, dy autoritetet rregullatore, përkatësisht AMF dhe ISA së bashku me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), zhvilluan një takim të përbashkët pune i cili kishte për qëllim forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit përgjatë 2019, për një mbikëqyrje efektive dhe dinamike të tregut të sigurimeve në tre shtetet pjesëmarrëse.

### **Banka Qendrore e Kosovës (BQK)**

Bashkëpunimi i AMF-së me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) vijoi të forcohet edhe gjatë vitit 2018. Në kuadër të thellimit të bashkëpunimit midis dy autoriteteve, në muajin korrik në Prishtinë u zhvillua një takim pune midis specialistëve të TI të AMF-së dhe specialistëve të TI-së së BQK-së. Gjithashtu në muajin dhjetor 2018, u zhvillua një takim

pune pranë zyrave të AMF-së, me pjesëmarrjen edhe të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë Veriore (ISA) mbi shoqëritë e sigurimit, të cilat e kanë shtrirë aktivitetin e tyre si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë e Maqedoni. Takimi synonte forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit, si në drejtim të shkëmbimit të informacionit, përvojave teknike e profesionale për një mbikëqyrje sa më efektive, ashtu edhe të diskutimit të problematikave që lidhen me mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve respektive të sigurimit ku u vendos edhe frekuenca dhe një plan pune për mbledhje të përbashkëta përgjatë vitit 2019.

### **Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE ISI)**

Një takim tjetër i rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit rajonal është dhe **“Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore”, (CESEE ISI)**, që ka vazhduar të mbështesë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave më të mira midis punonjësve të autoriteteve rregullatore në tregun e sigurimeve.

AMF është pjesëmarrëse aktive në nismën rajonale “Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore”, (CESEE ISI), e cila konsiderohet e suksesshme, nisur nga interesimi i vazhdueshëm dhe pjesëmarrja aktive e vendeve të rajonit, duke ruajtur dhe nxitur më tej frymën e bashkëpunimit efektiv mbi çështjet dhe problematikat e përbashkëta që hasen në rregullimin e tregjeve të sigurimeve në rajon. Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar dy takime të kësaj iniciative, njëri në vendin tonë, nën kujdesin organizativ të AMF-së, ndërsa tjetri në Vjenë, Austri. Në takimin e pesëmbëdhjetë në Tiranë çështjet e trajtuara lidheshin me zbatimin praktik të Direktivës së re të BE-së, “Shpërndarja në sigurime”, si dhe problematikat e hasura gjatë transpozimit të saj në legjislacionin kombëtar të çdo vendi.

Në takimin e 16-të në Vjenë, me temë “Mbikëqyrja me Bazë Rreziku”, u trajtuan sfidat e mbikëqyrjes me bazë rreziku, sfidat dhe eksperiencat e rregullatorëve në drejtim të vënies në zbatim të regjimeve të reja mbikëqyrëse, qasja e tregjeve ndaj kërkesave të reja, mbikëqyrja e grupeve të sigurimit, si dhe mënyrat e rritjes së bashkëpunimit midis rregullatorëve të rajonit. Në këtë takim, një nga temat u moderua nga një përfaqësues i AMF-së.

### **EIOPA dhe Banka Botërore organizuan në Shqipëri me mbështetjen e AMF-së *workshopin* ndërkombëtar me temë “Mbikëqyrja me Bazë Rreziku,” për Sigurimin dhe Risigurimin.**

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) në bashkëpunim me Bankën Botërore organizoi për herë të parë në Shqipëri *workshopin* ndërkombëtar me temë “Mbikëqyrja me bazë rreziku,” nën kujdesin organizativ të

AMF-së, në muajin shtator 2018. Në këtë event morën pjesë përfaqësues të autoriteteve homologe rregullatore dhe mbikëqyrëse, përfaqësues të grupeve të sigurimit dhe risigurimit, ku u diskutuan dhe u shkëmbyen eksperiencat dhe pikëpamje mbi tendencat globale të mbikëqyrjes me bazë rreziku, si dhe sfidat që lidhen me zbatimin e standardeve globale të mbikëqyrjes. Punonjës të Autoritetit asistuan në moderimin e këtij takimi dy-ditor, si dhe përfaqësuan institucionin me prezantimin me temë “Elementë për provigjonim dhe çmim të përshtatshëm”.

### **Takimi i autoriteteve të tregut të kapitalit të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6)**

Në muajin prill, AMF mori pjesë në takimin e dytë të autoriteteve të tregut të kapitalit të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) “Diversifikimi i sistemeve financiare për të rritur investimet”. Takimi shqyrtoi mundësitë për integrimin e tregjeve financiare në rajon dhe konkretisht të tregjeve të kapitalit, duke vlerësuar edhe nevojën për një strategji rajonale për zhvillimin e tregjeve të kapitalit. Përfaqësuesi i Shqipërisë bëri një prezantim mbi zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri dhe sfidat me të cilat ato përballen.

## **5.3 Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje**

### **Hapja e Negociatave për Shqipërinë**

Aktualisht procesi i integritit evropian i Republikës së Shqipërisë ndodhet në një moment tejet të rëndësishëm pas propozimit të dhënë nga Komisioni Evropian më datë 9 nëntor 2016, të hapjes së kushtëzuar të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Marrja e këtij rekomandimi pozitiv nga Komisioni Evropian për Shqipërinë është gjysma e rrugës drejt ëndrrës për nisjen e bisedimeve për anëtarësim. Vendimi përfundimtar jepet në qershor, kur Këshilli i Ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare do të mblidhen dhe do të votojnë nëse pranojnë apo jo hapjen e negociatave me Shqipërinë. Këshilli Evropian i ka dhënë mandat të qartë politik Komisionit Evropian që të vazhdojë angazhimin e tij të veçantë për Shqipërinë. Ky angazhim do të përfshijë edhe përdorimin e disa proceseve teknike të cilat normalisht kryhen vetëm pas hapjes zyrtare të negociatave të anëtarësimit. Si pjesë e këtij procesi teknik është rënë dakord me Komisionin Evropian fillimisht zhvillimi i takimeve për njohjen e legjislacionit të Bashkimit Evropian (*Screening*) të kapitujve negociues.

**Grafik 36: Fazat nga hapja deri në mbylljen e negociatave**



Konkretisht ky proces përfshin analizimin (*Screening*) e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë shërbimet financiare jo bankare për tre fushat dhe përcaktimin e shkallës së përputhshmërisë të tyre me *acquis* e BE-së (direktiva, rregullore, vendime, udhëzime, Vendime të Gjykatës Evropiane), si dhe nenet përkatëse të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian. Ky proces pritet të zgjasë në total 1 vit deri në 1 vit e gjysmë. Procesi i *Screening* përbëhet nga *Screening Shpjegues*; *Screening Dypalësh*;

Faza e *Screening analitik* të legjislacionit fillon me të ashtuquajturin *Screening Shpjegues* gjatë të cilit KE do t'i paraqesë vendit kandidat *acquis* të ndarë në kapitujt negociues. Faza shpjeguese zgjat maksimumi 5 ditë.

Më pas, do të bëhet një vlerësim, nëpërmjet të ashtuquajturit *Screening Dypalësh*, të nivelit të harmonizimit të sistemit ligjor të vendit kandidat me *acquis* e BE-së dhe do të përcaktohet ajo që ende duhet të bëhet për të arritur përputhjen me *acquis* të BE-së në pritje të një anëtarësimi të plotë.

Pas përfundimit të *Screening Dypalësh*, KE do t'i paraqesë Shteteve Anëtare një raport të *Screening* që përmban rekomandime për fillimin e negociatave për një kapitull të veçantë ose nëse vlerësohet nga KE do të përfshijë *Standardet e Hapjes (Opening Benchmarks)* të një kapitulli të veçantë. Standardet e Hapjes lidhen me kërkesat për miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit, përmbushjen e detyrimeve kontraktuale ndaj BE-së, kryesisht zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, kërkesa për miratimin e ligjeve dhe akteve nënligjore etj. Hapja e negociatave për kapitujt që duhet të përmbushnin Standardet e Hapjes mund të fillojnë vetëm pasi Këshilli i BE-së vendos që vendi kandidat i ka përmbushur këto standarde.

## Roli i AMF-së në Integrimin Evropian

AMF ka bërë përpjekje pozitive për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm të shërbimeve financiare me *acquis*. Legjislacioni aktual i Shqipërisë në fushën e shërbimeve financiare përbën një bazë të fortë për një harmonizim të mëtijshëm dhe të plotë me legjislacionin evropian. Në fushën e shërbimeve financiare jobankare është konsoliduar puna për rishikimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës duke synuar përafrimin e mëtijshëm të tij me *acquis* e BE-së dhe është bërë progres në përafrimin e legjislacionit të tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private. AMF si institucion kontribues në këtë proces ka punuar intensivisht përta i përket përafrimit të kuadrit ligjor, gjë që nënvizohet edhe në Progres Raportin e fundit të BE-së.

Gjithahstu AMF ka vazhduar të japë kontributin e saj në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Raporti i Progresit dhe Plani Kombëtar i Integritimit Evropian. Ajo koordinon dhe përgatit raportimet në lidhje me Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, si dhe është kontribues në kapitujt Kriteri Ekonomik dhe Kapitulli 17 “Politika Ekonomike dhe Monetare”.

AMF gjithashtu ka monitoruar rregullisht zbatimin e MSA-së, si dhe të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. Ajo ka marrë pjesë në takimet e radhës të nënkomiteteve përkatëse si dhe ka kryer raportime të suksesshme në kuadër të Integritimit Evropian më konkretisht:

- Takimi i 10-të i Nënkomitetit Çështjet Ekonomike – Financiare & Statistikat - 27 shtator 2018;
- Takimi i 10-të i Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit - 21 shkurt 2019;

Vlerësimi i palës evropiane gjatë këtyre raportimeve ishte pozitiv për veprimtarinë e AMF-së dhe rekomandimi i vetëm për AMF në Progres Raportin e KE-së për Shqipërinë ishte miratimi i projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit”.

Gjatë vitit 2018, AMF ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si institucioni koordinues në procesin e integritimit evropian. AMF ka përgatitur raporte të cilat pasqyrojnë progresin e arritur duke kontribuar në hartimin e dokumenteve që lidhen me procesin e Stabilizim-Asociimit. Kyçi i suksesit të Shqipërisë në rrugën e integritimit evropian është zbatimi i shpejtë i reformave, përmes aktiviteteve të planifikuara, në një nga dokumentet bazë siç është Plani Kombëtar i Integritimit Evropian (PKIE) për periudhën 2018-2020, i cili shërben si bazë për planifikimin e procesit të integritimit evropian të Shqipërisë. AMF gjatë vitit 2018 ka përcjellë në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme informacione periodike për monitorimin e realizimit të PKIE 2018-2020 për kapitujt “Shërbimet Financiare” dhe “Kriteri Ekonomik”, si dhe ka punuar për hartimin e planit për periudhën 2019-2021, si një nga instrumentet kryesore për

planifikimin dhe monitorimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, në procesin e integritit evropian të Shqipërisë.

Edhe gjatë vitit 2018 Autoriteti në cilësinë e koordinatorit të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare” ka zhvilluar takime mujore të GNPIE-së për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, pjesë e të cilit është edhe Banka e Shqipërisë, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 500, datë 13.09.2017 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”, si dhe ka marrë pjesë edhe në takimet mujore të GNPIE-ve të Kapitullit “Kriteri ekonomik”.

#### **Direktiva MiFID II (Direktiva për Tregjet e Instrumentave Financiare)**

Direktiva MiFID II 2014/65/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, data 15 maj 2014, "Për tregjet e instrumenteve financiare dhe që ndryshon direktivën 2002/92/KE dhe direktivën 2011/61/BE", është direktiva bazë, më e rëndësishmja e rregullimit të tregjeve financiare të BE-së, e cila përcaktohet si perspektiva e re evropiane për instrumentet financiarë.

Në tetor 2011, pas konsultimeve për reformimin e kësaj direktive, Komisioni Evropian publikoi propozimet legjislative të cilat morën formën e MiFID II (*Market in Financial Instruments Directive*) dhe rregullores së re MiFIR (*Market in Financial Instruments Regulation*).

***Të dyja MiFID II dhe MiFIR hynë në fuqi në 2 korrik 2014, duhen të transpozoheshin brenda korrikut 2017 në ligjet e shteteve anëtare, dhe u bënë të zbatueshme që nga 3 janari 2018.***

MiFID II do të sjellë ndryshime dhe ndikim shumë të madh në tregjet financiare. Ajo do t'i bëjë ato më të integruara, më efikase, konkurruese dhe do të përmirësojë mbikëqyrjen dhe transparencën dhe rrisë mbrojtjen e investitorëve dhe konsumatorëve. Kjo direktivë mundësoi për herë të parë konkurrencën në tregtimin e titujve midis firmave dhe tregjeve të ndryshme të investimit që operojnë në BE dhe ju dha atyre “një pasaportë” për të tregtuar kudo në BE, bazuar vetëm në autorizime shtetit të tyre anëtar. Direktiva gjithashtu përfshiu dhe masa të ndryshme për mbrojtjen e investitorëve. MiFID II synon:

- Të sigurojë më shumë integritet, konkurrencë efikase të tregut financiar të BE-së;
- Të krijojë një treg financiar të sigurt, të shëndoshë, më shumë transparent dhe të përgjegjshëm;
- Të sigurojë që tregtimi i organizuar të bëhet në platforma të rregulluara;
- Të sigurojë rritjen e mbrojtjes së investitorëve dhe përmirësimin e sjelljes së rregullave të biznesit, si dhe kushtet për konkurrencë në tregtimin e instrumenteve financiare;
- Të përmirësojë mbikëqyrjen dhe zbatueshmërinë.

## 5.4 Projekte

### **Projekti “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar” me komponent “Përmirësimi i kapaciteteve të rregullatorëve financiarë”.**

Në kuadër të projektit në rang kombëtar “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar (REPARIS), AMF është përfitues i komponentit të dytë të projektit “Përmirësimi i kapaciteteve të rregullatorëve financiarë në monitorimin dhe kontrollin e zbatimit më të mirë të raportimit financiar” Ky komponent i projektit është financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), administrohet nga Banka Botërore dhe ekzekutohet nga Ministria Financave dhe Ekonomisë. Projekti ka filluar në korrik 2017 dhe pritet të përfundojë në prill 2019.

Pas përfundimit të fazës së parë të projektit, “Trajnimi mbi SNRF-të me fokus në sigurime dhe fonde” në shkurt 2018, ku u kryer trajnimi i stafit të AMF-së, për standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF-të), është punuar me fazën e dytë konkretisht për përgatitjen e mjeteve për rishikimin e cilësisë së auditimit dhe shpërndarja e trajnimeve përkatëse, udhëzime të cilat ndihmojnë Autoritetin për vlerësimin e raporteve të auditit të jashtëm të shoqërive nën mbikëqyrje.

Përgjatë vitit 2018, paralelisht u zbatua edhe faza e tretë e projektit në kuadër të komunikimit të rregullatorëve me auditorët ligjorë duke përpiluar një raport vlerësimi për nivelin e bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve dhe auditorëve, raport që jep rekomandime për përmirësim e praktikave të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit me auditorët sipas modeleve të shteteve të tjera.

Nëpërmjet këtij projekti u synua përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve të rëndësishme të mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar në vend, në nivel ekspertize, sistemi dhe kapaciteti rregullator në drejtim të përshtatjes dhe zbatimit të standardeve më të larta të legjislacionit të BE-së dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

### **Projekti i Mikrosigurimeve “Akses në Iniciativën e Sigurimeve” (A2ii)**

Ky projekt mbështetet dhe financohet nga Iniciativa për Akses në Sigurime (*Access to Insurance Initiative*) në bashkëpunim me Akademinë për Udhëheqje Globale të GIZ (*GIZ Global Leadership Academy*). Projekti synon të promovojë bashkëpunimin shumë palësh, të mësuarit nga kolegët ndërkombëtarë dhe zhvillimin e zgjidhjeve inovative që do të rrisin pranimin e sigurimeve në popullatën me të ardhura të ulëta si dhe bizneseve të vogla. Projekti bashkon një gamë të gjerë të aktorëve gjithëpërfshirës të fushës së sigurimit të përfshirë në 4 ekipet e vendeve të përzgjedhura, për të mundësuar një zgjidhje inovative, në drejtim të rritjes së shkallës së përfshirjes së grupeve vulnerabël në skemat e sigurimit vullnetar.



Një nga arsyt kryesore të ndërmarrjes së këtij projekti është shkalla e ulët e penetrimit të produkteve të sigurimit, kryesisht tek popullsia me të ardhura të ulëta dhe të bizneset e së njëjtës kategori, në shumicën e ekonomive në zhvillim duke i përjashtuar nga përfitimet që ofron sektori i sigurimeve në mbulimin e humbjeve të paparashikuara dhe financiare.

Projekti nisi konkretisht në muajin nëntor 2017 dhe pati një kohëzgjatje prej 12 muaj, deri në muajin nëntor 2018.

Shqipëria krijoi skuadrën kombëtare me përfaqësues nga shoqëritë e sigurimit, banka, agjenci kreditimi si edhe organizma të tjerë që kanë aktivitet në fushën financiare dhe të biznesit, e cila punoi për të adresuar në një mënyrë të re sfidat me të cilat përballet industria e sigurimeve në vend lidhur me mikrosigurimet, si sigurime vullnetare gjithëpërfshirëse.

Në prill 2018 u zhvillua takimi i dytë kombëtar në kuadrin e këtij projekti. Ekipi pjesëmarrës punoi në disa drejtime, me qëllim ndërtimin e besimit, lidhjeve bashkëpunuese, krijimin e dialogut për sigurimet vullnetare dhe gjetjen e formave, skemave, produkteve të reja dhe aplikimin e tyre, me objektiv qasjen ndaj sfidës së rritjes së pjesëmarrjes së popullsisë së gjerë në skema sigurimesh vullnetare.

Ky takim u pasua nga takimi internacional i Laboratorit të Mendimit në qershor 2018 ku u përpunuan studimet dhe idetë më të mira në kuadër të dizenjimit të produkteve të përshtatshme nga ekipet e përzgjedhura internacionale, kjo sipas programit të projektit.

Më pas, AMF zhvilloi në ambientet e saj, konkretisht në shtator 2018, *workshopin* e 3-të kombëtar, dhe të fundit me objekt vlerësimi, nëse këto studime nënkuptojnë sfida ndaj "teorisë së ndryshimit" të tyre dhe çfarëdo korrigjimi, si dhe se si këto gjetje këto mësimet të nxjerra mund të përdoren për të shkuar përpara; rishikimi dhe rikalibrimi i ideve dhe qasjet dhe planifikimi i hapave të mëtejshëm për zbatim si dhe parashikimi për një të ardhme më të gjatë e më gjithëpërfshirëse të Laboratorit të Mendimit.

Gjatë *workshopit* tek pjesëmarrësit, u prezantua puna e ekipit të projektit për mbështetjen dhe zhvillimin e produkteve të sigurimeve gjithëpërfshirëse të fokusuara në fushën e bujqësisë.

Të pranishëm ishin edhe pedagogë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, të cilët mbështetetur në një studim të posaçëm dhe në përvojën e tyre, dhanë opinione se si mund të zgjerohet më tej siguri në sektorin e bujqësisë. Gjithashtu, në kontekstin e rritjes së aksesit në financim për sektorin e bujqësisë, përfaqësuesit e institucioneve të mikrofinancimit në Shqipëri, shprehën opinionin e tyre pozitive për nevojën e produkteve të reja në tregun e sigurimeve, me synim rritjen e përfshirjes së individëve dhe bizneseve të vogla e të mesme në skemat e sigurimeve.

Ky projekt ishte një përvojë e mirë në diskutimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për kapërcimin e barrierave ndaj kostos së produkteve dhe futjen e produkteve të reja të përshtatshme për një mundësi përfshirje sa më të gjerë të shtresave vulnerabël në produktet e sigurimeve.

### **Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”**

Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve” synon të mbështesë AMF-në në forcimin e kapaciteteve të saj në mbikëqyrjen e tregut të fondeve të investimeve dhe tregjet e obligacioneve të korporatave dhe atyre të qeverisë vendore. Ky projekt është mbështetur nga Banka Botërore, e cila ndjekë edhe zbatimin e tij, ndërsa Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) është financues i këtij projekti përmes Grantit (*Trust Fund Grant*).

Projekti ka filluar të zbatohet në muajin korrik 2016, dhe pritet të përfundojë në muajin mars të vitit 2019. Ai është hartuar për të përballuar sfidat me të cilat po përballlet AMF dhe fushat që mbulon ky projekt janë kryesisht:

- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve të investimeve. Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, të zhvillohet paketa e mbikëqyrjes (metodologjia, manualët dhe mjetet), si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për t’u përgatitur për emetimet e obligacioneve të shoqërive aksionare dhe atyre të qeverisë vendore. Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në fushën e instrumenteve dhe tregjeve të borxhit.

Projekti është i ndarë në tri faza zbatimi:

- Faza e parë: Zhvillimi i kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rregulluese të AMF-s për sektorin e fondeve të investimeve /Vlerësimi i nevojave mbikëqyrëse të AMF-së në lidhje me zhvillimin e shpejtë të sektorit të fondeve të investimeve. (Kjo fazë ka përfunduar në vitin 2017);
- Faza e dytë: Shqyrtimi dhe zhvillimi i legjislacionit dhe kuadrit mbikëqyrës për sektorin e fondeve të investimeve dhe tregun e obligacioneve (Faza përfundoi në mars 2019);
- Faza e tretë: Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së të mbikëqyrë dhe rregullojë sektorin e fondeve të investimeve dhe tregun e bonove/ndërtimi i kapaciteteve (Faza përfundoi në mars 2019).

Gjatë vitit 2018 është kryer një punë intensive në kuadër të zbatimit të Fazës II të projektit, duke realizuar përfundimin e një sërë raportesh, ku vlen të përmenden:

- Janar 2018 - Organizimi dhe mbajtja e takimit të konsulentëve të projektit me anëtarët e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, si dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, me qëllim ndërgjegjësimin e deputetëve për domosdoshmërinë hartimit dhe miratimit të dy draft ligjeve për t'iu përgjigjur zhvillimeve të tregjeve të kapitaleve;
- Hartimi final i Ligjit për Fondet e Investimeve dhe ai i Ligjit të Letrave me Vlerë, dy prej produkteve më të rëndësishëm të projektit;
- Janar 2018 – miratuar në Bord, Rregullore nr. 16 datë 31.01.2018 “Mbi formularin e kërkesës, përmbajtjen e dokumentacionit për miratim prospekti”;
- Shkurt 2018 - miratuar në Bord, Rregullore nr. 21, datë 06.02.2018 “Për administrimin e likuiditetit të FI”;
- Mars 2018 - miratuar në Bord, Rregullore nr. 57, datë 29.03.2018 “ Për palët e lidhura”;
- Tetor 2018 – miratuar nga AMF raporti final i rishikuar i menaxhimit të krizës, me pjesëmarrjen e GKFS.

Gjatë vitit 2018, puna ka vazhduar edhe me zbatimin e fazës së tretë të projektit lidhur me zhvillimin e kapaciteteve dhe trajnimet e stafit. Konkretisht është punuar dhe janë zhvilluar trajnime/vizita, si dhe *workshope* brenda dhe jashtë vendit.

Janë hartuar një sërë raportesh si dhe është mbajtur korrespondencë e vazhdueshme me të gjithë palët, Bankën Botërore, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, departamentet në AMF për implementimin e projektit.

Mbi vëzhgimin e ecurisë së projektit, janë përpiluar raporte mujore, raporte 6-mujore, si dhe janë organizuar mbledhjet e *Project Steering Committee*, me përfaqësues nga AMF, Banka Botërore dhe SECO (dy herë gjatë vitit 2018). Projekti pritet të përfundojë në mars 2019.

**Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, për paketën "Studimi i formës së ardhshme të Depozitarit Qendror të letrave me vlerë në Shqipëri"**

Tregtia e letrave me vlerë përveç atyre të Qeverisë në Bursën Shqiptare (ALSE), është e lidhur ngushtë me licencimin e Regjistruesit të Letrave me Vlerë dhe Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë.

Depozitari Qendror i Letrave me Vlerë është një institucion i rëndësishëm tregu i cili promovon interesin publik dhe shërben për të mbrojtur investitorët duke siguruar funksionin e Klerimit dhe Shlyerjes.

Infrastruktura aktuale e Sistemit të Shlyerjes së Letrave me Vlerë mbështet vetëm obligacionet e Qeverisë Shqiptare, të cilat regjistrohen dhe klerohen nëpërmjet AFISaR, operuar nga Banka e Shqipërisë. Me qëllim mbështetjen e krijimit të një Depozitari Qendror të Letrave me Vlerë, Autoriteti ndërmoi një aktivitet me kohëzgjatje prej tre muajsh në kuadër të projektit "Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF". Ky aktivitet përbëhej nga "Studimi i formës së ardhshme të Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë në Shqipëri".

Raporti përfundimtar mbi Depozitarin Qendror të Letrave me Vlerë u dorëzua në gusht 2018. Ky raport, i ofruar nga konsulenti i kontraktuar i këtij aktiviteti shpjegon rolin e Depozitarit, strukturën e tij të pronësisë, bazuar në kërkesat e IOSCO për të. Raporti përmban gjetjet kryesore dhe rekomandimet se si do të duket një Depozitar Qendror i Letrave me Vlerë në Shqipëri. Projekti zgjati për një periudhë dymbëdhjetë javore duke përfunduar në gusht 2018.

### **Projekte me asistencë teknike të Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare – FSVC**

Projektet e mbështetura nga FSVC gjatë vitit 2018 janë si më poshtë:

- Sistemi paralajmërimit të hershëm (*Early Warning System*). Gjatë vitit 2018 ka vijuar puna për ndjekjen e zbatimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm. Mbas punës së një ekipi të përbashkët me stafin e AMF-së dhe ekspert të FSVC për hartimin e një plani për një platformë të mbikëqyrjes së sigurimeve, e cila përfshin kriteret e paralajmërimit të hershëm, do të vazhdohet edhe gjatë 2019 me zbatimin që do të përfshijë gjithashtu automatizimin nëpërmjet një pakete *Business Intelligence (BI)*, që do të zgjidhet dhe instalohet nga stafi i TI në AMF.
- Projekti i asistencës teknike "Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik". Në janar 2018 AMF pati një vizitë të ekspertëve të FSVC në kuadër të projektit mbi TI dhe rishikimin e Rregullores "Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik". Më pas ekspertët përgatitën raportin përkatës, bazuar në takimet dhe vëzhgimet që ata patën me stafin e AMF-së gjatë javës së projektit, i cili përmban rekomandime mbi përmirësimin e katër aspekteve kryesore të lidhura me regjistrin, raporti i cili u dërgua në AMF nga përfaqësuesi i FSVC në muajin prill 2018. Ndjekja e projektit me FSVC vazhdon nga Autoriteti për përfshirjen në regjistrin *online* të shitjeve dhe të disa produkteve të tjera të detyrueshme.
- Në qershor 2018 u nënshkrua Memorandum Mirëkuptimi midis AMF-së dhe FSVC-së, pas miratimit nga Bordi sipas Vendimit 93, datë 13.06.2018.

- Një takim javor u zhvillua në tetor 2018 me konsulentë të FSVC në ambientet e AMF-së me përfaqësues të autoritetit, ku fokus ishte konsulenca dhe asistenca lidhur me rregullimin e mbikëqyrjes në tregun e sigurimeve, veçanërisht në problematikën dhe situatën financiare të shoqërive të Grupit Eurosig. Konsulentët e FSVC-së përgatitën një raport vlerësimi, i cili u shqyrtua më tej nga Autoriteti në kuadër të projektit të asistencës teknike për menaxhimin e skenarëve të performancës në lidhje me mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve.
- Gjatë vitit 2018 kanë vazhduar komunikimet ndërmjet Autoritetit dhe FSVC duke dhënë informacion mbi statusin e rekomandimeve të dhëna si dhe shprehjen e interesit për projekte të tjera të mundshme gjatë vitit 2019, si projekti i asistencës teknike "Siguria e informacionit në qendrën e informacionit", apo iniciativa të tjera në kuadër të projekteve për asistencë teknike në lidhje me mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve.

## **I. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I AMF-së**

### **II.1 Kuadri ligjor dhe rregullator i AMF-së**

Gjatë vitit 2018, me qëllim përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator të Autoritetit, e që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e tij, u miratuan këto akte të reja si edhe amendimet në aktet ekzistuese si më poshtë:

#### **Akte të reja**

Rregullore nr. 217, datë 31.10.2018 “Për organizimin e aktiviteteve të formimit profesional”, kjo rregullore synon të përcaktojë rregullat për organizimin dhe zhvillimin e trajtimeve për kualifikime profesionale për profesionet që licencohen/miratojnë nga Autoriteti.

Rregullore nr. 216, datë 31.10.2018 “Për njohjen e krediteve të formimit profesional në vazhdimësi”, kjo rregullore synon të përcaktojë kriteret dhe procedurën që ndiqet për vlerësimin e krediteve, me qëllim njohjen e tyre si kredite të vlefshme të formimit profesional në vazhdimësi për profesionet që licencohen/miratojnë nga Autoriteti.

Udhëzim nr. 20, datë 06.02.2018 “Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit”. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i parimeve dhe rregullave të përgjithshme të sigurisë së informacionit në AMF dhe përcaktimi i përgjegjësive për veprimet që lidhen me sigurinë me qëllim ruajtjen e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të aseteve të informacionit të Autoritetit.

#### **Amendime në aktet ekzistuese**

Shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, u miratuan me Vendimin e Bordit nr. 24, datë 26.02.2018 dhe konsistuan në rregulla për raportimin dhe afate për raportim, ndërsa amendimet e miratuara me vendimin nr. 214, datë 31.10.2018 ishin në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës.

Disa ndryshime në Rregulloren nr. 114, datë 11.09.2008 “Për konfidencialitetin në AMF”, u miratuan me Vendimin e Bordit nr. 247, datë 20.12.2018, me qëllim saktësimin e rregullave dhe procedurave për trajtimin me autoritetet e huaja të informacionit konfidencial, në përmbushjen edhe të rekomandimeve të raporteve MONEYVAL të Këshillit të Evropës. Gjithashtu, u ndryshua afati i trajtimit të kërkesave për informacion, dhe radha e trajtimit të tyre, kur ka disa kërkesa në të njëjtën kohë.

Me vendimin e Bordit nr. 95, datë 13.06.2018, u miratua një ndryshim në rregulloren nr. 75, datë 30.05.2016 “Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e

faqes së internetit”. Sipas këtij ndryshimi, Buletini Zyrtar përgatitet brenda muajit korrik të çdo viti. Buletini botohet për shpërndarje në format të printuar ose elektronik (me CD apo USB). Ndërsa të gjitha vendimet e Bordit që përbëjnë Buletinin Zyrtar publikohen në faqen online të AMF-së pas çdo mbledhje Bordi.

Me Vendimin e Bordit nr. 163, datë 30.07.2018 u aprovuan ndryshimet në rregullore nr. 155, datë 23.12.2014 “Për përcaktimin e elementëve të përlogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre”.

Me Vendimin nr. 224, datë 26.11.2018, Bordi miratoi udhëzimin “Për vlerësimin e performancës në punë të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si edhe ndryshoi Rregulloren nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës së punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, në funksion të vlerësimit vjetor të punës, vlerësimit të ecurisë dhe rezultateve në punë të punonjësve të Autoritetit.

Me Vendimin e Bordit nr. 213, datë 31.10.2018, u miratua një ndryshim në udhëzimin “Për vlerësimin e ecurisë dhe rezultateve në punë të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, në lidhje me tabelën shpjeguese të rezultateve në punë të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, me shkallët e vlerësimit, nivelin, mesataren e pikëve, etj.

Me Vendimin nr. 195, datë 27.09.2018, Bordi miratoi një shtese në rregulloren nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, në lidhje me kriteret dhe procedurën për pozicionin e punës kryespecialist në Autoritet.

Me Vendimin nr. 154, datë 30.07.2018, u miratua ndryshimi në udhëzimin e pagave të AMF-së, nr. 76, datë 28.07.2015 “Për shpërblimet e anëtarëve joekzekutivë dhe pagës së Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Nëndrejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”.

Ndryshimi në Rregulloren nr. 102, datë 30.09.2015 “Për krijimin, investimin dhe përdorimin e fondit të rezervës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, u miratua vendimin e Bordit nr. 222, datë 26.11.2018, dhe kishte të bënte me terminologjinë që i referohet vitit, në të cilin miratohen pasqyrat financiare.

### **Marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbim informacioni**

Me Vendimin nr. 93, datë 13.06.2018, u miratua marrëveshje AMF-FSVC me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale të AMF-së nëpërmjet konsultimeve të personalizuara, trajnimeve në vendin e punës dhe *workshopeve*.

Me Vendimin nr. 43, datë 23.03.2018, u miratua marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, e cila synon ofrimin e shërbimeve me qëllim rritjen e efektivitetit, kohëzgjatjes, kufizimin e rreziqeve teknike, pra në ruajtjen e integritetit, konfidencialitetit dhe vazhdueshmërisë së punës objekt i kësaj marrëveshjeje.

Me Vendimin nr. 19, datë 31.01.2018, Bordi miratoi nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Universiteteve, sipas një liste universitetesh dhe një marrëveshjeje tip.

## **II.2 Politika e Burimeve Njerëzore**

Politikat e burimeve njerëzore janë orientuar kryesisht drejt rritjes profesionale dhe ekspertizës së stafit. Këto politika janë në përputhje me objektivat e strategjisë afatmesme të institucionit dhe sipas përcaktimeve të kuadrit rregullativ.

Ruajtja e një mjedisi pune motivues, rritja e bashkëpunimit mes departamenteve dhe stafit, si dhe arritja e qëndrueshmërisë dhe vazhdueshmërisë afatgjatë të kapaciteteve administrative ka qenë prioritet i politikave në fushën e burimeve njerëzore. Kjo është arritur nëpërmjet politikave të burimeve njerëzore për promovimin e stafit që synojnë garën profesionale dhe shërben si instrument për identifikimin dhe administrimin më të mirë të mundshëm të burimeve njerëzore. AMF për vitin 2018 ka përshtatur infrastrukturën rregullative për ofrimin e mundësisë së promovimit në pozicione më të larta të punonjësve me më shumë eksperiencë dhe atyre me aftësi profesionale shume të mira. Kështu pjesë e rregullores së marrëdhënieve të punës si dhe një udhëzim i veçantë, janë seti i rregullave që do të zbatohen në rastet e kërkesave të punonjësit specialistë për emërimin në pozicionin kryespecialistë. Një tregues mjaft i rëndësishëm në këtë aspekt është dhe promovimi i stafit të brendshëm të AMF, ku rezulton se 6 punonjës janë ngritur në detyrë me një shkallë.

Vlen të përmendet treguesi i qarkullimit të stafit të AMF-së – i cili për vitin 2018 ishte më pak se 5% kundrejt niveleve tepër të larta të viteve paraardhëse, i cili tregon politikën e vazhdueshmërisë së stafit, kryesisht atij teknik dhe të kualifikuar sipas rekomandimeve të Bankës Botërore.

Një tjetër drejtim i rëndësishëm i punës së burimeve njerëzore është edhe plotësimi i strukturës organizative të AMF-së dhe i kuadrit ligjor dhe rregullativ. Kështu plotësimi i vendeve vakante ka qenë pjesë e objektivave për administrimin e burimeve njerëzore gjatë vitit, nëpërmjet një procesi konkurrimi të hapur dhe transparent. Numri i punësimeve të kryera gjatë 2018 është 19.




Në AMF, në fund të vitit 2018 numri i punonjësve arriti në 87 nga 90 punonjës të planifikuar. Shkalla e plotësimit të vendeve të punës është 96,6 %.

Një tjetër zhvillim në politikat e burimeve njerëzore për vitin 2018 ishte udhëzimi “Për vlerësimin e performancës në punë të punonjësve”, i cili u miratua në nëntor të vitit 2018. Forma e re e vlerësimit të performancës jep më tepër hapësirë për një vlerësim më objektiv të punës dhe të punonjësve në raport me njëri-tjetrin. Synimi kryesor i rishikimit të formës së vlerësimit është të ndihmojë punonjësit dhe drejtuesit të kuptojnë qartë ecurinë konkrete të punës me objektiv rritjen e cilësisë së punës.


Duke vlerësuar si prioritet qendrueshmërinë dhe vazhdimësinë, politikat e ndërmarra të burimeve njerëzore kanë ndikuar ndjeshëm në uljen e indeksit të qarkullimit të stafit nga 14 % në vitin 2017, në 5 % në vitin 2018.

**Grafik 37: Struktura e punonjësve të funksioneve kryesore të AMF-së sipas njësive**  
(Në %)



**Grafik 38: Struktura e punonjësve sipas profesionit**


(Në %)



Të dhënat tregojnë një qendrueshmëri të moshës mesatare të punonjësve në 39 vjeç. Rreth 72% e stafit janë femra. Përsa i përket të dhënave në lidhje me drejtimin, rezulton se femrat në pozicione drejtuese përbëjnë 65%, ndërsa meshkujt 35%.

**Grafik 39: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës**

(Në %)



## Kualifikimi profesional

Zhvillimi profesional i stafit është bërë i mundur nëpërmjet realizimit të trajnimeve profesionale, brenda dhe jashtë vendit. Pjesëmarrja në këto trajnime të specializuara të organizuara nga Autoritetet homologe, institucionet financiare ndërkombëtare përveç rritjes së njohurive profesionale i shërben stafit të Autoritetit edhe për shkëmbimin e përvojave profesionale dhe menaxheriale.

Aktivitetet e realizuara për vitin 2018, brenda dhe jashtë vendit, kanë konsistuar në pjesëmarrje në trajnime, seminare, konferenca, takime, si dhe vizita në shkëmbimin e përvojave më të mira profesionale, mbështetur në asistencën e institucioneve prestigjioze ndërkombëtare në fushën financiare si: Banka Botërore (BB), Këshilli i Evropës, USAID nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri si edhe shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve, Shoqata Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS); Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO); Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve (IOPS); Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve e SHBA-së (NAIC), etj.

Programi i trajnimeve vijoi në përshtatje me objektivat e institucionit dhe objektivat individualë për punonjësit. Kështu në kuadër të fazës së tretë të projektit **“Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve” (SECO)**, janë kryer *study-tour* dhe shkëmbime përvojash me autoritete homologe (Itali, Estoni, Kroaci).

Në vazhdimësi u realizuan *workshope* dhe trajnime me fokus zhvillimin e kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve të investimeve, trajnime për zhvillimin dhe forcimin e rolit të burimeve njerëzore si dhe *workshope* për punonjësit e nivelit drejtues për çështje të tilla si lidhshëpi, prezantimi dhe ndikimi në publik; trajnim mbi menaxhimin e njohurive dhe zhvillimin e tyre.

## II.3 Sistemet e Teknologjisë së Informacionit

Gjatë vitit 2018 ka pasur zhvillime të rëndësishme në infrastrukturën e brendshme të teknologjisë informatike duke aplikuar metodat më bashkëkohore në ndërtimin e sistemeve të informacionit. Janë zhvilluar takime me homologë në vendet e tjera me qëllim shkëmbimin e ideve dhe eksperiencave me pasojë përmirësimin e TI sipas praktikave më të mira. Përveç detyrave funksionale të lidhura ngushtësisht me funksionet e mbikëqyrjes, inspektimit dhe rregullimit, gjatë vitit 2018 u realizuan me sukses projektet si më poshtë:

1. Ndërtimi i infrastrukturës *disaster recovery* site pranë AKSHI:
  - Në fillim të vitit u bë e mundur instalimi i infrastrukturës së TI pranë AKSHI e cila lidhet me 2 fibra me qendrën e informacionit pranë AMF. Në këtë infrastrukturë

bëhet e mundur ruajtja (*backup*) e gjithë informacionit të sistemeve të AMF në mënyrë ditore, javore dhe mujore duke arkivuar gjithë informacionin në format digjital;

- Nëpërmjet kësaj infrastrukture AMF bën të mundur ruajtjen e informacioneve jashtë ambienteve të dhomës së serverave me qëllim ruajtjen e informacionit në raste kur dhoma e serverave pranë AMF të mund të ketë dalë jashtë funksionit për shkaqe të katastrofave të mundshme. Zbatimi dhe ngritja e kësaj infrastrukture përkon gjithashtu me standarde ndërkombëtar apo edhe me rekomandimet e ndryshme. Në vijim ky përfundim i këtij projekti i hap me tej rrugën mundësisë së zbatimit të një tjetër projekti të quajtur *business continuity site* i cili mendohet të zbatohet në vitin në vijim.

## 2. Analizë e sistemeve TI pranë AMF nga AKSHI:

- Me kërkesë të AMF u ngrit grupi i punës nga AKSHI dhe u analizuan të gjitha sistemet dhe infrastruktura e TI me qëllim dorëzimin e një raporti final me gjetjet. Gjithashtu në përfundim të kësaj analize AKSHI morri përsipër ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të specializuara duke theksuar disa prej tyre: Ofrimin e Mail Server të përmirësuar, sistemin e antivirusit të *Symantec* për gjithë pajisjet e AMF, etj;
- Raporti final i grupit të punës nga AKSHI nxori në pah nevojat për përmirësim të mëtejshëm të sistemeve të TI të cilat u morën në konsideratë të menjëhershme duke bërë të mundur realizimin e ndryshimeve përkatëse. Përmes asistencës së ofruar nga AKSHI do të mundësohet një ambient më i sigurt dhe efikas.

## 3. Përmirësimi i infrastrukturës së dhomës së serverave pranë AMF:

- Bazuar në rekomandimet e FSCV, AKSHI, Auditi i brendshëm si dhe analiza e drejtorisë së TI pranë AMF-së u bë e mundur rritja e kapacitetit përpunues të serverave ashtu edhe depozitues, rritja e vijës së parë të sigurisë së rrjetit nga sulmet kibernetike, monitorimi fizik i dhomës së serverëve;
- Këto ndryshime kanë sjellë rritjen e sigurisë, performancë të lartë në ofrimin e shërbimeve si dhe mundësi për ofrimin e më shumë shërbimeve në vijim.

## 4. Përmirësime të regjistrimit elektronik të sigurimit të detyrueshëm motorik:

- Një nga detyrat kryesore në kuadër të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve është mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës teknike të Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik si dhe mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve ndër-institucionale të dhëna nga AMF si DPSHTRR, DPGJC, QKB, AKSHI dhe Ministria e Brendshme; Disa prej këtyre ndryshimeve dhe mirëmbajtjeve të kryera gjatë vitit 2018 janë: *Upgrade* i Oracle në versionin 11G (64 bit), shmangien e raportimit të ID shqiptare si 'I HUAJ', raportim statusi police "kthyer" në kohë reale, integrimi për herë të parë me regjistrin e QKB;

- Këto përmirësime kanë bërë të mundur ofrimin e shërbimit me shpejtësi më të lartë, kanë ofruar automatizim të disa prej proceseve të cilat kryheshin manualisht si dhe me qëllim rritjen e cilësisë së të dhënave duke ulur gabimet njerëzore duke mbajtur kështu përgjegjësi përpara konsumatorëve.
5. Raportimi në kohë reale të policave të minatorëve dhe pasagjerëve
- Ndërlidhje me tregun e sigurimeve për raportim në kohë reale të policave për sigurimin e minatorëve, si dhe të pasagjerëve në udhëtim;
  - Këto ndryshime kanë sjellë plotësimin e rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë sipas rezolutës por gjithashtu edhe rritjen e cilësisë së mbikëqyrjes të tregut të sigurimeve.
6. Përmirësimi i sistemit të dëmeve dhe raportimi i tyre në kohë reale:
- Përmirësimi i sistemit të dëmeve me fusha të reja gjatë hedhjes së dosjeve të dëmeve si dhe sinkronizimi midis sistemeve të dëmeve të AMF me atë të shoqërive të sigurimit;
  - Funkcionet shtesë mundësojnë ofrimin e informacioneve të nevojshme për mbikëqyrje në kohë reale si dhe ofrojnë mbrojtjen e duhur konsumatore. Gjithashtu është rritur cilësia e të dhënave në lidhje me dëmet të cilat do sjellin aplikim më efikas të sistemit *Bonus-Malus* që mendohet të vihet në funksion gjatë vitit aktual.
7. Raportimi online për tregun e Investimeve dhe të Pensioneve, raportim në kohë reale:
- Krijimi i një platforme *online* për raporte të drejtpërdrejta të pasqyrave financiare apo raporteve të tjera periodike të tregut të fondeve të investimeve dhe atyre të pensioneve;
  - Në këtë mënyrë AMF plotëson kuadrin e digjitalizimit dhe grumbullimit të gjithë raporteve periodike të tregjeve nën mbikëqyrje duke lehtësuar procesin e raporteve periodike, duke rritur cilësinë e përpunimit të këtyre raporteve si dhe duke i hapur rrugë aplikimit të sistemit të inteligjencës në biznes në vitin në vijim.
8. Platforma e raportimit të ankesave online:
- Krijimi i një platformë ku çdo konsumator i secilit prej tregjeve nën mbikëqyrje nga AMF të mund të raportojë një ankesë përveç mënyrave tradicionale por tani edhe *online* përmjet kësaj platforme;
  - Aplikimi i kësaj platforme u ka sjell transparencë dhe lehtësi për konsumatorin pasi u ka ofruar atyre jo vetëm lehtësi në raportimin e ankesës por edhe mundësinë e ndjekjes *online* të statusit të ankesës së tyre deri në përfundim të saj.
9. Përfshirja e TI në inspektime:
- Inspektime tematike të ndryshme, por vlen të përmendet ai bazuar rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, në lidhje me vlerësimin e sistemeve të TI që përdorin shoqëritë e sigurimeve për të raportuar policat e sigurimit të detyrueshëm motorik.

- Si rrjedhojë është ndryshuar Rregullorja nr. 23, ku dhe gjithashtu janë organizuar takime me TI e shoqërive me qëllim rekomandimin për përmirësim të mëtejshëm të sistemeve të tyre me qëllim ofrimin e sigurt të informacioneve bazuar standardeve më të mira ndërkombëtare.

#### 10. Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemeve TI:

- Vizita të ndryshme pranë homologëve të rajonit dhe më gjerë, si edhe pjesëmarrja në aktivitete tematike ndërkombëtare. Disa prej tyre janë vizitat në Kroaci, Slloveni, Kosovë dhe Maqedoni;
- Një pjesë e punës së realizuar nga drejtoria e TI në 2018 ka ardhur jo vetëm nga rekomandimet e mësipërme por gjithashtu si rrjedhojë e aplikimit të praktikave më të mira ndërkombëtare të marra nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me vendet e zhvilluara.

#### 11. Mirëmbajtje e infrastrukturës aktuale:

- Përgatitjen dhe konfigurimin e mëtejshëm të infrastrukturës së brendshme të shërbimeve të AMF si administrimin e e-maileve, kompjuterëve, serverëve, dokumenteve elektronike, si dhe telefonia qendrore; Monitorimin dhe përditësimin e faqes zyrtare online të AMF-së; Zgjerimin e mirëmbajtjen e lidhjeve të Internetit dhe shkëmbimit të të dhënave të AMF-së në kuadër të përdorimit në rritje të sistemeve TI; Hartimin dhe zbatimin e programeve të sigurisë, duke ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve të AMF-së. Bashkëpunime me institucione kombëtare për sigurinë e informacionit si DSIK, AKCESK dhe Komisionerit të IDP;
- Si rrjedhojë infrastruktura aktuale ka ofruar në mënyrë të pandërprerë shërbimet ndaj stafit të brendshëm me përgjegjësi dhe efikasitet maksimal si dhe përshtatet në vijim bazuar standardeve më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Më në detaje do theksonim punën e kryer sipas kategorive si më poshtë:

#### **Sistemi i Raportimit Online**

- AMF In-Reg është sistemi i raportimit në lidhje me tregun e sigurimeve i cili përbëhet nga një sërë komponentësh aplikativë që bashkëpunojnë për të realizuar aktivitetin primar për të cilin është krijuar ky sistem si një platformë raportimi web, nëpërmjet të cilës shoqëritë e sigurimit raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit. Format raportuese janë një tjetër komponent i tërësisë së sistemit AMF In-Reg Firms (ndërfaqja që mundëson procedurën e raportimit të operatorëve në mbikëqyrje të AMF-së). Ato janë projektuar, ndërtuar dhe zbatuar në përshtatje me aplikacionin *Vizor Builder* i cili përditësohet sipas kërkesave në rritje;
- Në vijim të aplikimit të së njëjtit parim raportimi edhe për operatorët e subjekteve të tjera të mbikëqyrura nga AMF është zhvilluar analiza e kërkesave dhe ka përfunduar procedura e prokurimeve për sistemin e raportimit për tregun e

kapitaleve si dhe të tregut të pensioneve vullnetare. Ky projekt i ka hapur rrugë sistemeve të tjera që lidhen me analizat parashikuese dhe sistemeve që ofrojnë raportime inteligjente (*business intelligence reporting*). Brenda vitit 2019 do të fillojë dhe aplikimi i inteligjencës në biznes duke ofruar një nivel të lartë të matjes së tregut si dhe vendimmarrjeve akoma më efikase.

### Sistemi Qendror në dhomën e serverëve

Teknologjia e Informacionit (TI) në AMF është zhvilluar në përputhje me strategjinë kombëtare të informatizimit, si pjesë e pandarë e institucionit duke pasur si objekt pune zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike. Madje gjatë vitit 2018 është bërë progres i konsiderueshëm në këtë kuadër pasi janë kryer analiza dhe audite të shumta me qëllim përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë, disa prej tyre vlen të përmenden FSCV, Audit i brendshëm, AKSHI si dhe vetë drejtoria e TI.

Në vijim edhe të rekomandimeve të mësipërme janë realizuar këto projekte: Gjatë periudhës mars 2018 ka filluar punë infrastruktura *disaster recovery* pranë AKSHI e cila lidhet me 2 fibra. Në dhjetor 2018 kanë përfunduar përmirësimet sipas rekomandimeve të bëra në lidhje me infrastrukturën TI ashtu si kapaciteti përpunues i serverave apo edhe ai depozitues, është rritur vija e parë e sigurisë së rrjetit nga sulmet kibernetike. Janë vendosur sensor uji, lagështirë, CO, zjarri, temperature si dhe kontroll aksesi për monitorimin fizik të dhomës së serverave.

Gjatë vitit 2018, sistemet kryesore të TI në AMF kanë funksionuar në mënyrë të vazhdueshme me disponibilitet 99% të kohës vjetore duke siguruar mbështetjen e funksioneve të Autoritetit. Sistemet e TI-së në Autoritet kanë siguruar edhe koordinimin e punës me institucionet me të cilat Autoriteti ka bashkëpunim për shkëmbimin e informacionit, si DPSHTRR, AKSHI dhe Ministria e Brendshme.

### Regjistri Elektronik Online i Sigurimit të detyrueshëm Motorik

Janë kryer shumë zhvillime gjithashtu në kuadër të përmirësimit të regjistrit elektronik të sigurimit të detyrueshëm motorik, ku disa prej tyre janë: zhvilli dhe përshtatja e raportimit të Policave me numër serie me 9 shifra, zhvillim dhe përshtatja e raportimit në lidhje me heqjen e mundësisë për raportim e ID si 'I HUAJ' (përdorim abuziv edhe për shtetasit shqiptar) duke e shoqëruar me hartimin e procedurës për personat vërtet te huaj; Zhvillimi dhe përshtatja e raportimit të policave në statusin kthyer në kohë reale duke zhvilluar web servicen; Zhvillimi dhe përshtatja e raportimit të klientëve të policave duke sistemuar *bug*, Integrimi me QKB dhe përmirësimi i sistemit aktual duke shmangur *bugs* dhe duke shtuar kushtet e kontrollit me qëllim publikimin e Web Serviceve të QKB për rritje të saktësisë së të dhënave gjatë lëshimit të policave; *Upgrade* i database Oracle në versionin 11G (64 bit) për Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve, dhe shumë zhvillime të tjera që kanë ardhur si rrjedhojë e bashkëpunimit të frytshëm me shoqatën e sigurimeve.

Për vitin 2018, janë rreth 300 praktika drejtuar AMF-së nga konsumatorët dhe palët e treta të cilat janë trajtuar nga Autoriteti bazuar në Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik.

### **Hartimi i rregulloreve dhe udhëzimeve**

Janë realizuar disa inspektime por vlen të përmendet inspektimi tematik në lidhje me vlerësimin e sistemeve të TI që përdorin shoqëritë e sigurimeve, shoqëritë e agjentëve dhe brokerat për të raportuar policat e sigurimit të detyrueshëm motorik, duke nxjerrë gjetjet, analizuar observacionet dhe në fund duke hartuar raportin final me gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me çështjet e TI;

Si rrjedhojë janë hartuar dhe ndryshuar Rregullorja nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik” dhe gjithashtu Udhëzimi “Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit” që është shoqëruar me përgatitjen e politikave, formularëve dhe rregjistrave që rridhnin prej këtij udhëzuesi (kryesisht kjo e fundit ka qenë nevojë e brendshme e AMF-së për përputhshmërinë me standartet ndërkombëtare).


### **II.4 Audit i Brendshëm**

Aktiviteti i Njesisë së Auditimit përgjatë vitit 2018, është bazuar në përmbushjen dhe realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin Vjetor të miratuar nga Bordi i Autoritetit për vitin 2018.

Njësia e auditimit të brendshëm ka funksionuar me strukturë të plotë, me një Drejtues të Njesisë, një Auditues të profilit të përgjithshëm financiar, si dhe një Auditues të Teknologjisë së Informacionit dhe Vlerësimit të Riskut. Veprimtaria audituese është bazuar në procedurat e auditimit, të rregulluara në aktet ligjore në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm. Me qëllim garantimin e një efience sa më të lartë, i është kushtuar vëmendje procesit të vlerësimit paraprak të rrezikut, në përputhje me fushën për auditim. Nga analiza e treguesve më specifik të auditimit rezulton se ato kanë ndryshuar në vite, të ndikuara si nga numri i auditimeve, ashtu dhe nga specifikat e objekteve apo fushat e nën audituara. Natyra e 20 gjetjeve të auditimit i referohet kryesisht parregullsive në zbatimin e procedurave, ndërsa 53 rekomandime kanë synim përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjedhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen. Gjetjet dhe rekomandimet janë raportuar te Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe te Bordi i Autoritetit.



**Grafik 40: Struktura e situatës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga NjAB**  
(Në %)



Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të tij mbi Kontrollin e Brendshëm të Autoritetit, gjatë vitit 2018, Bordi i AMF-së ka miratuar “Planin strategjik për vitet 2019-2021, dhe planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2019”.

Plani Strategjik dhe Vjetor i Auditimit të Brendshëm, si një nga veprimtaritë më të rëndësishme për shërbimin e kontrollit të brendshëm, është ndërtuar për t’i siguruar organeve drejtuese të AMF, se e gjithë veprimtaria dhe operacionet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mbulohen me auditim në kuadër të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

## II. STRATEGJI DHE OBJEKTIVA TË AUTORITETIT

Edhe gjatë vitit 2019 puna e Autoritetit do të jetë e fokusuar në vijimin e zbatimit të Strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje (tetor 2017–tetor 2020)” duke ndjekur aktivitetet e parashikuara për rritjen e edukimit financiar të publikut dhe ndërgjegjësimin të konsumatorit.

Objektivi i Autoritetit për të shndërruar tregjet më të brishta financiare jobankare në Ballkanin Perëndimor në tregjet më të konsoliduara, u reflektuan në “Strategjinë për zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje 2018-2022”, si një udhërrëfyes për vizionin 5-vjeçar, të lidhur ngushtë edhe me procesin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Objektivat e vitit 2019 dhe ato afatmesëm, mbështeten pikërisht në këtë objektiv madhor të AMF-së, të cilat po i rendisim më poshtë:

### i) Mbikëqyrja dhe Monitorimi, nxitja dhe zhvillimi i tregjeve

Ky objektiv është trajtuar në kuadrin e zbatimit ligjor dhe rregullator për të tre tregjet nën mbikëqyrje duke garantuar qëndrueshmërinë në funksion të mbrojtjes së konsumatorit. Në përshkrimin e detyrave në funksion të këtij objektivi duket qartë ndarja e detyrave sipas tregjeve dhe bashkërendimi i punëve mes departamenteve që punojnë për të njëjtin objektiv.

Për të tre tregjet janë përcaktuar drejtimit kryesore të tyre në lidhje me inspektimet, Analizat *off-site*, analizat me bazë rreziku dhe bashkëpunimet me institucione të tjera financiare brenda dhe jashtë vendit. Në realizimin e këtij objektivi janë parashikuar dhe ndryshimet e Ligjit “për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ligjit “Për Titujt” Ligjit “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Ligji “Për pensionet Private” dhe një seri amendimesh apo hartimesh të rregulloreve për monitorimin e mbikëqyrjen e këtyre tregjeve.

### ii) Mbrojtja e konsumatorit

Për realizimin e këtij objektivi gjatë vitit 2019 jemi mbështetur edhe në strategjinë tre vjeçare “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje 2017-2020” dhe në planin e aktiviteteve që shoqëron këtë strategji.

Në këtë objektiv krahas punës që parashikohet të zhvillohet për rritjen e edukimit financiar të popullatës mbi tregjet financiare, janë parashikuar dhe një sërë procedurash monitorimi për shoqëritë që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrje në lidhje me sjelljen e tyre ndaj konsumatorit dhe disa aktivitete me nivelet e ndryshme arsimore në vend dhe veçanërisht me universitetet publike dhe private për të prezantuar dhe bashkëpunuar me ta në kuadër të rritjes dhe forcimit të njohurive mbi tregjet nën mbikëqyrje të AMF-së.

### iii) Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ

Në këtë objektiv janë përshkruar hapat që do të ndiqen nga departamentet përkatëse të tregjeve nën mbikëqyrje së bashku me Departamentin e Çështjeve juridike për hartimin dhe amendimin e akteve ligjore dhe rregullatore ashtu si kundër është cituar dhe në Objektivin 1. Krahas hartimit të ligjeve të reja dhe ndryshimeve të atyre ekzistuese për gjatë vitit 2019, do të punohet dhe për pajtueshmërinë me direktivat e BE dhe standardeve ndërkombëtare. Ky është një proces që shtrihet gjatë gjithë vitit 2019 e më tej.

### iv) Administrimi i Fondit të Kompensimit

Gjatë vitit 2018 për rëndësinë që iu dha trajtimin e tij, me synim mbrojtjen e konsumatorit është bërë një punë intensive për mbylljen e pagesave të prapambetura të Fondit të Kompensimit. Departamentet përkatëse krahas ndjekjes së pagesave që do të kryen në vazhdimësi nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve do të monitorojë dhe zbatimin e vendimeve të bordit për këtë qëllim. Është një ndër objektivat kryesorë, dhe synojmë frenimin e fenomenit të akumulimit të mos kryerjes së pagesave brenda kufijve kohorë të ngjarjes së ndodhur.

### v) Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF

Ky objektiv ka qenë në fokus të punës edhe gjatë gjithë vitit 2018. Me qëllim plotësimin e strukturës dhe rekrutimin e një personeli sa më të kualifikuar do të punohet për thithjen dhe punësimin e specialistëve me eksperiencë në fushën Financiare si dhe rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të stafit ekzistues. Për këtë do të hartohet një kalendar vjetor mbi trajnimet e stafit teknik të AMF brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e departamenteve. Përmirësimi i aftësisë për menaxhimin e skenarëve të krizave të tregjeve nën mbikëqyrje.

### vi) Modernizimi i infrastrukturës TIK dhe kapaciteteve të Qendrës së Informacionit.

Ky objektiv lidhet me një nga fushat kryesore të përpunimit të informacionit në AMF dhe fuqizimin e rritjen e kapaciteteve të personelit të Drejtorisë së teknologjisë së informacionit dhe Qendrës së Informacionit, modernizimit të platformave dhe programeve aktuale drejt një zgjidhje inteligjente të integruar dhe të sigurt, konsolidimi dhe ruajtja e të dhënave të Qendrës së Informacionit, rritja e sigurisë në rrjetet e informacionit dhe rritja e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve për ekspertizë. Krahas këtyre zhvillimeve, të cilat janë mjaft të nevojshme, do të punohet veçanërisht për administrimin e mirëmbajtjen e regjistrimit *online* të shitjeve, regjistrin elektronik të dëmeve dhe AMF In-Reg. Krijimi i një sistemi të ri raportimi për tregun e kapitaleve dhe pensione në kuadër të ofrimit të integritetit më të thjeshtë të shoqërive dhe gjenerimin inteligjent të raportimit për drejtoritë e AMF-së. Krijimi i një sistemi për ngritjen e ankesave të brendshme *online* në lidhje me DTI dhe gjurmimin e tyre për ofrim sa më cilësor të shërbimit.

### vii) Zbatimi i projekteve të asistencës teknike

Në këtë objektiv janë paraqitur veprimet konkrete që do ndërmerren nga AMF për të përmbushur dhe realizuar të gjitha projektet dhe asistencën teknike, me qëllim rritjen e


standardeve dhe ekspertizës së AMF, përmirësimin në raportimin financiar në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe institucional të vendit me direktivat e Bashkimit Evropian, menaxhimi i krizave etj.

viii) Bashkëpunimi ndërinstitucional me Organizatat Ndërkombëtare, Autoritetet homologe si dhe institucionet brenda dhe jashtë vendit.

Ky objektivi i detajuar me një plan aktiviteteve që do të organizohen gjatë vitit, synon forcimin e marrëdhënieve mes institucioneve brenda vendit dhe institucioneve homologe jashtë. Qëllimi është që të realizojmë marrëveshjen dypalëshe që të na shërbejnë për punën dhe për shkëmbimin e eksperiencave.

#### **IV. SHTOJCA**

## I. Struktura Organizative e AMF-së



**Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve** është përgjegjës për mbikëqyrjen efektive të shoqërive të sigurimit/ risigurimit, Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe ndërmjetësve në sigurime, nëpërmjet mbikëqyrjes *off-site*, *on-site* dhe shërbimeve aktuariale; licencon dhe monitoron shoqëritë e sigurimit dhe subjektet e tjera që operojnë në tregun e sigurimeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

**Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve** është përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut të titujve, fondeve të pensioneve vullnetare dhe të fondeve të investimeve, si dhe realizon mbikëqyrjen e subjekteve të licencuara në këto tregje; licencon subjektet që ushtrojnë veprimtari në tregun e titujve, tregun e fondeve të investimit dhe të pensioneve, si dhe monitoron ushtrimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me kuadrin ligjor.

**Departamenti i Çështjeve Juridike** është përgjegjës për përputhshmërinë ligjore të veprimtarisë së Autoritetit, nëpërmjet hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore të nevojshme, dhënies së opinionëve juridike dhe mbështetjes ligjore për veprimtarinë e tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe veprimtarinë e Autoritetit; kryen mbrojtjen ligjore të Autoritetit, përpara organeve gjyqësore dhe koordinon marrëdhënien e bashkëpunimit me institucionet ligj zbatues; siguron mbrojtjen e konsumatorit/investitorit, duke u kujdesur që veprimtaria e subjekteve nën mbikëqyrje të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe në mënyrë transparente e në mirëbesim siguron përmbushjen e proceseve integruese, përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së, si dhe përafrimin e parimeve dhe standardeve ndërkombëtare.

**Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve** është përgjegjës për zhvillimin e metodologjive dhe strategjive në funksion të mbikëqyrjes, ndjek zbatimin dhe ecurinë e projekteve të Autoritetit, kryen analiza të ecurisë dhe tendencave në zhvillim të tregjeve nën mbikëqyrje; administron Qendrën e Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme, zhvillon platforma të reja raportimi, si dhe harton dhe zbaton politika efektive të menaxhimit të burimeve financiare dhe njerëzore të Autoritetit në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së tij.